



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

Raportu vjetor 2016



TEB SH. A, Kosovë

Zgjerohmë botën tuaj

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Shërbimi më i mirë për klientët individë si dhe për ndërmarrjet - kjo është ajo që e udhëheqë TEB SH. A. me praktika etike biznesore që janë thelbësore për atë shërbim dhe për misionin tonë. Kjo është arsyeja përse sot aseti ynë numër një është marrëdhënia e mirëbesimit që kemi ndërtuar me klientët me kalimin kohës.

Vlerat tona

- Të sinqertë dhe të besueshëm
- Udhëheqës, pararendës dhe inovativ
- Të orientuar nga klienti dhe me fokus të fuqishëm tek cilësia e lartë
- Plot respekt për shoqërinë, të drejtat njerëzore dhe mjedisin
- Transparentë

Faqet

1.	Mbi TEB SH. A.	
1.1.	Profili i korporatës	6
1.2.	Misioni, vizioni dhe strategjia jonë	9
1.3.	Vlerat tona themelore	10
1.4.	Struktura aksionare	11
2.	Panorama e 2016-ës dhe perspektiva e 2017-ës	
2.1.	Nga Kryetari	13
2.2.	Nga Drejtori Ekzekutiv	14
3.	TEB SH. A. gjatë 2016-ës	
3.1.	TEB SH. A. në shifra	17
3.2.	Indikatorët financiarë kyç	18
4.	Njësitë e biznesit	
4.1.	Shërbimet bankare për individë	21
4.2.	Biznesi i kartelave	22
4.3.	Shërbimet bankare për NVM-të	25
4.4.	Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata	26
4.5.	Financat tregtare	27
4.6.	Menaxhimi i parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave	28
4.7.	Thesari dhe MPD-ja	29
4.8.	Burimet njerëzore	30
4.9.	Organizimi dhe zhvillimi i proceseve	32
4.10.	Teknologjia informative	33
4.11.	Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale	34
5.	Menaxhmenti/Qeverisja korporative	
5.1.	Struktura organizative e TEB Sh. A.	36
5.2.	Bordi i Drejtorëve	37
5.3.	Komitetet	39
5.4.	Auditimi i Brendshëm	42
5.5.	Menaxhimi i Rrezikut dhe Rreziku Operacional e Vazhdimësia e Biznesit	42
5.6.	Pajtueshmëria dhe Kontrolli i Brendshëm	45
6.	Raporti i Auditorit	
6.1.	Raporti i Pavarur i Auditimit i datës 31 dhjetor 2016 dhe Shënimet në Pasqyrat Financiare	48

TEB Sh. A Raporti vjetor 2016

Data e raportit: 01.01.2016 — 31.12.2016

Adresa: Agim Ramadani Street, Nr. 15, 10000 Prishtina

Telefoni: +381 (0) 38 230 123

Fax: +381 (0) 38 224 699

Email: info@teb-kos.com

Web: www.teb-kos.com

About TEB SH. A

1.1. Profili i korporatës

Zgjerohet botën tuaj...

Me fokus tek ardhmëria: do të përpiqemi ta rrisim më tej kënaqësinë e klientëve tanë.

Pas nëntë vitesh të suksesshme në Kosovë, TEB SH. A. (TEB) ka bërë emër të njohur në sektorin bankar, duke fituar reputacion bukur të merituar për shërbim të shkëlqyer. Prej fillimit e deri tani, në mënyrë sistematike kemi çelur shtigje të reja për t'i përmbushur nevojat e individëve dhe bizneseve për shërbime bankare dhe financim, duke lansuar shumë produkte e shërbime për 'herë të parë' në tregun e Kosovës.

Në botën që po ndryshon me shpejtësi, TEB-i është gjithmonë gati t'i mbështesë klientët dhe punonjësit. Kjo aftësi bazohet edhe në pozitën tonë si anëtar i mirënjohur i Grupit TEB. Grupi u formua përmes një sipërmarrjeje të përbashkët ndërmjet BNP Paribas, një prej institucioneve financiare më të fuqishme në botë, dhe Turk Ekonomi Bankasi, një prej bankave me më së shumti reputacion në Turqi,.

Ne synojmë të jemi bankë e përgjegjshme. Për këtë arsye zhvillojmë një sërë aktivitete me përgjegjësi shoqërore që kontribuojnë në zhvillimin social. Për TEB-in, përgjegjësia shoqërore e korporatës është një vegël shumë e vlefshme dhe thelbësore që plotëson misionin tonë ekonomik. Prandaj, përveç ofrimit të shërbimit të shkëlqyer, inovativ dhe të përgjegjshëm për klientët tanë, ne ndërmarrim projekte që janë të dizajnuara për të sjellur përparim në arsim, kulturë dhe sport - të gjitha me synim për ndikime pozitive për sa më shumë njerëz në Kosovë.

Vlera, Shërbimi, Ekselencia...

Për TEB-in, klienti është në qendër të gjithçkaje që ne bëjmë. Klientët tanë janë të posaçëm dhe të vlerësuar. Kjo shprehet në të gjitha produktet dhe shërbimet e dizajnuara në mënyrë të posaçme që ne ofrojmë për grupe të ndryshme të klientëve, nga ndërmarrësit e deri te qytetarët më të moshuar, nga punonjësit e deri te studentët.

Ne besojmë se rritja sistematike e numrit të klientëve, rritit tonë të shërbimit, vëllimit të transaksioneve dhe personelit tonë nga viti në vit është dëshmi e përpjekjeve tona që:

- Vazhdimisht ta zgjerohet gamën e produkteve dhe shërbimeve tona bankare jo-në-degë dhe t'i shtojmë funksionalitetin rrjetit tonë inovativ të shërbimeve bankare me shumë kanale. Ne ofrojmë të gjitha llojet e produkteve dhe shërbimeve bankare të fokusuar në cilësi, të cilat njerëzve iu duhen në faza të ndryshme gjatë jetës së tyre - e gjitha përmes rrjetit tonë të zgjeruar dhe me shumë kanale të ofrimit.
- Ofrojmë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë të bankës bazuar në "shërbim të personalizuar".
- Performojmë më së miri në industri për sa i përket rritjes në numër të kartelave të kredisë, rritje që shtohet vazhdimisht me produkte dhe shërbime të reja, si dhe me fushatat specifike të kartelave të organizuara me grup tjetër të klientëve, anëtarët tanë tregtarë. Përmes segmentimit të biznesit me kartela, ne i identifikojmë grupet specifike, u shërbejmë atyre me produkte si She-Card për zonjat, Kartela e kredisë për gratë ndërmarrëse, dhe Business Card për pronarët e NVM-ve.
- Ruajmë pozitën tonë të fortë në shërbimet me pakicë të menaxhimit të parasë së gatshme.

- Ofrojmë mbështetje bankare komerciale që është shtytësi kyç në udhërrëfyesin drejt rritjes ekonomike të ardhme në Kosovë. Çdo vit, përforcojmë fokusin tonë tashmë të fuqishëm në mbështetjen e qindra mijërave klientëve komerciale dhe të NVM-ve të TEB-it, sepse ata luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në procesin e zhvillimit ekonomik.

Reale, e mençur, me vlerë...

Si anëtare e dy grupeve të fuqishme ndërkombëtare financiare – TEB A.S., institucion financiar kryesor dhe me reputacion të lartë në sektorin bankar turk, dhe BNP Paribas, një nga bankat e nivelit më të lartë të eurozonës me rrjet të gjerë dhe ndërkombëtar – TEB përfiton nga përvoja, fortësia dhe gama e Grupit. Kjo na mundëson gjenerimin e rezultateve më të mira për klientët tanë.

Mbi këto baza të shëndosha, TEB-i vazhdon të përparojë duke rritur cilësinë e shërbimeve dhe duke zhvilluar produkte të përshtatura me pritjet e klientëve. Në hap me avancimet e shpejta në teknologji, ne në mënyrë sistematike përmirësojmë rrjetin tonë inovativ dhe me shumë kanale të shërbimeve bankare (si shërbimet bankare në Internet dhe ato Mobile, Qendra e thirrjeve, Shërbimet SMS, Bankomatët, POS-ët) duke iu mundësuar klientëve përdorimin e kanalit më të përshtatshëm të shpërndarjes për transaksionet e tyre bankare - me komoditet, shpejtësi dhe të besueshmëri.

Më shumë përkushtim për komunitetin...

Që nga themelimi i TEB-it në vitin 2008, qasja jonë ka qenë sjellja e risive. Si një bankë e fuqishme me shërbime të plota, jemi fokusuar në përgjigjen ndaj kërkesave të klientëve për shërbime financiare. Me kalimin e viteve, kemi arritur t'i shfrytëzojmë

në mënyrë efektive kompetencat dhe vizionin tonë të korporatës, duke prodhuar vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionarët. Në vitin 2016, vazhduam të rritemi të balancuar dhe të shëndetshëm – çka edhe pritet prej nesh - duke përforcuar më tej pozitën tonë si një nga institucionet financiare më të fuqishme në vend. Kjo na jep një bazë edhe më të fortë për të ardhmen tonë si një fuqi e rëndësishme në Kosovë.

Përgjegjësia shoqërore e korporatës luan një rol të rëndësishëm. Politika jonë është të kontribuojmë në zhvillimin shoqëror të Kosovës. Kemi krijuar një kornizë për iniciativa afatgjata bazuar në spektrin e projekteve që do të krijojnë përfitime më të mëdha shoqërore. Në lidhje me mbështetjen e biznesit, jemi duke punuar përmes Programit të mbështetjes së ndërmarrësisë së grave, Akademisë së biznesit dhe Forumit të biznesit.

TEB Sh.A ndihmon dhe ofron mbështetje për një numër të madh të projekteve në art, bashkëpunim dhe sport si:

1. Sponsorizimi i Federatës së futbollit të Kosovës.
2. Sponsorizimi i ekipit kombëtar të basketbollit të Kosovës për kualifikimet e Euro 2017.
3. Sponsorizimi i turneut të tenisit "Dielli TEB Open" 2016.
4. Mbështetja e përbashkët me Swiss Contact dhe Institutin Riinvest e ngjarjes 'Femrat Ndërmarrëse në Kosovë' që u organizua nga Qendra Inovative e Kosovës (QIK) dhe Forumi Ekonomik i Gruas (FEG).
5. Sponsorizimi i Programit Ye! Kosovo Boost për ndërmarrësit e ri për t'i stimuluar idetë inovative. TEB SH. A. ka për qëllim që t'i inkurajojë dhe promovojë ndërmarrësit me synim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë.

Tejkalojmë pritjet tuaja...

Suksesi i TEB-it varet nga punonjësit tanë, të cilët përcjellin tek klientët qasjen tonë inovative dhe proaktive, dhe punojnë shumë për ta ruajtur dhe rritur cilësinë e shërbimeve dhe asetëve të përfaqësuara nga emri i brendit tonë. Qëllimet tona janë t'u ndihmojnë individëve dhe bizneseve që të ndërtojnë të ardhmen e tyre, të realizojnë ambiciet e tyre si dhe t'u ndihmojmë t'i menaxhojnë rreziqet e tyre financiare. Duam të jemi një institucion financiar që i bën klientët të ndihen rehat.

Suksesi i TEB-it varet nga punonjësit tanë,
të cilët përcjellin tek klientët qasjen tonë
inovative dhe proaktive...

**Klientët tanë janë të posaçëm
dhe të vlerësuar.**

Qëllimet tona janë t'u ndihmojnë individëve
dhe bizneseve që të ndërtojnë të ardhmen e
tyre, të realizojnë ambiciet e tyre si dhe t'u
ndihmojmë t'i menaxhojnë rreziqet e tyre
financiare.

1.2 Vizioni, misioni dhe strategjia jonë

Vizioni ynë

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë.

Misioni ynë

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë.

Strategjia jonë

Në përputhje me vizionin dhe misionin tonë, strategjia jonë është që të ofrojmë një përvojë të jashtëzakonshme dhe efikase bankare për të gjithë klientët tanë. Këtë do ta arrijmë duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe praktike për të siguruar rritje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Oferta e TEB-it është gjithmonë e bazuar në zotimin tonë për të qenë bankë e përgjegjshme. Kjo është e mishëruar në të gjitha vlerat tona dhe pasqyrohet në biznesin tonë, në mënyrën si i zhvillojmë produktet dhe shërbimet tona dhe si i paraqesim qëllimet dhe premtimet tona.

Në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë tonë.

1.3. Vlerat tona themelore

Klienti në qendër

Suksesi ynë është i bazuar në përkushtimin e plotë për klientët tanë në çdo kohë, duke fituar besimin dhe besnikërinë e bazës sonë të klientëve. E ruajmë këtë besim, sepse klientët tanë janë në thelb të gjithçkaje që bëjmë. Nevojat dhe pritjet e klientëve janë shtysat e qasjes dhe përgjigjeve tona të shpejta dhe proaktive ndaj kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi. Kjo na mundëson ta krijojmë dhe ta japim vlerën e vërtetë teksa u shërbejmë klientëve tanë me shërbime dhe produkte të reja, përtej pritjeve të tyre, të përshtatura dhe të trendit të fundit.

Integriteti

Kemi përqaftuar standardet më të larta të integritetit në çdo gjë që themi dhe bëjmë dhe jemi të përkushtuar për të krijuar vlerë të shtuar për klientët, aksionarët dhe punonjësit tanë duke bërë gjithmonë më shumë se thjesht atë që është e duhur. Komunikojnë hapur dhe me sinqeritet, i ftojmë dhe i vlerësojmë pikëpamjet sfiduese që kanë për qëllim krijimin e ideve më të mira dhe marrjen e vendimeve më të përshtatshme dhe më të balancuara.

Krijojmë vlerë për aksionarët tanë përmes suksesit afatgjatë e jo përmes fitimit afatshkurtër. Pra, qëllimi ynë është që biznesi ynë kryesor të realizojë dividendë e rentabilitet operativ të shëndetshëm dhe të fuqishëm përmes një fryme të ndërmarrësisë që me përgjegjësi balancon rreziqet dhe fitimet.

Inovacioni

Aspirojmë inovacione me rëndësi. TEB-i vlerëson entuziazmin e kombinuar me kureshtjen intelektuale të personelit tonë, gjersa ata vazhdimisht synojnë të krijojnë produkte që lehtësojnë suksesin e klientëve tanë dhe ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për nevojat e tyre.

Efikasiteti në punë

Krijojmë procese dhe produkte miqësore për përdoruesin, të lehta për qasje dhe të projektuara për të shtuar vlerë. Përpiqemi të sigurohemi se shërbimet që ofrohen për klientët tanë kanë çmime që u përgjigjen drejtë kostos aktuale të ofrimit të tyre.

Disiplina

Mendojmë dhe veprojmë si pronarë të Bankës që t'i mbrojmë burimet e saj dhe të përqendrohemi në qëllimet e përbashkëta dhe jo ato individuale. Jemi krenarë për sukseset e TEB-it dhe vlerën që krijojmë për aksionarët dhe klientët tanë. Secili nga 580 punonjësit tanë ndihet përgjegjës nëse dështojmë në përmbushjen e pritjeve të klientëve dhe të gjithë japim llogari për përmbushjen e premtimeve tona - nuk ka justifikime. Synojmë të arrijmë përsosmëri operationale duke e kryer punën mirë që në përpjekjen e parë.

Burimet kompetente njerëzore

Synojmë të forcojmë pozitën tonë si punëdhënës i zgjedhur dhe përpiqemi të krijojmë një kulturë që tërheq individë të talentuar, nxit punën bashkëpunuese e të zhdërvjellët ekipore përmes diversitetit dhe përgjegjësisë, edukojmë dhe investojmë në talentët më të mirë, dhe menaxhimin e bazojmë në merita dhe mundësi të barabarta.

Partneriteti

Synojmë që me klientët dhe punonjësit të kemi marrëdhënie të qëndrueshme dhe reciprokisht të dobishme, në të cilat vlera e krijuar ndahet në mënyrë të drejtë. Jemi partnerë të përgjegjshëm me të gjitha palët me interes dhe rregullatorët, dhe i shërbejmë shoqërisë.

Kanalet e fuqishme të shpërndarjes

Përpiqemi të ofrojmë shërbime dhe përkrahje për klientët tanë siç iu përshtatet atyre, duke ofruar kanale të ndryshme të shpërndarjes, duke përfshirë zyrat tona të degëve, qendrën e thirrjeve, shitjet e drejtpërdrejta dhe kanalet e ndryshme alternative të shpërndarjes.

1.4. Struktura aksionare

Kapitali aksionar i Bankës është 24.000.000 € bazuar në 2.400.000 aksione të emetuara, secili me vlerë nominale 10 €.

Numri i aksioneve lidhet me aksionet e zakonshme pa të drejta, me preferenca ose kufizime të lidhura me to.

Aksionar më 31 Dhjetor 2016	Pronësia e aksioneve e paguar në kapital (€)	Aksione
TEB Holding A.Ş.*	24,000,000	100%

* 50%-50% BNP Paribas Fortis Yatırımlar Holding A.Ş. dhe Çolakoğlu Group Joint Venture

Panorama e 2016-ës dhe perspektiva e 2017-ës

2.1. Mesazhi i Kryetarit

Qëllimi i Bankës është që ta mbajë rritjen e saj në vitet e ardhshme duke vazhduar me qasjen tonë të orientuar nga klienti. Ne do të vazhdojmë ta mbështesim rritjen me korniza të forta të menaxhimit të rrezikut dhe pajtueshmërisë që janë në zemër të kulturës së Bankës.

Për Klientët, Partnerët biznesor dhe Aksionarë tanë,

Një nga lojtarët e mëdhenj të shërbimeve financiare në sektorin bankar të Kosovës, gjatë vitit 2016, TEB SH. A. ka vazhduar qasjen e saj pioniere, inovative dhe të orientuar nga klienti. Në TEB SH. A., rritja dhe performanca janë të shtytura nga fokusi i fuqishëm në krijimin e vlerës për të gjithë klientët tanë. Ato janë të mbështetura nga fuqia dhe rentabiliteti financiar që janë thelbësore në përmbushjen e rolit tonë dhe të siguruarit se do të mbesim të rëndësishëm për komunitetin në të cilin operojmë. Ne kemi dalë me shifra të mira financiare në vitin 2016 me 18.3 milion Euro fitim neto dhe raport të fortë të adekuatshmërisë së kapitalit prej 15.9%. Për më tepër, ekuiteti i aksionarëve të TEB SH. A. ka arritur në më shumë se 71.3 milion Euro, një rritje prej rreth 35% në krahasim me vitin e kaluar.

Prej natyrës evoluese të rregullimit të sektorit financiar, fokusit thelbësor në infrastrukturë dhe pajtueshmërisë më të madhe rregullatore, viti i kaluar gjithashtu ishte larg të qenit një vit tipik. TEB SH. A. ka për qëllim që të mbetet institucion financiar etik.

Ne e kemi përforcuar fokusin tonë të fuqishëm në mbështetjen e klientëve të shumtë NVM të Bankës si dhe segmentet e tjera potenciale siç janë Agro-bizneset dhe Gratë Ndërmarrëse. Ne kemi ndërtuar një pozitë të veçantë në Kosovë përmes mbështetjes sonë për të kontribuar në zhvillimin e tyre me një koncept të paraqitur si "Akademia Biznesore" e që ka për qëllim rritjen e kompetencave të sektorit të NVM-ve dhe për t'i ndihmuar ata ta rrisin biznesin e tyre. Brenda këtyre programeve mbështetëse, ne gjithashtu bashkëpunojmë me institucione ndërkombëtare; siç janë, Agjencia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Përveç të gjitha aktiviteteve dhe inovacioneve të saj të reja, TEB SH. A. ka mbajtur pozitën e saj udhëheqëse në segmentin e shërbimeve bankare me pakicë dhe si udhëheqës i pakontestueshëm i biznesit të Kartelave në Kosovë. Në terme të inovacioneve biznesore dhe trendeve në digjitalizim, Banka është angazhuar në migrimin e produkteve dhe shërbimeve të saja bankare në formatin digjital.

Të gjitha këto angazhime janë njohur edhe një herë në nivel ndërkombëtarë në vitin 2016. Na është dhënë titulli i bankës më të mirë në Kosovë nga revistat Bankers dhe Global Finance. Ne falënderojmë klientët tanë për besimin dhe konfidencën e tyre të vazhdueshme dhe në të ardhmen presim rritje të mëtutjeshme të marrëdhënies sonë me ta.

Dëshiroj ta falënderoj z. Musa Erden i cili gjatë këtij viti raportues e ka lëshuar pozitën si Kryetar i TEB-it në Kosovë, pozitë të cilën e ka mbajtur nga viti 2010. Ai ishte jashtëzakonisht i suksesshëm në të siguruarit që ne të kemi një bazë shumë të fortë këtu në Kosovë për rritjen e Bankës si dhe për aspiratat në shërbime në të ardhmen.

Gjithashtu dëshiroj ta shpreh mirënjohjen time ndaj gjithë klientëve, partnerëve biznesor dhe aksionarëve tanë për rezultatet solide që i kemi arritur në vitin 2016.

Jacques Roger Jean Marie Rinino
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

2.2. Letër nga Drejtori ekzekutiv

Viti 2016 ishte një vit i mirë për TEB SH. A. Ne i kemi forcuar edhe më tej marrëdhëniet me klientë dhe vazhdimisht kemi mbajtur fokusin tonë në klientë. Si rezultat, ishim në gjendje që ta regjistrujmë fitimin neto më të lartë ndonjëherë të Bankës, prej më shumë se 18 milionë Euro.

Për Klientët tanë, Partnerët biznesor dhe Palët me interes,

At TEB SH. A. our mission - 'to continually create and increase outstanding value for customers, Në TEB SH. A. misioni ynë - 'në vazhdimësi të krijojmë dhe të rrisim vlerë të jashtëzakonshme për klientët, aksionarët, punonjësit dhe shoqërinë' - krijon bazën për çdo gjë që ne bëjmë. Kjo përfshinë besimin të cilin jemi duke ndërtuar me zgjerimin e sferës së klientëve tanë, futjen e inovacioneve në shërbimet financiare dhe mundësimin e rritjes në Kosovë. Që nga themelimi i saj, Banka ka luajtur një rol kyç në këtë ekonomi, që është duke treguar përparim të dukshëm për sa i përket tranzicionit në sistemin e bazuar në treg dhe në mbajtjen e stabilitetit makroekonomik, megjithëse në vitin 2016 ekonomia nuk ka mundur t'i arrijë të gjitha nivelet e nevojshme të rritjes. Zgjerimi i aktiviteteve dhe produktivitetit të sektorit privat janë të rëndësishme kritike për rritjen ekonomike afatgjate të vendit dhe sektori bankar ka rol të qartë për ta luajtur këtu. Ne e luajmë atë rol me dedikim dhe angazhim të të gjithë 580 punonjësve tanë, të mbështetur nga 26 degë në të gjitha qytetet, komunat dhe një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve të përshtatura.

Qëllimi ynë për vitin 2016 ka qenë të arrijmë rritje të dukshme me rrezik të balancuar. Kjo strategji e rritjes, e kombinuar me ruajtjen e kënaqësisë së klientit si objektivi kyç, ka sjellë performancë të jashtëzakonshme dhe me fitim, përderisa u ruajt pozicioni ynë në treg. Menaxhimi i vazhdueshëm i matur i portfolios, rreziku ynë i balancuar mirë dhe strategjia e rritjes kanë rezultuar në fitime të jashtëzakonshme dhe rritje të qëndrueshme në portfolion tonë të kredive. Në fund të vitit 2016, asetet totale të Bankës kanë arritur në 430 milion Euro dhe portfolio bruto i kredive është rritur në 352 milion Euro.

TEB SH. A. dhe prindërit e saj, TEB dhe BNP Paribas, ndajnë të njëjtat vlera, duke përfshirë fokusin pro-aktiv në përgjegjësitë korporative dhe shoqërore. Gama e produkteve, shërbimeve dhe aktiviteteve në vijim janë tregues se TEB SH. A. i përkthen ato në vegla inovative që reflektojnë angazhimin tonë që gjithmonë t'i parashohim dhe t'i plotësojmë nevojat e klientëve:

- Rishtazi, ne kemi lansuar Kartelën për Gratë Ndërmarrëse për t'i mbështetur gratë në biznes;
- Gjatë vitit 2016 Banka ka vazhduar të investojë në nën-segmentet e NVM-ve që ndërlidhet fuqimisht me zhvillimin ekonomik të vendit, si Agro-bizneset, Ndërmarrësit dhe Ndërmarrësit e Femrave;
- Në Agro-biznes kemi vazhduar t'i promovojmë prodhuesit dhe bujqit vendorë duke organizuar panairë dhe ngjarje për ta ngritur vetëdijen për ushqimin vendor. Përveç panairëve për ekspozimin e produkteve bujqësore, kemi organizuar një ngjarje të re për ta festuar verën 'Beaujolais Nouveau'.

Partneriteti ynë strategjik me brendin e njohur globalisht që është BNP Paribas, gjithashtu na motivon dhe e forcon aftësinë tonë për t'i interpretuar në mënyrë të saktë kushtet në tregun global dhe për t'i përshtatur shumë shpejt strategjitë tona korporative në përputhje me rrethanat.

Në terme të natyrës evoluese të rregullimit të sektorit financiar, fokusit thelbësor në infrastrukturë dhe pajtueshmërisë më të madhe rregullative, viti i kaluar ishte larg të qenit një vit tipik. Çdo ditë e më tepër, pajtueshmëria është duke u bërë pikë vendimtare ku kryqëzohen strategjia dhe veprimet e përditshme të Bankës dhe të klientëve tanë. TEB SH. A. është duke e mbajtur hapin me kërkesat rregullative në rritje për të parashikuar dhe akomoduar çdo ndikim në pozitën tonë si ofrues me reputacion shumë të mirë dhe i besueshëm i shërbimeve financiare.

Në terme të inovacioneve biznesore dhe trendeve në digjitalizim, TEB SH. A. është duke i transformuar produktet dhe shërbimet e saj bankare në digjitale. Banka do të vazhdojë të gjenerojë shumë praktika inovative në treg. Partneriteti ynë strategjik me brendin e njohur globalisht që është BNP Paribas, gjithashtu na motivon dhe e forcon aftësinë tonë për t'i interpretuar në mënyrë të saktë kushtet në tregun global dhe për t'i përshtatur shumë shpejt strategjitë tona korporative në përputhje me rrethanat.

Mobile Banking i TEB-it është shërbim i synuar për personat që kërkojnë modele të reja të shërbimeve financiare bazuar në thjeshtësi, transparencë dhe përvojë shoqërore. Gjatë vitit 2016 ne kemi lansuar këtë shërbim të ri të mbështetur nga një gamë gjithëpërfshirëse e shërbimeve financiare të dizajnuara posaçërisht për mjedisin mobil. Është në dispozicion në sistemet IOS si dhe Android.

Në mënyrë që të rritet niveli i sigurisë për shërbimet e-commerce, është zbatuar 'Visa 3D Secure' për t'i mbrojtur mbajtësit e kartelave nga rreziqet në internet. Kjo është një nga metodat më të reja për parandalimin e mashtrimit në transaksionet online.

Gjithë ky inovacion, orientimi ynë nga klienti dhe performanca e fuqishme financiare edhe një herë i kanë ndihmuar TEB-it që ta marrë çmimin 'Banka e Vitit 2016 në Kosovë' nga revistat Bankers dhe Global Finance. Për më tepër, TEB SH. A. gjithashtu ka marrë shpërblim për "Programin e Grave Ndërmarrëse" nga Global Banking Alliance GBA - konsorcium kryesore ndërkombëtar i institucioneve financiare dhe organizatat tjera të interesuar në ndërtimin e pasurisë së gruas në mbarë botën. Këto çmime prestigjioze rikonfirmojnë aftësinë e bankës për t'iu përgjigjur nevojave financiare vazhdimisht në ndryshim të klientëve tanë, si dhe besnikërinë dhe besimin e tyre në institucionin tonë.

Do të dëshiroja të përfitoj nga ky rast që ta shprehë mirënjohjen time të singertë për anëtarët e ekipit tonë. Të gjitha këto rezultate janë arritur nga ta. Kam besim të plotë se sukseset tona do të vazhdojnë në vitin 2017 dhe tutje.

Ayhan Albeyoglu
Drejtori Menaxhues

TEB Sh. A në 2016

TEB-i në shifra	2016	2015	Rritje/ (Rënie)	Përqindje
Indikatorët e Bilancit të Gjendjes				
Gjithsej mjetet	429,255	410,576	18,679	4.5%
Gjithsej kreditë (bruto)	352,695	340,215	12,480	3.7%
Depozitat	334,467	342,878	-8,411	-2.5%
Ekuiteti i aksionarëve	71,324	52,991	18,333	34.6%
Kreditë jo-performuese / Gjithsej kreditë	6.2%	7.1%	- 0.9%	-13.4%
Kreditë / Gjithsej mjetet	82.2%	82.9%	-0.7%	-0.8%
Raporti i mbulimit të kredive jo-performuese	94.2%	93.2%	1.0%	1.10%
Indikatorët e pasqyrës së të ardhurave				
Të hyrat neto nga interesi	29,036	30,343	-1,307	-4.3%
Të hyrat neto nga jo-interesi	6,276	6,350	-74	-1.2%
Raporti kosto / të hyra	48.4%	44.1%	4.3%	9.8%
Neto të hyrat bankare	35,694	37,041	-1,347	-3.6%
Neto fitimi vjetor	18,333	17,336	997	5.8%
Raportet e rentabilitetit				
Kthimi në ekuitet	35.7%	51.1%	-15.3%	-30.0%
Kthimi në mjete	4.3%	4.2%	0.0%	1.2%
Të hyrat neto nga interesi / Mjetet mesatare që krijojnë interes	8.3%	9.3%	-1.1%	-11.4%
Raportet e likuiditetit dhe solvencës				
Raporti i adekueshmërisë së kapitalit	15.9%	16.7%	-0.8%	-4.9%
Mjetet likuide / gjithsej mjetet	19.5%	21.3%	-1.9%	-8.9%
Mjetet e peshuara të rrezikut	479,976	349,247	130,729	37.4%
Indikatorë të tjerë				
Degët	26	26	0	0.0%
Punonjësit	580	585	-5	-0.9%

3.2. Indikatorët Kyç Financiar

Portfolio e kredisë e diversifikuar dhe menaxhuar siç duhet, optimizimi i mëtejshëm i kostos së operimit dhe inovacionet e vazhdueshme të produktit, përforcuan pozitën e Bankës si një lojtar kyç në tregun e Kosovës.

Në fund të vitit 2016, mjetet totale të Bankës arritën në €429.3 milionë, duke shënuar rritje prej €18.7 milionë apo 4.5% në krahasim me vitin 2015, duke mbajtur madhësinë e mjeteve të bankës në nivelin e synuar. Portfolio e kredisë bruto është rritur në €352.7 milionë, që është një rritje prej 3.7% apo një rritje e vëllimit prej €12,5 milionë në performancën e vitit të kaluar. Kreditë bruto tani përbëjnë 82.2% të mjeteve totale të Bankës në bilancin e gjendjes së TEB-it.

4.5%

€18.7M
Rritje e asetëve
(€429.3M total)

34.6%

€18.3M Rritje në
kapitalin aksionar
(€71.3M total)

Raporti i Kredive Jo-Performuese (KJP) (kreditë mbi 90 ditë në vonesa në këste) në fund të vitit 2016 ishte 6.1%, krahasuar me 7.1% në vitin 2015, një rënie prej gati 100 pikë bazë për shkak të menaxhimit më të mirë të KJP-ve dhe praktikave të përmirësuara të kredive të Bankës. Depozitat e klientëve në total në fund të vitit 2016 arritën në € 334.5 milionë, që është një rënie prej €8.4 milionë ose 2.5% në krahasim me fundin e vitit 2015.

Gjatë muajit dhjetor 2016, është nënshkruar një marrëveshje me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Gratë në Programin e Biznesit në vlerë prej €5 milionë.

Ekuiteti i aksionarëve është rritur nga € 53.0 milionë në vitin 2015 deri në € 71.3 milionë në vitin 2016, për shkak të rritjes së fitimeve të mbajtura gjatë vitit. E gjithë kjo paraqet një rritje prej 34.6% në ekuitetin aksionar në krahasim me vitin 2015.

Indikatorët e pasqyrës së të hyrave po ashtu tregojnë qëndrueshmëri në performancë ngjashëm me vitin e kaluar me një rënie marginale. Të hyrat neto nga interesi arritën €29.0 milionë, €1.3 milionë rënie ose 4.3% në krahasim me vitin 2015, pasi që normat e interesit për kredi kanë vazhduar trendin rënës. Të ardhurat neto nga jo-interesi arritën në € 6.3 milionë, një rënie prej €0.1 milionë ose një rritje prej 1.2% në krahasim me vitin 2015.

Raporti i kostos me të hyrat në vitin 2016 është rritur më tej në 48.4% nga 44.1% në vitin 2015, për shkak të rënies së të hyrave nga interesi dhe rritjes së investimeve në projekte të efektshmërisë. Të hyrat neto bankare në fund të vitit ishin € 35.7 milionë krahasuar me € 37.0 milionë realizuar në vitin 2015, përsëri kryesisht të ndikuara nga rënia e normave të interesit të kredisë.

Banka përfundoi vitin me €18.3 milionë të fitimit pas tatimit krahasuar me €17.3 milionë në vitin 2015 ose rritje prej 5.7%.

Në aspektin e treguesve të rentabilitetit, në fund të vitit 2016, Banka ka gjeneruar një Kthim në Kapital (KNK) prej 35.7% krahasuar me 51.1% në vitin 2015, kryesisht si rezultat i rritjes së ekuitetit të aksionarëve për shkak të fitimeve të mbajtura të vazhdueshme. Kthimi në Mjete (KNM) ishte 4.3% krahasuar me 4.2% në vitin e kaluar. Raporti i Interesit Neto ndaj Mjeteve Mesatare që Krijojnë Interes ishte 8.3%, krahasuar me 9.4% në vitin e kaluar.

Sa i përket menaxhimit të kapitalit bankar në fund të vitit 2016, Raporti i Adekueshmërisë së Kapitalit të Bankës (RAK) ishte 15.9%, duke tejkaluar kërkesën minimale të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) prej 12%.

Raporti i Mjeteve Likuide ndaj Mjeteve totale ishte 19.5% në fund të vitit 2016 krahasuar me 21.4% në vitin 2015, përderisa Mjetet e Peshuara të Rrezikut (APRr) arritën në €480,0 milionë, nga € 349.2 milionë në vitin e kaluar pas rritjes së portfolios së kredisë gjatë vitit 2016.

Në vitin 2016, Banka ka mbajtur numrin e degëve deri në 26, ndërsa numri i punonjësve ka zbritur në 580 krahasuar me 585 në fund të vitit 2015.

Banka përfundoi vitin
me €18.3M fitim pas tatimit
në krahasim me €17.3M në 2015
Rritje prej 5.8%

Njësitë e biznesit

4.1. Shërbimet bankare për individë

Shërbimet bankare për Individë të TEB SH. A. janë vazhdimisht të angazhuara në identifikimin, zhvillimin dhe ofrimin e produkteve inovative bazuar në nevojat e vërteta të klientëve. Suksesi ynë në plotësimin e këtyre nevojave përmes përvojës së shkëlqyer të klientit është e qartë përmes rritjes sistematike në bazën tonë të klientëve. Në vitin 2016 ajo është rritur për 6.8%.

Përgjatë vitit 2016, jemi përpjekur vazhdimisht që të jemi inovativ dhe t'i ofrojmë klientëve tanë produkte optimale me kohë. Përveç zgjerimit të gamës së produkteve tona optimale, dhe sikur vitin e kaluar, Shërbimet bankare për individë të TEB SH. A. vazhdojnë të bëjnë oferta atraktive të kredive për punonjësit e sektorit privat dhe klientët e shërbimeve bankare private. Si rezultat i fushatave të kredive dhe përmirësimeve në sistem, ne kemi pasur mundësinë ta rrisim pjesën tonë në treg në 22% me 13.8 milion Euro rritje neto në kreditë për individë. Fushata jonë unike në vitin 2016 ka përfshirë:

- Fushatat për kredi hipotekare me kompanitë më të njohura të ndërtimit të komplekseve ndërtimore;
- Kredi për blerjen e veturave të markave të njohura botërore, si Renault, Nissan, Mercedes, Range Rover, Ford, Dacia, Suzuki dhe Hyundai;
- Kemi vazhduar t'i mbështesim të rinjtë përmes fushatave për kredi për arsim.

Aktivitetet kryesore të Shërbimeve bankare për individë, përfshijnë:

- Përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të dizajnuara për segmente të ndryshme të klientëve, monitorimin e tregut dhe kryerjen e analizës së ndikimit të çfarëdo ndryshimi në mjedisin konkurrues.

- Përmirësimin e proceseve teknologjike dhe operacionale lidhur me shërbimet bankare për individë.
- Monitorimin, vlerësimin dhe planifikimin strategjik për ta zhvilluar linjën biznesore.
- Ofrimin e produkteve dhe shërbimeve bankare përmes degëve dhe kanaleve digjitale (internet, telefon mobil).
- Rritjen e pjesës së tregut të TEB SH. A. përmes degëve të reja dhe bankomatëve të ri, përderisa në të njëjtën kohë bëjmë ofrimin e zgjidhjeve inovative përmes koncepteve të degëve të reja dhe bankomatëve të ri për t'i plotësuar nevojat në ndryshim të klientëve.
- Zhvillimin e produkteve të reja kreditore, të depozitave dhe produkteve tjera përmes perspektivës inovative të fokusuar në klientë dhe monitorimin nga afër të performancës së produktit për ta rritur pjesën tonë në treg.

Shërbimet bankare private

Shërbimet me privilegje të dizajnuara për t'i prekur jetët e klientëve tanë

Shërbimet bankare private ofrojnë zgjidhje financiare optimale për klientë privatë bankarë bazuar në qasje të shërbimit të personalizuar që përfshinë produkte dhe shërbime bankare veçanërisht të përshtatura për të cilat klientët kanë nevojë në faza të ndryshme të jetës së tyre - e gjitha kjo përmes rrjetit tonë të gjerë dhe me shumë kanale të shpërndarjes.

Kanalet alternative të shpërndarjes

Çdo vit, TEB SH. A. i shton funksionalitete rrjetit të saj inovativ të shërbimeve bankare me shumë kanale, duke përfshirë E- banking, Qendra të Thirrjeve, Shërbimet me SMS, Bankomatë dhe Terminale POS. TEB-i në mënyrë sistematike identifikon kanalet e rëndësishme strategjike dhe vazhdon me investime në shërbimet bankare që nuk

bëhen në degë, siç është Mobile Banking i TEB-it. TEB SH. A. ka krijuar një model të ri plotësisht të digjitalizuar bazuar në avancimet më të reja teknologjike. Ndërsa krijojmë një përvojë më të mirë për klientin, me Mobile Banking të TEB-it ne gjithashtu kemi për qëllim që ta thjeshtojmë procesin dhe interfejsat për t'i zvogëluar kostot e degës përmes migrimit digjital dhe përfitimit të klientëve të ri.

Mobile Banking i TEB-it është i synuar për klientët që kërkojnë model të ri të shërbimeve financiare bazuar në thjeshtësi, transparencë dhe përvojë shoqërore. Është lansuar në vitin 2015 me ofertë gjithëpërfshirëse të shërbimeve financiare veçanërisht të dizajnuar për mjedisin mobil.

Marketingu përmes medieve sociale është pjesë e të bërit biznes në mileniumin e ri dhe TEB-i nuk bën përjashtim kur vjen te përdorimi i këtyre kanaleve për ta krijuar komunikimin një-me-një me klientët tanë. Ne kemi prezencë në një numër të konsiderueshëm të rrjeteve të medieve sociale siç janë Twitter, LinkedIn, Instagram, YouTube. Dhe tashmë kemi 139.000 llajka në Facebook.

Ç'ka më tutje?

TEB SH. A. është natyrshëm e përqendruar në klientë dhe kujdesi ndaj klientit është kyç. Çdo gjë që ne bëjmë është e fokusuar në klientët tanë, nga zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve relevante deri tek krijimi i infrastrukturës teknologjike për t'i mbështetur ato. Banka do të vazhdojë të bëjë investime të mëdha në përmirësimin e efikasitetit të proceseve të brendshme. Dhe fokusi ynë vitin e ardhshëm përsëri do të jetë përforcimi i mëtutjeshëm i të gjitha proceseve tona biznesore ashtu që të vazhdojmë ta përmirësojmë efikasitetin dhe kënaqësinë e klientit.

4.2. Biznesi i kartelave

Me mbi 11,000 kartela të reja të miratuara gjatë vitit 2016, StarCard mbetet kartela e kredisë më e përdorur dhe më e preferuar në treg. Pozita jonë si zgjedhja e parë e klientit na jep një përgjegjësi edhe më të madhe për të qenë kudo që janë klientët tanë dhe për t'i dëgjuar në mënyrë aktive nevojat e tyre. Kompetenca, ekspertiza, dëgjimi aktiv dhe aftësia e zbatimit pa rivalitet u dëshmuar sërish si çelësi për një tjetër vit të shkëlqyer për biznesin tonë. Duke kombinuar nevojat e klientëve me zhvillimet e reja teknologjike, kemi vazhduar të prezantojmë produkte të reja, shërbime të zgjeruara dhe kanale të reja të shfrytëzimit në mënyrë që klientët tanë të mund të kryejnë transaksione bankare me komoditet, kudo qofshin dhe pa kufizimet e imponuara nga orari tradicional i ofrimit të shërbimeve bankare.

Debit kartela e TEB-it i ndihmon klientët që ta menaxhojnë paranë e tyre të gatshme duke iu treguar se sa dhe ku kanë shpenzuar në pasqyrën e bilancit të gjendjes që ua dërgon banka. Për më tepër, klientët mund të kenë qasje në shërbimin e mbitërheqjes. Bilanci mund të kontrollohen dhe mund të bëhet tërheqja 24/7 përmes rrjetit tonë të bankomatëve të shpërndarë në gjithë Kosovën. Blerja gjithashtu është bërë më e lehtë pasi që Debit kartela e TEB-it ofron qasje në rrjetin më të madh në vend të terminaleve POS (Pikat e shitjes) ku klientët tanë mund ta përdorin kartelën për të paguar për blerjet pa komision. Çdo transaksion i bërë përmes debit kartelës përbrenda rrjetit të terminaleve POS të TEB-it shpërblehet me pikë të bonusit.

Në mënyrë që edhe më tej ta lehtësojmë shërbimin e klientit dhe përveç kartelave tona Visa, tani MasterCard pranohet në терминалет POS dhe bankomatët e Bankës TEB duke përdorur teknologjinë më të re pa kontakt. TEB-i i ka mbi 4,000 терминалет POS dhe 80 Bankomat që gjithashtu japin

qasje në rrjetet e Bankomatëve, Terminaleve POS dhe e-commerce në mbarë botën e që ndihmon në thjeshtëzimin e blerjeve dhe transaksioneve tjera. Pagesat online përmes Debit kartelës është një shërbim tjetër inovativ i futur në funksion në vitin 2016. Numri i transaksioneve përmes terminaleve POS është rritur për 16% në krahasim me vitin e kaluar. Krenohemi me faktin se klientët janë shumë të kënaqur me shërbimet tona. Kjo ka çuar në depërtim edhe më të madh në treg dhe, në fund të viti 2016 banka jonë ka lëshuar 75% të të gjitha kredit kartelave aktive në Kosovë. Tarifat dhe komisionet tona që lidhen me mirëmbajtjen dhe përdorimin e kartelave mbeten shumë konkurruese në treg dhe, gjithashtu ofrojmë një gamë të shumëfishtë të transaksioneve pa pagesë, si pagesat online dhe blerjet ndërkombëtare me kredit kartelë.

Me një bazë klientësh në rritje, nevoja për të garantuar shërbime më të mira është prioritet. Prandaj, kemi zgjeruar ekipin e shitjes direkte dhe aktivitetet e tij. Tani, jemi edhe më afër klientëve dhe të aftë për t'iu përgjigjur më shpejt dhe më besueshëm nevojave të tyre. Ekipi i shitjeve direkte është gjithashtu në dispozicion për të ofruar informata për ofertat speciale për të cilat klienti mund të ketë të drejtë përdorimi. Gjithashtu, këshillon klientët mbi produktet dhe shërbimet e reja në dispozicion nga banka dhe që ne mendojmë se mund të jenë me interes dhe përfitim për ta. Gjatë gjithë vitit dhe në partneritet me tregtarët, Banka ka iniciuar fushata të shumta të personalizuar, duke ofruar propozime të ndryshme që paraqesin plane shtesë të pagesave, zbritjeve, periudha grace dhe produkte bonus. Ne jemi mirënjohës për besnikërinë e klientëve tanë, prandaj sërish kemi shpërndarë mbi 500.000 € në pikë bonusi në kartela ose si bonuse në forma të tjera.

TEB-i ka investuar shumë në siguri të avancuar për rrjetin tonë të infrastrukturës. Kjo menaxhohet në mënyrë të sigurt dhe

efektive nga ekipi ynë shumë vigjilent i monitorimit në kohë reale. Teksa teknologjia bëhet gjithnjë e më e sofistikuar, mashtrimi me kartela në të gjithë botën po përhapet me ritëm dinamik. TEB-i ka investuar shumë në siguri të avancuar për rrjetin tonë të infrastrukturës. Besojmë se siguria e transaksioneve është padyshim një nga sukseset tona, sepse transaksionet mashtruese në tentativë duke përdorur kartelat tona dhe në rrjetin tonë mbeten konsiderueshëm nën trendet e sektorit. Avancimi më i fundit është sistemi i Sigurisë 3-D të cilin e kemi lansuar gjatë vitit 2016. Ky sistem siguron që çdo transaksion i kryer nga shitësit që mbajnë logon e autentikuar 'Verifikuar nga VISA' shkon përmes procesit 3DS. Klientët gjithmonë do ta pranojnë fjalëkalimin e autorizimit kur të bëjnë blerje në këtë mënyrë. Nëse shitja bëhet tek shitësit jashtë rrjetit të Sigurisë 3D, atëherë transaksioni do të lejohet. Megjithatë, për t'iu shmangur çfarëdo keqpërdorimi të mundshëm, ne e kemi përcaktuar limitin ditor për transaksione të tilla. Kjo i limiton blerjet me debit kartelë.

Mediat sociale kanë pasur ndikim të pa masë në kulturën tonë, biznesin, në tërë botën në përgjithësi. Prandaj, ne e kemi rritur vetëdijen për brendin tonë përmes fushatave aktive në mediat sociale, veçanërisht në faqen e admiruesve tanë në Facebook për 'StarCard'. Ne kemi arritur rritje prej 33% në numrin e llajkave në krahasim me vitin e kaluar. Rezultati ynë ditor mesatar gjatë vitit 2016 ka qenë 20,000 shikime ndërsa kërkimet nga njerëzit për StarCard në Facebook kanë qenë rreth 350 herë për çdo ditë. Gjatë vitit 2016, kemi organizuar rreth 240 fushata, 105 nga to me tregtarë të veçantë ndërsa pjesa tjetër, rreth 140 nga to, kanë qenë fushata të përgjithshme. Ne kemi shfrytëzuar mediet sociale për t'i reklamuar produktet tona, për ta ndërtuar lojalitetin e klientëve dhe për shumë funksione të tjera. Ndërveprimi me dhe informata

prapa-kthyesë nga klientët tanë e kanë ndihmuar Bankën që ta kuptojë tregun, dhe t'i përshtatim produktet dhe strategjitë tona. Në krahasim me reklamat në televizion dhe format e tjera të shtrenjta të marketingut, prezenca në mediet sociale është vegël (kosto-) efektive për ta rritur imazhin dhe popullaritetin e brendit.

Në vitin 2016 dhe si pjesë e përgjegjësisë sonë shoqërore, kemi vazhduar të rekomandojmë fuqishëm opsionin e pasqyrës së bilancit të gjendjes në formë elektronike për klientët. Toka është e vjetër 4.6 miliardë vjet. Ta zvogëlojmë këtë në 46 vjet. Ne jemi këtu që 4 orë. Revolucioni ynë Industrial ka filluar para 1 orë. Brenda kësaj kohe ne i kemi shkatërruar më shumë se 50% të pyjeve të tokës. Kjo nuk është e qëndrueshme. Prandaj, edhe pse kjo mund të konsiderohet vetëm një gjest i vogël në ruajtjen e pyjeve dhe drunjve, ne kemi vendosur ta ndryshojmë këtë duke zvogëluar shfrytëzimin e letrës dhe tani mbi 80% të pasqyrës së bilancit të gjendjes dërgohet në mënyrë elektronike përmes emailit. Kjo do të thotë se në vitin 2016 janë shpëtuar mbi 395 drunj.

Ç'ka më tutje?

Sipas statistikave të besueshme, ka pasur një rritje të madhe të shitjeve online përgjatë dy viteve të kaluara. Llogaritet se një biznes që inkorporon platformën e-commerce mund t'i rrisë të hyrat e veta për deri në 250%. Kjo për shkak të faktit se shumë njerëz preferojnë lehtësinë e qasjes dhe komoditetin që vjen me platformat e-commerce. Kjo është veçanërisht e vërtetë për ato sisteme që mund të procedojnë pagesa me kredit kartela. Duke marrë parasysh këtë trend të rritjes në mbarë botën, TEB SH. A. vendosi që të investojë në digjitalizimin e pjesës më të madhe të shërbimeve tona. Ne më tutje planifikojmë t'iu ofrojmë tregtarëve tanë dhe shitësve me pakicë platformën e-commerce ku ata do të mundën t'i shesin produktet e tyre online.

Është e qartë se e-commerce sjellë mjaft komoditet për sa i përket pagesave. Kjo ndihmon në rritjen e transaksioneve të klientëve dhe gjithashtu blerësve impulsiv. Ri rezultat, ne kemi për ditë e më shumë kontakte me klientë potencialë për Bankën. Disa nga përfitimet shitesë për bizneset që shesin online përfshijnë mundësinë të jenë të hapura 24/7 pa asnjë rritje të kostove variable ose që dikush të duhet të jetë prezent fizikisht për t'i pranuar pagesat pasi që çdo gjë mund të bëhet online. Një biznes që operon ekskluzivisht jashtë internetit mund të ketë vështirësi në kontaktin me një gamë më të gjerë të klientëve. Për më tepër, e-commerce dhe pagesat mobile kanë parë rritje të paprecedentë në vitet e fundit. Shumë analistë kanë vlerësuar se deri në vitin 2017, industria e pagesave mobile do të vlejë 1 trilion dollar amerikan. Si përgjigje, bankat kryesore në botë i kanë dhënë pagesave mobile, shërbimeve bankare mobile dhe shërbimeve bankare online prioritetin më të lartë bashkë me iniciativat tjera të TI-së.

Gjithashtu, do ta zbatojmë Përgjigjen interaktive zanore (Interactive Voice Response (IVR)) si një teknologji që ia mundëson kompjuterit bashkëveprimin me klientët tanë nëpërmjet përdorimit të inputeve zanore dhe tonale nëpërmjet tastierës.

Duke përdorur qasjen një-madhësi-u-bie-të-gjithëve në bazën e mbajtësve tuaj të kartelave nuk i reflekton realitetet e tregut të sotëm. Segmentet e ndryshme të mbajtësve të kartelave kanë sjellje, motivime dhe pritje shumë të ndryshme për sa i përket asaj se si i shfrytëzojnë opsionet e pagesave. Prandaj, për vitin e ardhshëm jemi duke planifikuar segmentimin/diferencimin e kartelave ashtu që të mund t'i qasemi këtyre grupeve specifike të klientëve bazuar në sjelljen e shfrytëzimit të tyre të kartelës.

Objektivi ynë është të lehtësohet procesi i pagesave dhe të rritet siguria kundër mashtrimit me kartela për këto transaksione. Për ta rritur sigurinë e pagesave me kartela bashkë me karakteristikat tjera që ofron MasterCard, ne gjithashtu do të fillojmë të lëshojmë MasterCard. Në anën e shitësve kemi për qëllim rritjen e numrit të tregtarëve në këta sektorë me mbulesë të ulët, ndërsa në anën e klientit do ta rrisim bazën duke ofruar MasterCard.

4.3. Shërbimet bankare për NVM

TEB SH. A. E lehtëson të bërit biznes për NVM-të, bujqit dhe bizneset bujqësore

Gjatë vitit 2016, sektori i NVM-ve ka vazhduar të jetë një nga fushat e fokusit të Bankës pasi që pritet të luajë rol të rëndësishëm në zhvillimin e Kosovës duke gjeneruar rritjen, sigurimin e vendeve të reja të punës dhe inspirimin e modeleve inovative të biznesit për ekonomi. Nuk ka qenë befasi, që konkurrenca ndërmjet bankave për rritjen e pjesës në këtë segment interesant të tregut ka qenë e lartë, e që ka rezultuar me ndikim në normat mesatare të interesit. TEB-i e ka mbajtur fokusin për t'u bërë banka e preferuar e sektorit të NVM-ve përmes qasjes proaktive, reaguese dhe inovative ndaj kërkesave të klientëve.

Përgjatë gjithë vitit raportues, Banka ka marrë një numër të konsiderueshëm të vendimeve të segmentimit strategjik që pritet të gjenerojnë efikasitet dhe të përmirësojnë cilësinë e portfolios. Pas analizës së kujdesshme të portfolios sonë, ne vendosëm që ta bëjmë tërheqjen nga segmenti i ulët i klientëve mikro me qarkullim vjetor prej nën 1.2 milion Euro, duke e rritur fokusin në NVM-të që gjenerojnë së paku 2 milion Euro në vit. Me këtë lëvizje, ne kemi për qëllim të tërheqim klientë NVM më të konsoliduar me sisteme të standardizuara të raportimit,

kapacitet më të lartë të punësimit dhe prospekt më të madh për rritje. Ky ndryshim në segmentim qartazi ka pasur efekt në normën e rritjes së portfolios. Megjithatë, efikasiteti i rritur do të thotë se krahasuar me vitin 2015, Banka deri tani ka menaxhuar të sigurojë një rritje të përgjithshme prej 3.2 milion Euro të shumës së kredisë.

Si në vitet e kaluara, gjatë vitit 2016 TEB-i ka vazhduar të investojë në nën-segmentet e NVM-së që ndërlidhet fuqishëm me zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo është arsyeja përse Agro-biznesi, Ndërmarrësia dhe Ndërmarrësia e Grave mbesin fokus për ne. Në Agro-biznes kemi vazhduar t'i promovojmë prodhuesit dhe bujqit vendorë duke organizuar një numër të konsiderueshëm të panairëve dhe ngjarjeve të specializuara për ta ngritur vetëdijen për ushqimin e prodhuar në vend. Një panair i ka ekspozuar produktet bujqësore, ndërsa një tjetër ka promovuar prodhimin e verërave lokale, që konsiderohet si nën-sektor me potencial eksportues për Kosovën. Ne kemi mbështetur disa projekte dhe ndërmarrje të agro-biznesit me anë të financimit, që ka rezultuar me 13.5% në portfolion e kredive të papaguara.

Banka e kupton dhe e njeh rëndësinë e kulturës së ndërmarrësisë në zhvillimin e përshpejtuar ekonomik për vendin. Është shumë e rëndësishme që vlerat e ndërmarrësisë të mbillen në të gjitha segmentet e shoqërisë e veçanërisht në mes rinisë e cila ka fuqi të madhe transformuese për ekonominë. Për këtë arsye, ne kemi sponsorizuar 'Programin Ye! Kosova Boost' të organizuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) dhe 'Kampin e ndërmarrësisë' (Entrepreneurship Bootcamp) të iniciuar nga Jakova Innovation Centre (JIC). Këto ngjarje kanë ofruar trajnim, mentorim dhe shpërblime për idetë më të mira nga një grup i përzgjedhur i ndërmarrësve të ri dhe ambiciozë.

Fokus i ngjashëm intensiv i është përkushtuar zhvillimit të programit të Grave ndërmarrëse që ka për qëllim stimulimin e pjesëmarrjes më të lartë të grave në biznes. Në këtë aspekt, linja kreditore e BERZH-it prej 5 milion Euro është shfrytëzuar plotësisht dhe një linjë e dytë për shumën e njëjtë është nënshkruar në dhjetor të vitit 2016. Në të njëjtën kohë, fushëveprimi i partneriteteve të ngjashme është zgjeruar pasi që Banka hyri në marrëveshje me agjencitë për zhvillim si 'GIZ' për trajnime dhe 'Swisscontact' në ofrimin e kredive deri në 3,000 Euro me 0% interes. Kjo qasje që kombinon qasje në financa me shërbime jo-financiare reflekton strategjinë tonë të zhvillimit për këtë treg. Përveç kësaj, për ta rritur tutje sferën e produkteve të ofruara për këtë grup të synuar, në gusht Banka ka lansuar kredit kartelën për 'Gratë Ndërmarrëse'. Kjo kredit kartelë me pamje të dallueshme ka për qëllim që ta reflektojë identitetin e veçantë të grave ndërmarrëse si pjesëmarrëse të reja në biznes.

Ç'ka më tutje?

Në nëntor kemi nënshkruar një marrëveshje e cila do ta rrisë qasjen e NVM-ve në financa në vitet e ardhshme. Duke bashkëpunuar me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) do të tejkalohen pengesat për financa të NVM-ve. Ndërmarrësit dhe NVM-të do të kenë qasje më të madhe në hipoteka dhe financa për biznes.

4.4. Shërbimet bankare komerciale dhe për korporata

Nëpërmjet marrëdhënieve të saja të afërta me klientët dhe qasjes së orientuar kah zgjidhjet, TEB SH. A. është një lojtar mjaft i dukshëm në segmentin komercial dhe të korporatave. Në TEB, e pranojmë se ky

segment i caktuar i klientëve është më i ndërlikuar për sa i përket nevojave dhe kemi zhvilluar një strategji të zgjidhjeve të përshtatura dhe të avancuara të shërbimeve të menaxhimit të parasë së gatshme për t'iu ofruar klientëve tanë një sistem të vlerës së shtuar që është me përfitim edhe për bankën. Si në vitet e mëparshme, strategjia jonë në vitin 2016 u përqendrua në rritjen e pjesës sonë të tregut dhe profitabilitetit. Kjo e fundit u dëshmuar të jetë sfiduese, sepse tregu diktoi një rënie të konsiderueshme në normat e interesit, ndërsa numri i kufizuar i klientëve në këtë segment kërkon një qasje proaktive nga Banka. Departamenti ka arritur një rritje prej 1.6 milion Euro në kredi, ose një rritje prej 2.3% në krahasim me vitin e kaluar. Tregu e vlerëson ofertën cilësore të Bankës në shërbime të tilla si transferet, pagesat përmes terminaleve POS dhe transaksionet e tjera. Ne kemi vazhduar të ofrojmë zgjidhje të avancuara të menaxhimit të parave të gatshme, siç është rrjeti i zgjeruar i terminaleve POS, debitit dhe kredit kartelat e dallueshme lidhur me biznesin dhe teknologjinë më moderne për biznes përmes e-banking me karakteristika dhe opsione të shumta. Zgjerimi i kanaleve alternative të ofrimit të shërbimeve dhe rritja e zgjidhjeve të menaxhimit të parave është një qasje e rëndësishme strategjike për vitet e ardhshme, sepse tregu i biznesit po kërkon partneritete më efikase dhe më të gjera. Një nga prioritetet e veçanta të Bankës në vitin 2016 ishte rritja e efikasitetit në operacione. Kemi investuar shumë kohë dhe përpjekje të konsiderueshme në promovimin e gamës së gjerë të opsioneve dhe përfitimeve të shumta që ofron e-banking për biznese. Kjo iniciativë ka rezultuar mjaft e suksesshme, sepse shumë klientë kanë filluar ta përdorin e-banking për nevojat e tyre të përditshme bankare. Si rezultat, 71% e totalit të transaksioneve të transfereve vendore janë kryer duke përdorur e-banking, me 66.3% të transfereve ndërkombëtare duke përdorur të njëjtin kanal. Ky ndryshim në sjelljen e

klientëve përbën një arritje të rëndësishme për departamentin, sepse zvogëlon ngarkesën e punës në degë dhe i mundëson ekipeve të degës të kalojnë më shumë kohë për këshillim dhe përkrahje për klientët. Në forcimin e marrëdhënieve me klientët, Banka ka vazhduar ofrimin e shërbimeve jo-financiare në formë të këshillave biznesore për klientët korporata. Kjo tregon se fusha e bashkëpunimit me klientët korporata është e kufizuar vetëm nga kreativiteti dhe imagjinata, pasi mundësitë janë të pafundme.

Ç'ka më tutje?

Kur shikojmë para për vitin 2017, parashohim një tjetër vit sfidues, sepse vendi po përballet me tensione politike dhe ka ende luhajtje në normat e interesit. Megjithatë, jemi të përkushtuar për rritjen e bashkëpunimit tonë me segmentin e korporatave dhe kemi një ide të qartë se si të arrihet ky objektivi. Si bankë, do të vazhdojmë të mbështetemi në inovacion dhe zgjidhje të përshtatura për ta arritur një pjesë më të madhe të biznesit të klientëve korporata dhe për ta rritur pjesën tonë të tregut dhe profitabilitetin. Në të njëjtën kohë, në mënyrë aktive do të synojmë projektet në sektorin e prodhimit dhe eksportit, sepse ata shihen si pika strategjike për rritjen e mëtejshme të korporatave dhe gjithashtu për rritjen e përgjithshme të ekonomisë.

4.5. Financat tregtare

TEB SH. A. e kupton se biznesi ndërkombëtar në një botë të globalizuar është sfidë - suksesi kërkon njohuri të gjera profesionale dhe rrjet efektiv. TEB-i i ka të dyja.

Gjatë viti 2016, kemi vazhduar t'i përkrahim klientët tanë duke krijuar dhe përshtatur zgjidhje të financave tregtare për nevojat e tyre të biznesit. Për më tepër, kemi punuar vazhdimisht në zgjerimin e rrjeteve tona, forcimin e marrëdhënieve me bankat e tjera,

dhe ngritjen e mëtejme të standardeve tona të larta të profesionalizmit dhe kompetencës. Përkrahur nga prania globale dhe ekspertiza në tregtinë ndërkombëtare e BNP Paribas dhe TEB A.Ş., ne vazhdimisht zgjerojmë mbulimin tonë gjeografik dhe gamën e produkteve tona.

Produktet e financave tregtare për operacionet e biznesit dokumentar përfshijnë letër kreditë e importit dhe eksportit, skontimin në letër kredi, garancitë vendore dhe ndërkombëtare, letër kreditë në pritje (stand-by) dhe arkëtimet. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2011 me programin e tregtisë së Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC-së) na ka dhënë një mundësi të shkëlqyer dhe më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur kërkesës në lidhje me letër kreditë e konfirmuara dhe kundër garancitë. Gjatë vitit raportues, gjithashtu kemi zgjeruar më tej marrëdhëniet tona me banka të reja korrespondente.

TEB SH. A. e ka mbajtur përkrahjen e vazhdueshme për klientët dhe synon të jetë gjithmonë partneri më i besueshëm dhe i preferuar i biznesit në Kosovë, duke vazhduar ta ndajë profesionalizmin dhe ekspertizën në produktet e financave tregtare me klientët tanë duke ofruar edhe zgjidhje inovative..

Ç'ka më tutje?

Vitin e ardhshëm, do të vazhdojmë t'i mbështesim klientët tanë, duke ofruar një urë të sigurt për mundësi të reja. Profesionalizmi dhe ekspertiza do të jenë udhëzuesit tanë, sepse i shohim këto si elemente që të bëjnë të dallueshëm në një botë që lëviz me shpejtësi. Në vitin 2017, gjithashtu synojmë të shtojmë produkte të reja të tregtisë ndërkombëtare në gamën tonë të produkteve.

4.6. Menaxhimi i parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave

Vizioni ynë është që të jemi banka më e mirë në Kosovë. Kjo është arsyeja pse jemi duke investuar shumë në kanalet alternative të shpërndarjes duke zhvilluar dhe përmirësuar platformën tonë të shërbimeve bankare elektronike e-banking

Në një kohë të progresit të shpejtë teknologjik, TEB-i jo vetëm që po e mban ritmin, por edhe i paraprin progresit në menaxhimin e parasë së gatshme dhe sistemet e pagesave, gjersa vazhdon të shtojë kanale të reja të pagesave dhe mundësi për shërbime më të mira. Menaxhimi ynë i parave të gatshme dhe zgjidhjet për pagesa janë përshtatur për t'iu ofruar klientëve tanë afaristë një gamë të produkteve dhe shërbimeve që do ta rrisin likuiditetin. Ne sigurojmë infrastrukturën e duhur për procedim të shpejtë dhe të sigurt të pagesave. Për më tepër, duke shfrytëzuar zgjidhjet tona të teknologjisë së fundit klientët tanë krijojnë kursime të kostos dhe përfitojnë nga kostot operacionale të optimizuara direkte dhe indirekte.

Sistemi i pagesave

TEB-i ka qenë e para që ka futur në funksion Sistemin e debitimit direkt (SDD), produkt unik në tregun e Kosovës që është e dizajnuar për të përkrahur bashkëpunimin komercial B2B (biznes me biznes). Funkcioni i saj kryesor është përmirësimi i likuiditetit financiar të klientëve tanë të biznesit duke ofruar menaxhimin e plotë të llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme. Ai konsiderohet si sistemi më efektiv i menaxhimit të rrjedhës së parasë pasi përkrahet nga teknologjia dhe interfejsat më të fundit që lehtësojnë procedimin e plotë dhe automatik të pagesës së faturave. Kjo i mundëson klientëve që të na autorizojnë

për të debituar (tërhequr) automatikisht mjete direkt nga llogaria e tyre bankare për të bërë pagesa të ndryshme mujore për kompani të ndryshme publike dhe private. Nevojitet vetëm një formular i autorizimit (i nënshkruar nga klienti) dhe transaksioni përkatës do të kryhet në mënyrë automatike. Klientët me SDD marrin linjë kreditore të dedikuara që mundëson pagesat për furnizuesit dhe garanton se kushtet e pagesës së faturës respektohen plotësisht. Hapi tjetër logjik ishte futja e skontimit të SDD-së që garanton të arkëtueshmet. Duke zbatuar skontimin e SDD-së, klienti konsolidon financat dhe përfiton nga arkëtimi i hershëm i të arkëtueshmeve. Shërbimi ynë ultra-modern online shfrytëzon sistemet më të avancuara të sigurisë dhe jep qasje 24/7 në shërbime bankare të sigurta, të përshtatshme dhe të shpejta. Klientët tanë mund t'i transferojnë fondet në mënyrë elektronike te përfituesit në mbarë botën dhe të procedojnë pagesa vendore, duke përfshirë pagesën e shërbimeve komunale dhe debi të tjera të rregullta, (si rryma, uji dhe telefoni). Për më tepër, klientët mund t'i kryejnë pagesat për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) në mënyrë automatike duke përdorur e-banking. Projekti i PBKR - Sistemit të Pagesës Bruto në Kohë Reale ka përfunduar me sukses në korrik të vitit 2016 dhe të gjitha pagesat vendore duke përfshirë pagesat në vlera të larta tani procedohen në kohë reale.

Në ditët e sotme, transferet e shpejta dhe të sigurta ndërkombëtare të parave janë me rëndësi të madhe për klientët me ambicie përtej shtetërore. Kjo është arsyeja pse ofrojmë një shërbim që është mënyra më e lehtë, më e shpejtë dhe më e besueshme për të bërë pagesa ndërkombëtare. Nëpërmjet rrjetit tonë të gjerë me mbi 50 marrëdhënie të huaja korrespondente dhe 10 banka për plasim, pagesat ndërkombëtare dalëse mund të kryhen për përfituesit e huaj në të gjithë botën. Si anëtar i SWIFT-it,

rrjetit më të madh në botë të pagesave, klientët tanë gëzojnë një përparësi të qartë, sidomos në pagesat ndërkombëtare dalëse. Pagesat ndërkombëtare hyrëse mund të menaxhohen duke përdorur të njëjtin sistem. Kjo do të thotë që jemi në gjendje të ofrojmë shërbime të pagesave që janë udhëheqëse në treg, gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të brendshme shumë efektive dhe përmes zgjerimit të vazhdueshëm të rrjetit tonë global.

Në vitin 2016, përsëri kemi marrë një çmim për cilësinë e lartë të pagesave tona ndërkombëtare dalëse nga KBC Bank NV, Belgjikë. Ne arritëm normën e jashtëzakonshme prej 98% STP. Ky çmimi i ka njohur transaksionet në vitin 2015.

4.7. Thesari dhe MPD (menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve)

Departamenti i thesarit dhe MPD-së i TEB SH. A. është përgjegjës për menaxhimin në mënyrë efektive të rrjedhës së parasë dhe rreziqeve të bilancit të gjendjes së Bankës dhe në pajtim me limitet e përcaktuara nga rregullatorët ndërkombëtarë dhe vendorë. Roli i Departamentit është thelbësor për ta siguruar vazhdimësinë e operacioneve ditore të Bankës dhe për t'u siguruar se ato janë në linjë me nivelet e identifikuara të rrezikut, e që kërkon përshtatje të vazhdueshme ndaj zhvillimeve dhe pritjeve në treg dhe ekonomi.

Është shumë e rëndësishme që Banka të ketë nivelin e kërkuar të likuiditetit në të gjitha valutat aktive për të qenë në shërbim të klientëve të saj nëse kërkohet dhe që të mund t'i përmbushë të gjitha detyrimet e saj me koston më të vogël të mundshme. Kjo arrihet përmes rrjedhës ditore efektive të parasë dhe menaxhimit afatgjatë të likuiditetit duke përdorur qasjen ekskluzive

të Departamentit në kapitalin dhe tregjet e parasë edhe vendore e edhe ndërkombëtare.

Rreziqet e hendeqeve të normës së interesit dhe të FX-it në bilancin e gjendjes që janë të natyrshme për shkak të natyrës së biznesit gjithashtu menaxhohen nga Departamenti duke përdorur instrumente të ndryshme në dhe jashtë bilancit të gjendjes për mbrojtje nga humbjet e mundshme.

Gjatë kryerjes së funksionit të vetë, Thesari dhe MPD-ja janë shumë të vetëdijshme për rrezikun në përputhje me qasjen e përcaktuar dhe të kujdesshme të Bankës. Si rezultat, Departamenti punon për ta mbajtur përzierjen optimale të fondeve përmes menaxhimit të vazhdueshëm të likuiditetit dhe hendekut të normës së interesit. Kjo qasje është në përputhje me synimet e bilancit të gjendjes, strategjitë biznesore dhe pritjet ekonomike. Për më tepër, në aspektin e menaxhimit të rrezikut, Thesari dhe MPD-ja menaxhojnë asetet dhe detyrimet duke analizuar vazhdimisht rreziqet e mundshme dhe mundësitë e tregut në kuadër të rregullave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i aseteve dhe detyrimeve (KAD).

Ekipi FTP i Departamentit kryen funksionin e Vënies së Çmimit të Transferimit të Fondeve për njësitë tjera biznesore të Bankës, duke udhëhequr dhe drejtuar synimet biznesore dhe duke e centralizuar rrezikun e normës së interesit.

Ekipi i Marketingut të Thesarit u shërben klientëve në të gjitha segmentet, me një gamë të gjerë të produkteve që përfshijnë transaksione të këmbimit valutor, transaksione të ardhme të këmbimit valutor, transaksione të kundër-këmbimit të valutës së huaj, obligacionet dhe bonot e qeverisë.

Departamenti gëzon mbështetjen e fuqishme të prindërve të tij Francez dhe Turk në kontrollin e rrezikut dhe kryerjen e punëve të tij.

Ç'ka më tutje?

Biznesi nuk do të jetë më i lehtë në vitin 2017 dhe pritet një gjah intensiv për rendiment duke marrë parasysh konkurrencën në rritje në treg ndërsa rreziqet politike janë në rritje e sipër në botë. Thesari dhe MPD-ja do të vazhdojnë ta mbështesin bankën në mënyrat më të mira të mundshme ashtu që ta sigurojë aftësinë paguese dhe performancën solide të saj përbrenda një kornize të rreptë të menaxhimit të rrezikut, respektit të skajshëm të ligjeve vendore dhe ndërkombëtare dhe të gjitha palëve tjera me interes.

4.8. Burimet njerëzore Politika e burimeve njerëzore

Punonjësit janë pasuria më e rëndësishme e TEB SH. A., pasi që përkushtimi, dedikimi, aftësitë dhe përpjekjet e tyre janë ato që i ndihmojnë Bankës të arrijë objektivat e saj strategjike.

Sfidë e vazhdueshme e ekipit të Burimeve Njerëzore është:

- Të punojë nga afër me menaxhmentin e Bankës për ta siguruar sinergjinë dhe për të krijuar një mjedis frymëzues të punës për punonjësit.
- T'i rekrutojë dhe mbajë talentët e rinj më të mirë dhe energjikë në treg, ambiciet e të cilëve përputhen me kulturën tonë dinamike të biznesit, të cilët do të kontribuojnë në rritjen Bankës dhe të cilët janë të aftë të gjenerojnë vlerë të shtuar. Nga ana tjetër, ne ofrojmë mundësi të zhvillimit dhe pako konkurruese të përfitimeve.
- T'i përkrahë punonjësit në rrugën e tyre të karrierës, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm.
- Ta zhvillojë dhe menaxhojë sistemin e vlerësimit të performancës.

- T'i japë secilit person mundësi të barabarta gjatë procesit të rekrutimit, zhvillimit, progresit në karrierë dhe avancimit.

Këto pika të fokusit janë përkthyer në një politikë të Burimeve Njerëzore që udhëhiqet nga lëvizja e brendshme, zhvillimi i vazhdueshëm i aftësive dhe njohurive të punonjësve si dhe promovimi i vazhdueshëm i të gjitha formave të diversitetit.

Në fund të vitit 2016, ekipi i plotë i TEB-it përbëhej nga 590 punonjës. Gjatë këtij viti u rekrutuan gjithsej 84 profesionistë të shërbimeve bankare dhe financiare. Në aspektin e lëvizjes, 173 punonjës të TEB-it janë promovuar ose iu janë dhënë sfida të reja gjatë vitit 2016. Kur janë hapur pozita të reja, punonjësve gjithmonë iu është dhënë mundësia që të lëvizin më lartë në pozitë brenda organizatës, me 34 kolegë të aftë për t'i pranuar sfidat e reja në lokacione të ndryshme, ndërsa shtatë punonjës ekzistues janë promovuar në pozitën e menaxherit.

Zhvillimi i karrierës

TEB SH. A. iu jep punonjësve të vetë mundësinë për të avancuar përmes zhvillimit të vazhdueshëm dhe duke krijuar plane të karrierës dhe në vitin 2016 janë bërë investime të konsiderueshme në përmirësimin e proceseve të ndërlidhura me këtë. Duke marrë parasysh se kultura korporative shpërndahet poshtë nga menaxherët tek punonjësit, i është dhënë prioritet trajnimit të avancuar për menaxherët e bankës. Përgjatë gjithë vitit, është mbajtur një seri e programeve të zhvillimit veçanërisht të dizajnuara me shumë module për menaxherët (e lartë) dhe këto do të vazhdojnë në vitet e ardhshme.

Vëmendje e veçantë i është përkushtuar punonjësve ekzistues me potencial për t'u bërë menaxherë. Përgjatë vitit, 45 punonjësve me potencial të lartë iu është ofruar mundësia që të marrin pjesë në Programin

e zhvillimit në Qendrën e vlerësimit. Nga ky program që ka filluar në vitin 2014 dhe që ende vazhdon, ne kemi emëruar shtatë menaxherë të ri gjatë vitit 2016 dhe kemi një grup të menaxherëve potencialë në dispozicion që mund të konsiderohen për pozita të lira në të ardhmen. Ne besojmë se programe të tilla kontribuojnë në mirëqenien e punonjësve dhe rrisin motivimin dhe besimin e tyre, pasi që ata e dinë se vlerësohen nga Banka dhe shohin një ardhmëri të ndritur në familjen tonë.

Gjatë vitit 2016, janë organizuar programe të vazhdueshme të trajnimit, të brendshme dhe të jashtme; dhe këto kurse janë mbajtur nga menaxhmenti dhe nga kompanitë e mirënjohura të trajnimit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimit të detyrueshëm për Pajtueshmërinë dhe të gjithë punonjësit janë trajnuar në këtë temë së paku një herë. Në përgjithësi, janë organizuar 92 kurse për ta trajnuar stafin tonë. Për t'u siguruar që zhvillimi i njerëzve tanë është në përputhje me ndryshimet globale në ekonomi dhe teknologji, 48 punonjës tanë kanë udhëtuar jashtë vendit për të marrë pjesë në seminare, panairë, punëtori, konferenca dhe trajnime në vende të ndryshme evropiane, përfshirë Turqinë, Luksemburgu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francën, Hungarinë, Maqedoninë dhe Shqipërinë.

Burimet Njerëzore kanë vazhduar të caktojnë dhe t'i përcjellin trajnimet teknike online përmes platformës për trajnime online të BNP Paribas, në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat dhe standardet për trajnime të Grupit BNP Paribas.

Në vitin 2016, ne kemi bërë lansimin e e-campus, platformë e brendshme e trajnimit online. Për më tepër, punonjësve tanë i janë caktuar dhe ata i kanë përfunduar disa kurse të trajnimit të aftësive ndërpersonale dhe atyre teknike. Kjo platformë ka qenë shumë e dobishme për punonjësit, pasi trajnimi është ofruar në gjuhën shqipe për të siguruar që e gjithë përmbajtja është e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë punonjësit.

Inovacionet

Inovacioni është pjesë e ADN-së së TEB SH. A. dhe në Bankë besojmë se është komponent kyç në suksesin tonë. Gjatë vitit 2016, ekipi i Burimeve Njerëzore ka organizuar disa 'Ditë të nxjerrjes së ideve' që kanë pasur për synim shkëmbimin e ideve inovative për ta mbështetur qëllimin tonë që të jemi banka më e mirë me fokus ndaj klientit në Kosovë. Punonjësi i kanë shkëmbyer dhe promovuar idetë pasi që ato kanë rritur sinergjinë që shton vlerë si për Bankën ashtu edhe për stafin.

Si rezultat i këtyre Ditëve të nxjerrjes së ideve kemi shumë ide të shkëlqyeshme dhe projekte të reja janë duke u zhvilluar dhe duke u zbatuar bazuar në to.

Aktivitetet shoqërore

Në TEB besojmë se Banka ka rol në promovimin e mirëqenies, lumturisë dhe motivimit për njerëzit tanë. Kjo është arsyeja pse ne gjithashtu organizojmë aktivitete shoqërore ashtu që ato të mund t'i forcojnë marrëdhëniet e punës në një mjedis më të relaksuar. Gjatë vitit 2016, ne kemi organizuar disa ngjarje të tilla, duke përfshirë kokteje, takime dhe aktivitete sportive. TEB SH. A. përpiket të jetë institucion me përgjegjësi shoqërore kështu që ne kemi mbështetur disa aktivitete që ekipet vullnetare të punonjësve kishte organizuar për t'i kontribuar shoqërisë.

Ç'ka më tutje?

Në vitin 2017, ekipi i Burimeve Njerëzore do të vazhdojë të japë mbështetje të plotë në rekrutimin dhe trajnimin e talentëve më të mirë. Do të fokusohet në zhvillimin e aftësive dhe njohurive të punonjësve, si dhe të ofrojë rrugë të reja të karrierës dhe mundësi për lëvizje të brendshme. Trajnimi është prioritet kryesor dhe përgjatë vitit do të organizohen kurse për t'u siguruar se zhvillimi i stafit është

në përputhje me kërkesat dhe standardet e Grupit. Ne edhe më tej do të fokusohemi në aktivitetet shoqërore për ta mbajtur motivimin e punonjësve tanë. Aktivitetet që i kontribuojnë shoqërisë gjithmonë do të jenë të rëndësishme. Për më tepër, ne do ta forcojmë platformën që iu mundëson njerëzve tanë të gjenerojnë ide për inovacion.

4.9. Organizimi dhe zhvillimi i proceseve

Nëpërmjet kulturës sonë të korporatës, në të cilën vlera dhe cilësia e shërbimit për klientët është në qendër të çdo gjëje që e bëjmë, ne kemi vazhduar ta shfrytëzojmë forcën tonë duke iu përshtatur më tej modelit tonë të biznesit, që është energjik dhe që merr parasysh rrezikun.

Si anëtare krenare e dy grupeve të fuqishme financiare ndërkombëtare, jemi duke shfrytëzuar plotësisht ekspertizën e spektrit të gjerë në mënyrë që TEB të mund të bëhet edhe më i fuqishëm në përballimin e çdo sfide. Kemi vazhduar përpjekjet tona për t'i përfshirë vlerat dhe strategjitë e grupit në aktivitetet dhe proceset tona të biznesit. Theksi është gjithmonë në pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret, kulturën e fortë të etikës dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët tanë.

Politikat dhe procedurat janë faktori esencial për komunikimin e vlerave të korporatës dhe standardeve profesionale. Ato shërbejnë si gurë-themel për menaxhimin e duhur të aktiviteteve të Bankës, pajtueshmërinë me kërkesat rregullative dhe legislative, kontrollin e rreziqeve dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara për klientët. Andaj, gjatë gjithë vitit, Banka ka investuar përpjekje të mëdha në hartimin dhe rishikimin e dokumenteve të politikave dhe procedurave, duke mbuluar të gjitha aktivitetet e saj, për t'u siguruar se janë të cilësisë së lartë dhe harmonizojnë strategjitë e biznesit dhe aktivitetet e biznesit.

Kënaqësia e klientit është në thelb të imazhit të brendit e që në anën tjetër e forcon reputacionin tonë. Kjo është arsyeja pse ne kemi një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të cilësisë në nivel të Grupit. Prioritet i yni është që ta bëjmë kënaqësinë e klientit shtyllë qendrore të strategjisë për të siguruar se çdo kontakt me Bankën rezulton në mirënjohje më të madhe për bankën dhe imazh më të mirë për profesionin tonë. Kjo gjithashtu ka për qëllim matjen e kënaqësisë së klientit dhe caktimin e synimeve për përmirësim nga dëgjimi i çfarëdo shprehjeje të pakënaqësisë nga klientët. Kjo mbështetë përpjekjen tonë për të reaguar shpejtë në mënyrën më të përshtatshme, dhe për të mbrojtur interesat e klientëve duke u sjellë në mënyrë shembullore në çdo kohë dhe duke ofruar produkte dhe shërbime që përmbushin nevojat e tyre.

Ne punojmë në një mjedis dinamik bankar. Banka vazhdon t'i përgjigjet sfidës së ofrimit të produkteve dhe shërbimeve të porositura për t'i përmbushur nevojat e klientëve. Nismat e ndërmarra për zhvillimin dhe efikasitetin operacional kanë për qëllim kontrollin dhe optimizimin e proceseve tona për t'i siguruar operacionet e klientëve, dhe për ta përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë e shërbimeve tona.

Programi i efikasitetit operacional, metodologjia dhe parimet e tij, kanë për qëllim pasurimin e përvojës dhe kënaqësisë së klientit duke ulur ndjeshëm kohëzgjatjen e proceseve, por duke kontribuar në produktivitetin e brendshëm.

Ç'ka më tutje?

Duke shikuar para, ne do të vazhdojmë t'i optimizojmë dhe zhvillojmë strukturat organizative themelore dhe infrastrukturat e procesit në përputhje me strategjinë afariste të Bankës. Kënaqësia e klientit dhe efikasiteti operacional do të mbeten një nga shtytësit për krijimin e vlerës.

4.10. Teknologjia informative

Departamenti i Teknologjisë informative në vitin 2016 ka qenë i angazhuar në ofrimin e përparësisë strategjike për TEB-in duke nxitur përdorimin kreativ dhe inovativ të teknologjisë për t'i arritur objektivat e Bankës. Departamenti ka promovuar administrimin efektiv të aseteve të informimit dhe ka ofruar një infrastrukturë teknologjike të sigurt dhe shumë të besueshme, bashkë me shërbime dhe mbështetje të cilësisë së lartë të orientuara nga klienti, ashtu që t'i plotësojë nevojat gjithnjë në ndryshim të menaxhmentit, Bankës dhe stafit.

Arritjet

- Gjatë viti 2016, kemi pasur mundësinë t'i kontribuojmë projektit Kredit kartela për Gra ndërmarrëse për t'i mbështetur femrat ndërmarrëse në biznes. Ne kemi rritur numrin e bankomatëve për t'i përmirësuar kanalet tona të shpërndarjes. Bankomatët dhe терминаlet POS janë konfiguruar për t'i pranuar kartelat MasterCard.
- Si projekt për të gjitha bankat, platforma e transfereve vendore është automatizuar për t'i ofruar klientëve tanë ofrimin e shërbimit në kohë reale.
- Aplikacioni TebMobile është në dispozicion në të dy sistemet operative, IOS dhe Android; versionin Android e kemi lansuar në fillim të vitit 2016.
- Për t'i mbështetur përmirësimet e procesit të biznesit, kemi instaluar skanerë në degët tona për ta zvogëluar kohën e nevojitur për procesin e pranimin të klientit të ri, ose për të aplikuar për kredi ose kredit kartelë. Ne gjithashtu kemi dizajnuar dhe kemi zbatuar formularët e aplikimit online në sistemin tonë të brendshëm për t'i thjeshtëzuar proceset. Ky element ka kontribuar në zvogëlimin e shfrytëzimit të kotë të letrës

në bankën tonë dhe të kohës së procesit të aplikacionit për 50% në krahasim me vitet e kaluara.

- Në mënyrë që ta rrisim sigurinë për shërbimet e-commerce, ne kemi zbatuar projektin 'Visa 3D Secure' që do t'i mbrojë mbajtësit e kartelës nga mashtrimet online; kjo është një nga metodat më të reja për parandalimin e mashtrimit për sa i përket transaksioneve online.
- Për më tepër, është rritur numri i pajisjeve Q-matic për ta përmirësuar menaxhimin e kohës së pritjes në degët tona.

Shërbimet bankare të sigurt dhe infrastruktura e fortë

Ne monitorojnë nga afër të gjitha dobësitë e sigurisë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, duke marrë masa për ta mbrojtur bankën dhe klientët tanë në përputhje me rrethanat. Kemi përfunduar një numër të përmirësimeve në sistemet tona të prodhimit për të siguruar një infrastrukturë më stabile dhe më reaguese. Një ndryshim i vogël por i rëndësishëm praktik që kontribuon në angazhimin tonë për mjedisin është kalimi në shtypjen në të dyja anët në të gjithë printerët tanë. Kjo tani është praktikë standarde në Bankë.

Ç'ka më tutje?

Our goals are to support the achievement of Qëllimi ynë është që ta mbështesim arritjen e objektivave strategjike të Bankës.

Plani ynë afatgjatë strategjik është që vazhdimisht ta rrisim cilësinë dhe ta përmirësojmë efektivitetin në shërbimet ndaj dhe komunikimet me palët me interes.

Si proces i përmirësimit të vazhdueshëm, do t'i shqyrtojmë dhe do t'i përmirësojmë proceset, procedurat dhe dokumentacionin e TI-së bazuar në standardet Ndërkombëtare për Menaxhimin e Shërbimit të TI-së dhe për Menaxhimin e Cilësisë.

Në vitin 2017, do të vazhdojmë zbatimin dhe integrimin e karakteristikave shtesë në produktet dhe shërbimet tona në pajtim me strategjitë e korporatës.

4.11. Siguria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale

Siguria e informacionit është përgjegjësi e çdonjërit

Ky ka qenë parimi ynë themelor në vitin 2016 dhe do të vazhdojë të jetë në vitin e ardhshëm. Gjatë viti 2016, i kemi përmbushur të gjitha detyrimet dhe kërkesat ligjore. Ky parim ka siguruar mbrojtjen e besueshmërisë dhe reputacionit të Bankës, menaxhimin e rreziqeve dhe mundësi të ndërlydhura me biznesin, vazhdimësinë e aktiviteteve kryesore dhe mbështetëse me ndërprerje shumë të rralla, si dhe ngritjen e vetëdijes në mes punonjësve për sa i përket sigurisë së informacionit, dhe në këtë mënyrë është ofruar përmirësim i vazhdueshëm për sistemin e Bankës për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Në mbështetje, gjatë vitit 2016 janë zhvilluar dhe publikuar një numër i konsiderueshëm i dokumenteve. Programet e trajnimit të Bankës përfshijnë trajnimin për Sigurinë e informacionit dhe njoftimet të cilat sigurojnë që punonjësit të jenë të vetëdijshëm dhe të pajisur me informata për t'i mbrojtur klientët tanë dhe asetet e Bankës.

Mbrojtja e të dhënave


Secili ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale

Prandaj, mbrojtja e informacionit të klientëve tanë është prioritet i lartë por edhe kërkesë ligjore. Njësia e Bankës për Mbrojtjen e të Dhënave respekton privatësinë dhe të drejtat për mbrojtjen e të dhënave të personave të cilët ia kanë besuar të dhënat personale TEB SH. A., duke mbledhur dhe proceduar të dhëna personale vetëm atëherë kur kjo është e lejuar me ligj. Ne i respektojmë detyrimet e përcaktuara për sa i përket procedimit të të dhënave personale.

Banka i përgjigjet ankesave për sa i përket shkeljeve të rregullave për mbrojtjen e të dhënave. Dhe gjithashtu bashkëpunojmë me Agjencinë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave. Programet e trajnimit të Bankës përfshijnë trajnimin e detyrueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave për stafin edhe pse nuk detyrim ligjor. Qëllimi i trajnimit është që të sigurojë një kuptim bazik të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave për punonjësit e ri dhe ata ekzistues, ashtu që të mund të ushtrojmë përgjegjësinë tonë për mbrojtjen e të drejtave dhe privatësinë e individëve gjatë trajtimit të të dhënave personale.

Menaxhmenti dhe Qeverisja Korporative

5.1 Struktura Organizative e TEB Sh.A.



Raporton në Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve

* Raporton në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut të Bordit të Drejtorëve

5.2. Bordi i Drejtorëve

Jacques Roger Jean Marie Rinino*
Kryetar

Dr. Ismail Yanık*
Zëvendës Kryetar

Alp Yılmaz
Zëvendës Kryetar

Ayşe Aşardağ
Anëtar

Pascal Alfred J. Gilliard
Anëtar

Birol Deper*
Anëtar

Tuğbay Kumoğlu
Anëtar

Ayhan Albeyoğlu
Anëtar (kryesisht)

** Në një mbledhje të jashtëzakonshme të aksionarëve të mbajtur më 28 mars 2016 Jacques Rinino u emërua si Kryetar, Ismail Yanık si zëvendës Kryetar dhe Birol Deper si anëtar i Bordit të Drejtorëve të TEB SH. A. pasi që Kryetari i mëparshëm dhe dy anëtarë të BD-së dhanë dorëheqje më 28 mars 2016.*

Trupi drejtues

TEB SH. A. (Banka/TEB) ka Bordin e Drejtorëve që aktualisht përbëhet nga tetë anëtarë. Të gjithë kanë përvojë të gjerë në shërbimet bankare (ju lutemi shihni biografite e anëtarëve). Bordi kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta në përputhje me kërkesat e përcaktuara në statutin e Bankës dhe rregulloret e Bordit të Drejtorëve si dhe në përputhje me gjithë legjislacionin përkatës dhe kërkesat e përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullatorët. Bordi mblidhet të paktën çdo tre muaj.

Roli i Bordit të Drejtorëve

Edhe pse detajet janë përcaktuar në nenet 26, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, detyra kryesore e Bordit është t'i mbikëqyrë aktivitetet financiare dhe afariste të Bankës. Ai është përgjegjës për përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Bankës, politikës afariste të saj duke përfshirë njësitë operative dhe administrative, nën-njësitë dhe funksionet e tyre, pozitat mbikëqyrëse dhe marrëdhëniet raportuese. Për më tepër, Bordi është i ngarkuar edhe me mbikëqyrjen e aktiviteteve të menaxhmentit të lartë. Bordi i Drejtorëve përcakton dhe krijon strukturën bankare dhe nivelet e ekspozimit të bankës, rishikon dhe miraton rregullimet dhe masat e nevojshme. Për më tepër, Bordi është përgjegjës për miratimin e raportit të menaxhmentit të lartë për aktivitetet e biznesit në bazë të bilancit gjashtëmuor të gjendjes, pasqyrës së fitimit dhe humbjes, bilancit vjetor të gjendjes dhe raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. Vendimet e marra nga Bordi kërkojnë shumicën e votave nga anëtarët të cilët ose janë të pranishëm ose votojnë me ndërmjetës.

5.3. Komitetet

Komitetet e Bordit të TEB SH. A.

Në përputhje me Statutin e TEB SH. A., rregulloret dhe kërkesat e Bankës, Bordi ynë ka caktuar Komitetin e auditimit, Komitetin e menaxhimit të rrezikut, Komitetin e pasurive dhe detyrimeve, Komitetin e lartë të kredive dhe Komitetin e kompensimit (ky i fundit u hoq në mes të vitit 2015) që përbëhen nga anëtarët e Bordit dhe ekspertët e jashtëm. Bordi gjithashtu mund të krijojë komisione ad hoc dhe të përcaktojë përbërjen dhe detyrat e tyre, aty ku duhet dhe është e përshtatshme. Sipas nenit 22 të Statutit të TEB SH. A. të datës 24 qershor 2013, Komitetet mund të zgjidhen nga radhët e aksionarëve, drejtorëve dhe punonjësve të Bankës, si dhe nga radhët e personave të tjerë jashtë bankës, duke iu nënshtruar kufizimeve në Statut. Komitetet nuk duhet të marrin vendime në vend të BD-së ose aksionarëve, por do të veprojnë si këshilltarë të tyre.

Komiteti i auditimit

Kryetar: Ayşe Aşardağ

Zëvendës Kryetar: Biorol Deper

Anëtar: Pascal Alfred J. Gilliard

Anëtar: Nexhat Kryeziu (ekspert i jashtëm)

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti i auditimit ka detyrat dhe përgjegjësitë e qarta që janë të përcaktuara në aktet nënligjore të komiteteve të auditimit dhe janë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret relevante. Detyrat e tij përfshijnë:

- Rekomandimin e kontrolleve adekuate të brendshme të kontabilitetit, operacionale dhe administrative;
- Mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së Bankës me politikat dhe procedurat;
- Kërkimin dhe rishikimin e raporteve nga shefi i departamentit të auditimit të brendshëm të Bankës;
- Rekomandimin e kompensimit për shefin e departamentit të auditimit të brendshëm;
- Monitorimin e pajtueshmërisë me legjislacionin bankar përkatës dhe rregulloret ose kërkesat e aplikueshme;
- Rekomandimin për emërimin e një auditori të jashtëm;
- Monitorimin e performancës së auditorit të jashtëm, rishikimin e raportit të auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të Bankës dhe raportimin e të gjitha gjetjeve tek Bordi i Drejtorëve;
- Dhënien e mendimeve tek Bordi i Drejtorëve në lidhje me çdo çështje që i kërkohet atij nga Bordi i Drejtorëve, ose që komisioni dëshiron ta adresojë; dhe
- Miratimin e planit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm të TEB SH. A.

Komiteti i auditimit takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i lartë për kredi (CRECOM)

Kryetar: Pascal Alfred J. Gilliard

Zëvendës Kryetar Haluk Kırçalı

Anëtar: Alp Yılmaz

Detyrat dhe përgjegjësitë

Ky komitet është i autorizuar të marrë vendime për kredi për shumat në mes 500,000 € dhe 2.5 milion €.

Komiteti i menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve (KAD)

Kryetar: Dr Ismail Yanık

Zëvendës Kryetar: Ayhan Albeyoğlu

Anëtar: Alp Yılmaz

Anëtar: Pascal Alfred J. Gilliard

Anëtar: Tolga Gürdem

Anëtar: Orçun Özdemir

Anëtar: Serhan Özarıslan

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Monitorimi i tregjeve financiare, duke kontrolluar situatën, lëvizjet dhe ndryshimet në bilancin e gjendjes së bankës dhe marrjen e vendimeve, të gjitha këto në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Bankës;
- Udhëzimi dhe monitorimi i veprimeve të Departamentit të Thesarit dhe MAD-së në mënyrë të vazhdueshme dhe duke vepruar si organ vendim-marrës, siç përcaktohet në aktet nënligjore të Komisionit për MAD;
- Mbikëqyrja e menaxhimit të aseteve dhe detyrimeve nga ana e Departamentit të Thesarit dhe MAD-së për sa i përket kritereve të mëposhtme:
- Sigurimi i respektimit të raporteve të jashtme (rregullative) të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) dhe rregullave të brendshme të përcaktuara nga Bordi ose KAD-i;
- Monitorimi i rezervave të domosdoshme minimale të përcaktuara nga BQK-ja.

Komiteti për asete dhe detyrime takohet së paku çdo tre muaj.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut (KMRr)

Kryetar: Pascal Alfred J. Gilliard

Zëvendës Kryetar: Alp Yılmaz

Anëtar: Jacques Roger Jean Marie Rinino

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për menaxhimin e rrezikut është përgjegjës për monitorimin e të gjithë komponentëve të lidhur me rrezikun dhe funksionet që kanë të bëjnë me kreditë, tregun, likuiditetin, çështjet operationale, të reputacionit, mjaftueshmërinë e kapitalit të Bankës si dhe rreziqet tjera.

Komiteti për menaxhimin e rrezikut takohet së paku në baza mujore.

5.4. Auditimi i brendshëm

Bordi i Drejtorëve i TEB SH. A. ka themeluar Departamentin e auditimit të brendshëm në shkurt të vitit 2013 si një nga komponentët kryesorë në strukturën drejtuese të Bankës. Para kësaj date, Banka kishte kontraktuar funksionin e saj të auditimit të brendshëm te Turk Ekonomi Bankasi (TEB) A.Ş., në bazë të Marrëveshjes së nivelit të shërbimit (SLA) të nënshkruar në vitin 2008. Banka vazhdon të marrë përkrahje për auditim nga TEB A.Ş. përmes këshillave të auditimit për Departamentin e auditimit të brendshëm. Për më tepër, TEB A.Ş. kryen auditime specifike për aktivitetet e caktuara, bazuar në planet e para-përgatitura të auditimit. Departamenti i auditimit të brendshëm të Bankës është i pavarur dhe si i tillë i raporton direkt Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të auditimit dhe me iniciativën e vet, nëse e sheh të nevojshme ose të përshtatshme.

Departamenti i auditimit të brendshëm ka funksion të sigurisë, duke i ndihmuar Bankës për t'i përmbushur objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar ndaj vlerësimit dhe përmirësimit të efektivitetit të mjedisit të kontrollit, duke përfshirë proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes. Është përgjegjësi e Auditimit të brendshëm që të vlerësojë nëse mjedisi i kontrollit siguron se rreziqet që mund të rrjedhin nga aktivitetet e Bankës menaxhohen në mënyrën e cila mundëson një nivel të pranueshëm të uljes së rrezikut. Aktivitetet e auditimit kryhen nga departamenti i auditimit të brendshëm sipas planit të auditimit, i cili përgatitet të paktën një herë në vit duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Secili plan i auditimit miratohet nga Komiteti i auditimit i Bankës. Plani përditësohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar

linja të reja të biznesit. Në të njëjtën mënyrë, auditori i brendshëm përgjegjës zhvillon dhe regjistron një plan të fokusuar në rrezik për çdo detyrë të auditimit që analizon pikat e brendshme të rrezikut dhe përfshin objektivat, fushëveprimin, kohën dhe ndarjen e burimeve.

Puna e Departamentit të auditimit të brendshëm kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të hartuara nga Instituti i Auditorëve të Brendshëm, i cili është organi drejtues për profesionin e auditimit të brendshëm në të gjithë botën, si dhe me praktikatat e auditimit të TEB A.Ş.

5.5. Menaxhimi i rrezikut

TEB SH. A. ka një qasje gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme për sa i përket rrezikut, si dhe identifikimit dhe menaxhimit të vazhdueshëm të tij. Banka monitoron dhe vlerëson rrezikun e kredive, tregut, likuiditetit, dhe atë operacional si dhe rreziqet tjera të ndërlidhura të bankës duke përdorur metodat që janë në përputhje me standardet e Grupit dhe ato ndërkombëtare. Procesi i menaxhimit të rrezikut është i organizuar në strukturën e metodologjive të menaxhimit të rrezikut të TEB A.Ş. dhe BNP Paribas (MRG dhe IRB, respektivisht) dhe favorizon një kulturë të përbashkët të menaxhimit të rrezikut. Procesi është i përbërë nga identifikimi i rrezikut, analiza, pranimi ose zbutja e rrezikut dhe monitorimi i rrezikut përmes krijimit të politikave dhe procedurave të arsyeshme. Menaxhmenti i Rrezikut i Grupit (MRG) mbikëqyr procesin e përgjithshëm të menaxhimit të rrezikut në kuadër të grupit. Departamenti i menaxhimit të rrezikut i TEB SH. A. punon në bashkëpunim me menaxhmentin ekzekutiv për të siguruar se rreziqet që i merr Banka

janë në pajtim me politikat e MRG-së të TEB A.Ş. dhe IRB-në e BNPP-së dhe se janë në përputhje me apetitin e bankës për rrezik. Departamenti i menaxhimit të rrezikut raporton drejtpërdrejt tek Bordi i Drejtorëve përmes Komitetit të menaxhimit të rrezikut (KMR) në baza mujore në nivel të portfolios, për të cilin jepen direktivat për zbutjen e rrezikut.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku më i shpeshtë me të cilin ballafaqohet banka bazuar në kushtet e tregut vendor. Ne e përkufizojmë rrezikun e kredive si humbje që mund të ndodhë nëse pala tjetër në marrëdhënie të kredisë dështon, pjesërisht ose tërësisht, për t'i përmbushur detyrimet e saj siç është përcaktuar në marrëveshjen e kredisë. TEB SH. A. është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet kredidhënies së saj, financave tregtare dhe aktiviteteve të thesarit, por rreziku i kredive mund të lindë edhe në rrethana të tjera.

Zbutja: TBordi i Drejtorëve është përgjegjës për përcaktimin e politikave të kredive dhe miratimit të shërbimeve të kredisë. Ky autoritet i delegohet Komitetit të lartë të kredive dhe Drejtorit Ekzekutiv në kushte dhe me kufizime të caktuara. Ushtrimi i këtyre kompetencave të deleguara monitorohet dhe raportohet rregullisht përmes komiteteve përkatëse nga auditimi i brendshëm dhe menaxhimi i rrezikut. Ekspozimi primar i TEB SH. A. ndaj rrezikut të kredive lind nëpërmjet kredive të saj dhe paradhënies për klientë. Përqendrimet e rrezikut të kredisë mund të lindin kur një numër i klientëve janë të angazhuar në aktivitete të ngjashme të biznesit, ose aktivitete në të njëjtin rajon gjeografik, ose kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të bënin që aftësitë e tyre për t'i përmbushur detyrimet kontraktuese të ndikohen nga ndryshimet

ekonomike, politike ose kushtet e tjera. Zyrtari i portfolios i degës i viziton aplikantët për kredi dhe i merr pasqyrat financiare dhe informacionin në lidhje me aktivitetet dhe planet e investimit të klientit. Përgatitet propozimi për kredi që përmban komentimin për pozitën financiare të kompanisë së klientit dhe informacione tjera cilësore, analizën e industrisë, informacionin për partnerët dhe menaxherët, palët tjera me interes si dhe referencat nga burimet tjera në dispozicion. Më pastaj ky informacion i dorëzohet Divizionit për ndarje të kredive që vlerëson besueshmërinë e aplikantit në baza individuale dhe e përcjell dosjen e kredisë për vendimmarrje tek Komiteti i lartë për kredi. Departamenti për menaxhimin e rrezikut çdo muaj i vlerëson dhe menaxhon të gjitha rreziqet financiare përfshirë rrezikun kreditor, në nivel të portfolios. Analiza në nivel të bankës duhet të shqyrtohet sa herë që ekziston një ndryshim i rëndësishëm në mjedisin e biznesit që mund të ndikojë në Bankën. Stres testet e kredive janë një komponent tjetër i rëndësishëm për të kuptuar ngjarjet ose ndryshimet e mundshme në treg që mund të ndikojnë në bilancin e gjendjes së Bankës.

Njësia e ndarë për Monitorimin e korporatave përbrenda Divizionit për ndarje të kredive është themeluar për t'i monitoruar klientët me ekspozim të lartë, dhe në të njëjtën kohë për t'i vëzhguar pikëpamjet e tregut dhe industrisë në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i kredisë për shkak të faktorëve të jashtëm. Raportimi i KJP-së sektoriale është me rëndësi për të kuptuar lëvizjet në treg dhe industri. Si rezultat i politikës së kujdesshme të kredive të miratuar nga Banka, limiti maksimal i kredisë që një klient ose një grup i klientëve të ndërlidhur mund ta marrë mbahet nën kufijtë ligjor, duke zvogëluar kështu rrezikun e përqendrimit të kredisë. Limitet e vendosura nga Bordi i Drejtorëve monitorohen dhe raportohen çdo

muaj tek Komiteti i menaxhimit të rrezikut. Divizioni për ndarjen dhe monitorimin e kredive bën vlerësime të portfolios së kredisë për Komitetet e Kredisë dhe të Menaxhimit të rrezikut si dhe raporton rastet me rrezik të lartë dhe kreditë jopërformuese. Pasi ofrohet një produkt kreditor, Departamenti për monitorim të kredive monitoron aftësinë e klientit për pagesë dhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kolateralit. Në këtë mënyrë, çdo kredi problematike identifikohet në fazë të hershme. Përbrenda, banka ka filluar t'i aplikojë rezultatet e klasifikimit të kredisë për subjektet e saja ligjore. Si i tillë, klasifikimi përmban informacione sasiore dhe cilësore. Nëse klasifikimi kreditor dhe/ose cilësia e kolateralit ka ngritur ndonjë dyshim, klienti shqyrtohet dhe monitorohet më hollësisht.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin humbjet e mundshme që një bankë mund t'i pësojë si pasojë e ekspozimit të llogarive të saj në bilanc të gjendjes dhe jashtë-bilancit të gjendjes ndaj rrezikut të normës së interesit, rrezikut të pozicionit të ekuitetit ose rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhatjet në tregjet financiare.

Zbutja: Menaxhimi i rrezikut të tregut në TEB Sh.A është dizajnuar që t'i menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut, në mënyrë që të optimizohen kthimet duke e ruajtur profilin konservativ të Bankës për sa i përket rrezikut.

Rreziku i normës së interesit

Si pjesë e rrezikut të tregut, rreziku i normës së interesit mund të rrjedhë nga rreziku që një aset të humb në vlerë për shkak të ndryshimit të normës së interesit. Mbrojtja ndaj paqëndrueshmërisë së normës së interesit është prioritet i lartë për TEB SH. A.

Zbutja: Rreziku i normave të interesit përcaktohet duke matur shkallën e ndjeshmërisë së aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancit të gjendjes përmes simulimeve të shokut pozitiv dhe negativ mbi të Hyrat neto nga shërbimet bankare, e që kryhen në rregullisht. Si masë parandaluese, banka përipiqet ta përputh çdo maturitet të depozitës me një aset që ka maturitet të njëjtë. RNI-ja monitorohet nga afër përmes analizave të Hendekut dhe të Kohëzgjatjes. Efektet e mundshme negative të luhatjes së normës së interesit në pozicionin financiar dhe rrjedhën e parave minimizohen me anë të vendimeve të shpejta. Gjatë përcaktimit të strategjive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të çmimeve, Komisioni i pasurive dhe detyrimeve i TEB SH. A. menaxhon maturimin e zërave jashtë bilancit të gjendjes dhe miraton parimin e punës me kufijtë pozitivë të bilancit të gjendjes si politikë të saj për vënien e çmimeve.

Rreziku i këmbimit valutor

Rreziku i këmbimit valutor përcaktohet si një humbje e mundshme që një bankë mund ta pësojë në të gjitha asetet dhe detyrimet e saj valutore në rast të ndryshimeve në kurset e këmbimit.

Zbutja: Kufijtë e pozitive të përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve monitorohen në baza ditore dhe gjithashtu ekzaminohen ndryshimet e mundshme në pozitat monetare të Bankës që mund të vijnë si rezultat i transaksioneve rutinore në valuta të huaja.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit ndodh kur nuk ka para të mjaftueshme ose rrjedhë të mjaftueshme të parasë për t'i përmbushur kërkesat neto të financimit në kohën e duhur. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllen shpejt me çmime të përshtatshme.

Zbutja: Politika e Bankës është ta ketë një strukturë të aseteve që është mjaft likuide për t'i përmbushur të gjitha llojet e detyrimeve kur ato duhen paguar. Bordi i Drejtorëve rregullisht monitoron dhe përcakton normat e likuiditetit dhe standardet përkatëse për ruajtjen e likuiditetit të lartë gjatë gjithë kohës. TEB SH. A. ka një sistem efikas për sa i përket raportimit me kohë të pozicionit të likuiditetit te Bordi i Drejtorëve, te Menaxhmenti i lartë dhe të gjitha njësitë përkatëse. Për më tepër, stres testet e likuiditetit janë një vegël tjetër e rëndësishëm për ta matur likuiditetin e bankës për supozime të ndryshme biznesore. Për më tepër, si pjesë e direktivës Basel II, Banka llogarit rregullisht Raportin e mbulimit të likuiditetit, duke siguruar adekuatshmërinë e likuiditetit afatshkurtër.

Adekuatshmëria e kapitalit

Qëllimi i bankës është që të sigurohet se ka kapital të mjaftueshëm për t'i mbuluar rreziqet e përfshira në aktivitetet e saj biznesore të kredidhënies. Departamenti për menaxhimin e rrezikut i monitoron dhe raporton normat e mjaftueshmërisë së kapitalit te Menaxhmenti Ekzekutiv dhe Bordi i Drejtorëve përmes Komitetit të menaxhimit të rrezikut. Sipas Ligjit për veprimtarinë bankare dhe rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës, ekzistojnë tri raporte të mjaftueshmërisë që duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës: Kapitali i klasit të parë në raport me APRr së paku 8%, Kapitali total në raport me APRr së paku 12% dhe Ekuitetit total në raport me Asetet totale së paku 7%.

Rreziku operacional dhe Vazhdimësia e biznesit

Rreziku operacional përkufizohet si rrezik i humbjes që mund të rezultojë nga proceset e brendshme jo adekuate ose të dështuara, njerëz ose sisteme, ose nga ngjarje të jashtme të caktuara.

Zbutja: Departamenti i menaxhimit të rrezikut në TEB dhe njësia e saj e dedikuar për rrezikun operacional janë përgjegjës për monitorimin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Banka ka një sistem të përshtatshëm për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e biznesit të Bankës për sa i përket identifikimit efektiv të Treguesve kyç të rrezikut dhe vlerësimit, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut përkatës operacional. Njësia e rrezikut operacional zbaton metodat për t'i ndihmuar departamentet tjera në identifikimin, monitorimin, kontrollimin dhe zbutjen e incidenteve potenciale operacionale. Rreziku operacional ofron trajnime të rrezikut operacional për gjithë punonjësit, sidomos ata që janë përgjegjës për raportimin e incidenteve ndaj rrezikut operacional tek Njësia e vazhdimësisë së biznesit, dhe vlerësimin e të gjitha proceseve për sa i përket rrezikut operacional dhe identifikimin e proceseve me rrezik të lartë.

Vazhdimësia e biznesit, pavarësisht nga lloji dhe arsyeja, përbëhet tërësisht nga planet që sigurojnë vazhdimësinë e funksioneve kritike biznesore të bankës në rast të ndërprerjes së çdo biznesi që rrjedh nga faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Njësia e rrezikut operacional dhe Vazhdimësisë së biznesit angazhohet vazhdimisht në përkufizimin, matjen dhe raportimin e rrezikut te Departamenti i menaxhimit të rrezikut. Rezultatet e aktiviteteve të Rrezikut operacional dhe Vazhdimësisë së biznesit shqyrtohen dhe vlerësohen në baza mujore në nivel të Bordit përmes Komisionit për menaxhimin e rrezikut.

5.6. Pajtuueshmëria

Jemi të përkushtuar për aktivitete bankare të përgjegjshme dhe për të vepruar me integritet dhe përgjegjësi në çdo gjë që bëjmë. Në TEB, besojmë se në krijimin e vlerës për klientët, aksionarët, punonjësit

dhe shoqërinë tonë, mënyra si kryejmë afarizmin është po aq e rëndësishme sa qëndrueshmëria e rritjes së biznesit tonë. Nënkuptohej se respektimi i ligjeve dhe rregulloreve dhe standardeve dhe udhëzimeve më të larta ndërkombëtare është pjesë e identitetit tonë dhe formon themelin e mënyrës sonë të biznesit.

Në të njëjtën kohë, kemi vendosur standarde të larta të integritetit të biznesit dhe sjelljes etike me qëllim të rritjes së efektivitetit të kornizës së pajtueshmërisë. Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të vazhdueshme në kërkesat rregullative në Kosovë dhe në nivelin e Grupit BNP Paribas, ku menaxhimi i pajtueshmërisë po kthehet në prioritet kryesor. Si në vitet e kaluara, jemi ballafaquar me shumë sfida, por vlerësojmë rritjen e rëndësisë, vetëdijes dhe zbatimit në fushën e pajtueshmërisë. Fryma jonë ekipore, përkushtimi dhe përmirësimi i qëndrueshëm i efikasitetit tonë të gjitha kanë për qëllim ruajtjen e integritetit të institucionit tonë financiar.

Presim që punonjësit tanë të veprojnë me ndershmëri, me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë dhe profesionale, në shërbim të interesave më të mira të klientëve dhe duke respektuar integritetin e tregjeve. Kodi ynë i sjelljes, i përbërë nga vlerat, sjellja dhe kërkesat tona etike në biznes, formon bazën e mënyrës së sjelljes së punonjësve tanë me kolegët dhe klientët tanë, partnerët afaristë, aksionarët dhe autoritetet. Kodi i mirësjelljes përfshinë dispozitat etike në biznes që kanë për qëllim menaxhimin e konfliktit të interesit, parandalimin e abuzimit të tregut, luftimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera ekonomike.

Jemi të përkushtuar për të respektuar ligjet, rregulloret dhe udhëzimet e rrepta për ta luftuar pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe për ta parandaluar shkeljen

e sanksioneve financiare ndërkombëtare. I analizojmë klientët tanë dhe transaksionet e tyre për të parandaluar që emri ynë dhe produktet dhe shërbimet tona të keqpërdoren për qëllime të tilla. Kjo mund të shihet në numrin e rritur të punonjësve që punojnë në Departamentin tonë të pajtueshmërisë, si dhe në zbatimin e mjeteve të avancuara lidhur me KPP/LFT dhe sanksionet financiare ndërkombëtare.

Për këtë qëllim, ne zbatojmë masa të përpikta të përkrahura nga sistemet automatike të monitorimit dhe procesin e shqyrtimit "Njih Klientin Tuaj" (NjKT). Procesi ynë i rishikimit të NJKT-së shërben për të përditësuar informacionin për të menaxhuar rreziqet e KPP-së që mund të paraqiten për shkak të ofrimit të shërbimit për një klient ekzistues. Procesi është në formën e rishikimeve të rregullta, sipas procedurave të përcaktuara dhe duke përfshirë vlerësimin e njerëzve ose subjekteve që janë pronarët e fundit përfitues. Masat preventive dhe zbatimi i kontrolleve të hollësishme na ndihmon ta mbajmë respektimin e rreptë të ligjeve dhe rregulloreve si dhe të politikave dhe procedurave të përshtatura të Grupit BNP Paribas. Prandaj, vazhdojmë të realizojmë projekte të rëndësishme për ta forcuar infrastrukturën tonë të TI-së dhe qasjet ndër-funksionale ndaj etikës së punës, për parandalimin e pastrimit të parave/financimit të terrorizmit/shkeljes së sanksioneve financiare ndërkombëtare dhe konfliktit të interesit, dhe do të vazhdojmë të punojmë në projekte të ngjashme në të ardhmen. Me qëllim të promovimit të programit tonë të pajtueshmërisë dhe për të siguruar ndërgjegjësimin dhe respektimin nga punonjësit tanë, kemi zgjeruar programin tonë të trajnimit për të përfshirë mësimin elektronik (e-learning) dhe module të veçanta për temat kyçe të pajtueshmërisë.

Modulet janë në dispozicion për të gjithë punonjësit dhe mund të përshtaten me nevojat e linjave tona të biznesit në përputhje me kërkesat specifike të punës. Ato gjithashtu plotësojnë gamën e gjerë të programeve të trajnimit në lokacion që adresojnë tema të pajtueshmërisë. Shumica e disiplinave të mbuluara nga modulet profesionale janë të bazuara në konceptet e përbashkëta të transparencës. Departamenti ynë i Pajtueshmërisë i raporton drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të auditimit. Qëllimi i tij është të menaxhojë rrezikun e pajtueshmërisë në mënyrë të duhur për të siguruar që aktivitetet bankare janë në pajtueshmëri me ligjet, rregullat dhe rregulloret përkatëse.

Kontrolli i brendshëm

Departamenti i kontrollit të brendshëm ka për qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndoshë të kontrollit të brendshëm në TEB SH. A. Ai merret me koordinimin e domosdoshëm dhe siguron se aktivitetet përkatëse kryhen rregullisht, në mënyrë efektive dhe në përputhje me strategjitë dhe politikat e menaxhmentit të Bankës, si dhe me rregullat dhe rregulloret në fuqi. Në TEB, funksionet e Kontrollit të brendshëm dhe Rrezikut operacional janë të strukturuar ndaras. Brenda fushëveprimit të kontrollit të brendshëm, kryhen kontrollet e aktiviteteve kritike në degë dhe departamenteve të zyrës qendrore nga Njësia e kontrollit të degës, Njësia e kontrollit qendror dhe Njësia e kontrollit të kredive.

Kontrolluesi kryen kontrollet e tij/saj në pajtim me listat e kontrollit të cilat janë të përgatitura paraprakisht dhe në përputhje me rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe të jashtme. Listat e kontrollit rishikohen nëse ndodhin ndryshime në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe/ose të jashtme.

Pikat e kontrollit në listat e kontrollit përdoren për:

- Verifikimin e respektimit të duhur të rregullave dhe procedurave të brendshme dhe përputhjen e rregullave të brendshme me rregulloret ligjore si dhe pajtueshmërinë me to;
- Kontribuimin në ruajtjen e aseteve;
- Vlerësimin e mjaftueshmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit të aktiviteteve të përditshme; dhe
- Kontribuimin në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve të lidhura me aktivitetet afariste aktuale dhe të propozuara të ardhme të organizatës, duke përfshirë produktet e reja.

Departamenti i kontrollit të brendshëm i raporton çdo tre muaj drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve nëpërmjet Komitetit të auditimit.

TEB SH.A.

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

(së bashku me raportin e audituesve të pavarur)

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRAT E FLUKSEVE MONETARE	4
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	5 - 35



KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo
Telephone +381(38)246771
Telefax +381(38)610772
Email al-office@kpmg.com
Internet kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionarin dhe bordin e drejtorëve të TEB SH.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të TEB SH.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2016, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit tonë ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 04/L-014, "Për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim", që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa si dhe me Kodin e BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në raportin vjetor të përgatitur nga drejtimi në përputhje me Nenin 56 të Ligjit 04/L-093 "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra. Raportin vjetor parashikohet që ta sigurojmë pas datës së këtij raporti të audituesve.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.



Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur t'i sigurojmë ato dhe të konsiderojmë nëse këto informacione të tjera kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare, apo me njohuritë që ne kemi marrë gjatë auditimit, ose nëse duket se ato kanë anomali materiale.

Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.



- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch
6, Pashko Vasa Street
Pristina, Kosovo

Prishtinë, 28 prill 2017


TEB SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
 Në mijë EUR

	Shënim	2016	2015
AKTIVET			
Arka dhe Banka Qendrore	5	60,862	72,876
Hua dhe paradhënie për bankat	6	14,699	5,004
Hua dhe paradhënie për klientët	7	328,455	313,744
Aktive financiare të vlefshme për shitje	8	14,727	10,288
Aktive afatgjata materiale	11	4,153	3,750
Aktive afatgjata jo-materiale	12	1,698	1,723
Aktive të tjera financiare	9	2,643	1,920
Aktive për tatime të shtyra	24	101	90
Aktive të tjera	10	1,917	1,181
Totali i aktiveve		429,255	410,576
DETYRIMET			
Detyrime ndaj klientëve	13	334,467	342,878
Huamarrjet	16	17,522	10,975
Detyrime të tjera financiare	14	4,284	2,166
Detyrime afatshkurtër për tatimin mbi fitimin		983	1,072
Detyrime të tjera	15	675	494
Totali i detyrimeve		357,931	357,585
KAPITALI I AKSIONARËVE			
Kapitali aksionar	17	24,000	24,000
Fitime të pashpërndara		47,324	28,991
Totali i kapitalit aksionar		71,324	52,991
Totali i detyrimeve dhe i kapitalit të aksionarëve		429,255	410,576

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi Ekzekutiv i Bankës më 28 prill 2017 dhe janë nënshkruar nga:



 Z. Orçun Ozdemir
 Drejtor i Përgjithshëm



 Z. Dukagjin Shylemaja
 Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm

Shënimet nga faqja 5 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor**

Në mijë EUR

	Shënim	2016	2015
Të ardhura nga interesi	18	30,553	32,843
Shpenzime për interesat	19	(1,516)	(2,500)
Të ardhura neto nga interesat		29,037	30,343
Të ardhura nga komisionet	20	8,093	7,904
Shpenzime për komisionet	21	(1,817)	(1,554)
Të ardhura neto nga komisionet		6,276	6,350
Fitimi neto nga këmbimet në monedhë të huaj		277	326
Të ardhura të tjera operative		105	22
Rimarrje/(humbje) nga zhvlerësimi i huave ndaj klientëve	7	2,202	(1,099)
Provizione	15	(103)	(226)
Shpenzime personeli	22	(7,090)	(7,005)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	11,12	(2,467)	(2,334)
Shpenzime administrative dhe të tjera operative	23	(7,722)	(6,997)
		(14,798)	(17,313)
Fitimi para tatimit		20,515	19,380
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	24	(2,182)	(2,044)
Fitimi neto i vitit		18,333	17,336
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse		18,333	17,336

Shënimet nga faqja 5 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
Në mijë EUR

	Kapitali aksionar	Fitime te pashpërndara	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	24,000	11,655	35,655
Transaksione me aksionarin e Bankës	-	-	-
Fitimi neto për vitin	-	17,336	17,336
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	17,336	17,336
Gjendja më 31 dhjetor 2015	24,000	28,991	52,991
Transaksionet me aksionarin e Bankës	-	-	-
Fitimi neto për vitin	-	18,333	18,333
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	18,333	18,333
Gjendja më 31 dhjetor 2016	24,000	47,324	71,324

Shënimet nga faqja 5 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.
Pasqyra e flukseve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në mijë EUR

	Shënim	2016	2015
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi neto i vitit		18,333	17,336
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizimi	11	1,130	1,229
Zhvlerësimi	12	1,337	1,105
(Rimarrje)/humbje nga zhvlerësimi i huave ndaj klientëve	7	(2,202)	1,099
Provizione	15	103	226
Fitimi neto nga këmbimet në monedhë të huaj		(277)	(326)
Të ardhura të tjera operative		105	22
Humbje nga shitja e aktiveve		-	6
Humbje nga aktivet afatgjata		-	(5)
Të ardhura nga interesi	18	(30,553)	(32,843)
Shpenzime për interesa	19	1,516	2,500
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin		2,182	2,044
		(8,326)	(7,607)
<i>Ndryshime në:</i>			
Rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore	5	6	(1,658)
Hua dhe paradhënie për klientët		(12,480)	(28,039)
Aktive të tjera financiare	9	(723)	(47)
Aktive të tjera		(356)	(451)
Detyrime ndaj klientëve		(8,645)	27,046
Detyrime të tjera financiare	14	2,118	(214)
Detyrime të tjera	15	181	(12)
		(28,225)	(10,982)
Interesi i arkëtuar		30,481	32,502
Interesi i paguar		(1,656)	(1,603)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(2,271)	(991)
		(1,671)	18,926
Flukse neto (përdorur në)/nga aktivitetet operative			
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjatë materiale	11	(1,533)	(710)
Blerjet e aktiveve afatgjatë jo-materiale	12	(1,312)	(1,998)
Blerjet e aktiveve financiare të vlefshëm për shitje		(4,368)	(3,011)
		(7,213)	(5,719)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Hyrje nga huamarrjet		8,000	26,000
Pagimet e huamarrjeve		(1,429)	(30,878)
		6,571	(4,878)
(Rënie)/rritja neto në mjete monetare dhe ekuivalentë me to			
Mjete monetare dhe ekuivalentët me to më 1 janar		47,420	39,091
Mjete monetare dhe ekuivalentët me to më 31 dhjetor	6	45,107	47,420

Shënimet nga faqja 5 deri në 35 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues

Më 19 dhjetor 2007, TEB Sh.a. ("Banka") mori licencën për aktivitet bankar bazuar në rregulloret e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK") dhe ka filluar operacionet gjatë muajit janar 2008.

Zyra qendrore e regjistruar e Bankës gjendet në rrugën Agim Ramadani, nr. 15, 10000 Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë tregtare dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve në Kosovë, përmes rrjetit të saj prej 26 degësh (2015: 26) që gjenden në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

Banka kontrollohet nga TEB Holding, e themeluar në Turqi (Banka Mëmë), e cila ka në pronësi 100% (2015: 100%) të aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2016. Aksionarët e TEB Holding janë BNP Paribas dhe Grupi Çolakoglu, të cilët zotërojnë 50% të aksioneve secili.

Më 31 dhjetor 2016, Bordi i Drejtorëve është i përbërë nga:

Jacques Roger Jean Marie Rinino – Kryetar

Alp Yilmaz - Zëvendës Kryetar

İsmail Yanik - Zëvendës Kryetar

Ayhan Albeyoglu - Anëtar dhe Drejtor i Përgjithshëm

Ayşe Aşardağ – Anëtar

Birol Deper - Anëtar

Pascal Alfred J. Gilliard – Anëtar

Tuğbay Kumoglu – Anëtar.

2. Baza e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Detajet e politikave kontabël të Bankës janë përfshirë në Shënimin 3.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç aktiveve financiare të vlefshme për shitje dhe instrumenteve financiare derivative, të cilat maten me vlerën e drejtë.

2.3 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në EUR, e cila është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, përveç rasteve kur shprehet ndryshe.

3. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të dhëna më poshtë janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e paraqitur në këto pasqyra financiare.

3.1 Të ardhura dhe shpenzime nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që aktualizon pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar në vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Gjatë përlllogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson flukset e mjeteve monetare duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar, por jo humbjet e ardhshme të pësura të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit dhe komisionet si dhe pagesat ose arkëtimet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve përfshijnë kostot rritëse të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen ose emetimin e një aktivi financiar ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitur në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesin mbi aktivitetet dhe detyrimet financiare të mbajtura me kosto të amortizuar, të llogaritura mbi bazën e normës efektive të interesit; dhe
- Interesin mbi letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e normës efektive të interesit.

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.2. Komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit mbi një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në përlogaritjen e normës efektive të interesit (shih (3.1)).

Të ardhurat e tjera nga komisionet njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve përkatëse.

Shpenzimet e tjera nga komisionet lidhen kryesisht me tarifat e transaksioneve dhe shërbimeve të cilat regjistrohen si shpenzime në momentin që pranohen shërbimet.

3.3. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në atë datë. Fitimi ose humbja nga këmbimi i zërave monetarë paraqitet nga diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj përkthyer me kursin e këmbimit të fund vitit.

Diferencat nga këmbimi njihen në përgjithësi në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3.4. Aktivitet dhe detyrimet financiare jo-derivative

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë, depozitat dhe huatë në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit që është data në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivi financiar ose detyrimi financiar fillimisht matet me vlerë të drejtë plus, për një zë që nuk është i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes ose lëshimit të aktivit/detyrimit.

(ii) Klasifikimi

Aktivitet financiare jo-derivative klasifikohen në kategoritë në vijim: aktive financiare të vlefshëm për shitje, kredi dhe të arkëtueshme. Klasifikimi i aktiveve financiare përcaktohet në njohjen e tyre fillestare, pavarësisht nga karakteristikat e instrumentit dhe qëllimi i drejtimit. Shih 3.5, 3.6 dhe 3.7.

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare jo-derivative, që nuk janë garanci financiare dhe angazhime kreditore, të matura me kosto të amortizuar. Shih 3.13 dhe 3.14.

(iii) Çregjistrimi

Aktivitet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale mbi mjetet monetare nga aktivitet financiare skadojnë ose aktivitet financiare transferohen dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim. Transaksioni trajtohet si transferimi i një aktivitet financiar, kur transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet thelbësore të pronësisë. Banka i çregjistron detyrimet financiare kur obligimet e veta kontraktuale përfundojnë, anulohen ose skadojnë.

(iv) Kompensimi

Aktivitet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose ta realizojë aktivin dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në baza neto vetëm kur është e lejuar sipas SNRF-së.

(v) Matja me koston e amortizuar

'Kostoja e amortizuar' e një aktivitet ose e një detyrimi financiar është shuma me të cilën matet aktivitet ose detyrimi financiar në regjistrimin fillestar, minus pagesat e kryegjësë, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet shumës fillestare të regjistruar dhe vlerës në maturim, minus çfarëdo zbritje për zhvlerësim.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej nëse shitet një aktivitet ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm mes pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në tregun primar ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument.

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.4. Aktivet dhe detyrime financiare jo derivative (vazhdim)

(vi) Matja me vlerën e drejtë (vazhdim)

Një treg quhet aktiv në qoftë se transaksionet në lidhje me aktivin apo detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e burimeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e burimeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të kishin parasysh në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - d.m.th vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik e as nuk është e bazuar në një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vrojtueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Në qoftë se një aktiv ose pasiv i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofruar dhe një çmim të kërkuar, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në çmimin e kërkuar. Vlera e drejtë e një depozite nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë kur mund të kërkohej pagimi i shumës. Banka njeh transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur.

(vii) Zhvlerësimi

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidenca objektive që një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare është zhvlerësuar.

Një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet vetëm nëse ka evidenca objektive të zhvlerësimit si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit (një "rast humbjeje") dhe që kjo ngjarje (këto ngjarje) ka një ndikim në flukset e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare të aktivit financiar ose grupit të aktiveve financiare që maten me besueshmëri.

Zhvlerësimi dhe klasifikimi i kredive bazohet në analizën e disa faktorëve të kredisë, që përmbajnë dobësitë që janë mbartur kredisë, ose nëse ekziston probabiliteti që një pjesë e shumës së kredisë të mos paguhet. Kriteret kryesore të cilat Banka i vëzhgon për të përcaktuar se ka evidencë objektive të një humbjeje nga zhvlerësimi përfshijnë:

- Mos kryerja ose vonesa në pagesat e interesit ose principalit;
- Mos kryerja e pagesave nga institucionet e tjera financiare, që i nënshtrohen një pragu të caktuar;
- Vështirësitë e likuiditetit të emetuesit;
- Shkeljen e angazhimeve ose kushteve të kontratës;
- Falimentimin e emetuesit;
- Përkeqësimin e kushteve ekonomike dhe të tregut.

Banka në fillim vlerëson nëse ekziston evidencë objektive për zhvlerësim, individualisht për aktivet financiare të cilat janë të rëndësishëm, dhe individualisht ose në mënyrë kolektive për aktivet financiare të cilat nuk janë të rëndësishëm. Nëse Banka përcakton se nuk ka evidencë objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë ai i rëndësishëm ose jo, ajo e përfshin aktivin në një grup të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe Banka i vlerëson ato për zhvlerësim në mënyrë kolektive.

Vlera kontabël e aktivit reduktohet përmes përdorimit të një llogarie zbritjeje dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje për vitin.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (në bazë të procesit të klasifikimit të Bankës që konsideron llojin e aktivit, vonesat dhe faktorë të tjerë relevant). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë për grupet e aktiveve, duke qenë tregues i aftësisë së klientëve për të paguar sipas kushteve kontraktuale të aktiveve të vlerësuar.

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive dhe detyrime financiare jo derivative (vazhdim)

(vii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Vlerësimi kolektiv bëhet duke u bazuar në modelin e rrezikut të kredisë që merr parasysh faktorin për probabilitetin e mospagimit ("PD") dhe faktorin e humbjes si pasojë e mospagimit ("LGD") të rregulluar kur është e përshtatshme sipas rrethanave lokale. Faktori PD vëzhgohet gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore ndërsa shkalla e rikuperimit e cila llogaritet pas zbritjes së faktorit LGD analizohet brenda një periudhe 24 mujore. Modeli përditësohet në baza vjetore për tri segmente të ndara; individë, korporata biznesi dhe karta të kreditit.

Disa nga ekspozimet e kredisë mbi 500 mijë EUR (2015: mbi 500 mijë EUR) vlerësohen individualisht, ndërsa ekspozimet kreditore nën këtë nivel vlerësohen të grupuara. Banka e klasifikon portofolin në kategoritë e mëposhtme:

- Standarde: jo në vonesë dhe në vonesë nga 1 deri në 30 ditë
- Nën vëzhgim: në vonesë 31-60 ditë
- Nën-standarde: në vonesë 61-90 ditë
- Të dyshimta: në vonesë 91-180 ditë
- Të humbur: në vonesë >180 ditë

Normat kolektive të humbjes nga kreditë për dy kategoritë e para janë vlerësuar nga Banka duke përdorur një model që është miratuar nga Bordi i Drejtorëve më 28 prill 2016 dhe nga Banka Qendrore e Kosovës më 22 qershor 2016. Banka krijon fonde për humbje nga zhvlerësimi vetëm për kreditë në vonesë. Nivelet e lejimit për kreditë në vonesë në kategorinë Standarde dhe nën vëzhgim janë llogaritur duke përdorur normat e mëposhtme:

	Standarde në vonesë	Vrojtuese
Kartat e kreditit	10.54%	19.76%
Individët	7.7%	25.55%
Korporata	19.56%	36.76%

Faktorët PD dhe LGD të përdorur për të përcaktuar nivelet e zhvlerësimit të paraqitur më lart, rrjedhin nga informacioni mbi tendencat historike të probabilitetit të mospagimit të Bankës. Banka ka zbatuar një faktor shtesë mbi rezultatet e faktorëve PD dhe LGD që gjeneron modeli, me synimin që të llogarisë humbje të mëtejshme që mund të rezultojnë nga ndonjë zhvillim i pa favorshëm ose ndryshim në burime, apo pasaktësi në aplikimin e modelit. Banka e ka përshtatur më tej modelin për rrezikun e kreditimit duke aplikuar raportin minimal prej 50% për kreditë e klasifikuara si nën-standarde dhe të dyshimta, dhe 100% për kreditë e klasifikuara si të humbura. Këto nivele minimale synojnë të mbulojnë pasiguritë lokale lidhur me vlerën dhe përdorimin e kolateralit. Kreditë e dyshimta dhe të humbura për të cilat janë përdorur nivelet minimale të përmendura më lart, janë paraqitur si ekspozime të vlerësuara individualisht në Shënimin 28 (g).

Për të vlerësuar përshtatjen e faktorëve të përdorur për lejimin e zhvlerësimeve, Banka ka krahasuar raportin e kredive aktuale jo-performuese me raportin nga përdorimi i informacioni historik për mospagesat, për t'u siguruar se humbjet e vlerësuara reflektojnë zhvillimet aktuale.

Ekspozimet e ristrukturuara që janë në vonesë më pak se 90 ditë, kur nuk evidentohet përkeqësim financiar dhe në pagesa klasifikohen si ekspozime performuese, përndryshe ekspozimet klasifikohen si ekspozime të ristrukturuara jo-performuese. Një ekspozim ristrukturuar klasifikohet në kategorinë nën-standarde ose më ulët derisa të evidentohet performancë e qëndrueshme.

Pas përfundimit të secilës periudhë të performancës së qëndrueshme, Banka i klasifikon kreditë e ristrukturuara një kategori më lart. Ekspozimet e ristrukturuara monitorohen nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe klasifikimi i tyre përmirësohet vetëm pas katër pagesave të rregullta, të njëpasnjëshme.

Kur huaja konsiderohet e paarkëtueshme, ajo çregjistrohet kundrejt fondit përkatës për zhvlerësimin e kredisë. Kreditë e tilla çregjistrohen vetëm pasi të gjitha procedurat e nevojshme janë përfunduar dhe humbja është përcaktuar.

Nëse, në një periudhë pasardhëse, humbja nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (siç është përmirësimi në klasifikimin e rrezikut të kreditimit të debitorit), humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë anulohet duke rregulluar llogarinë e zbritjes. Shuma e anuluar njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në shpenzimin e zhvlerësimit për humbjet e kredisë.

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive dhe detyrime financiare jo derivative (vazhdim)

(vii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje

Banka vlerëson në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka evidencë objektive që një aktiv financiar i vlefshëm për shitje është zhvlerësuar. Në rastin e investimeve të kapitalit të klasifikuara si të vlefshme për shitje, një rënie e madhe ose e tej zgjatur në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën koston e tij konsiderohet si evidencë objektive e zhvlerësimit. Nëse një evidencë e tillë ekziston, humbja e akumuluar rimerret në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes. Banka ka miratuar kriteret e përcaktuara nga TEB Holding Group dhe për ta përcaktuar nëse një rënie në çmimin e kuotuar të tregut është 'e rëndësishme' ose 'e zgjatur'. Sipas këtyre kriterëve, 'e rëndësishme' vlerësohet kundrejt koston në njohjen fillestare dhe konsiderohet të jetë mbi 20% e koston fillestare dhe "e zgjatur" vlerësohet kundrejt periudhës në të cilën vlera e drejtë e investimit ka qenë nën koston e njohur fillimisht dhe konsiderohet të jetë mbi gjashtë muaj. Humbjet nga zhvlerësimi të regjistruara në pasqyrën e fitimit dhe humbjes nga instrumentet e kapitalit nuk rimerren në fitim ose humbje. Rritjet e vijueshme në vlerën e drejtë mbas zhvlerësimit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

3.5. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjete monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë kartëmonedhat, monedhat, balancat e pakushtëzuara bankare të mbajtura në Bankën Qendrore dhe aktivet financiare afatshkurtra me maturitet fillestar tre mujor ose më pak nga data e blerjes, që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e amortizuar.

3.6. Hua dhe paradhënie

Kreditë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të listuar në treg aktiv dhe të cilat Banka nuk ka synim t'i shesë menjëherë ose në një afat të shkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe për klientët klasifikohen si kredi dhe llogari të arkëtueshme, respektivisht.

Kreditë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e drejtpërdrejta rritëse të transaksionit, dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv duke zbritur çdo zvogëlim (përmes një llogarie zbritjeje) për zhvlerësim ose pamundësi të arkëtimit.

3.7. Aktivet financiare të vlefshme për shitje

Aktivitet financiare të vlefshme për shitje fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot e drejtpërdrejta rritëse të transaksionit. Më pas ato mbarten me vlerën e drejtë. Investimet e vlefshme për shitje përfshijnë letrat me vlerë të borxhit.

Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të vlefshëm për shitje njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesi llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore në aktivet monetare të klasifikuara si të vlefshëm për shitje njihen në fitim ose humbje.

3.8. Instrumentet financiare derivative

Banka zotëron instrumente financiare derivative për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit. Banka nuk përdor kontabilitet mbrojtës. Derivatet maten fillimisht në vlerë të drejtë; kostot e transaksionit që i atribuohen direkt njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Pas njohjes fillestare, derivatet maten në vlerë të drejtë dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje.

3.9. Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka tregues se aktivet mund të jenë zhvlerësuar. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet shuma e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme vlerësohet si vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të aktivitet minus kostot e shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Kur vlera kontabël neto e një aktivi është më e lartë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme, ajo zvogëlohet në shumën e saj të rikuperueshme dhe diferenca i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e aktiveve afatgjatë material përcaktohen duke iu referuar vlerës kontabël të tyre dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për atë periudhë. Shpenzimet për riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit ose humbjes kur ndodhin.

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.9. Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare, përgjatë jetëgjatësisë së dobishme si vijon:

Kategoria e aktiveve	Norma e përdorur e amortizimit
Përmirësimet e hapësirave të marra me qira	5 vite ose afati i qirasë, cilido që është më i shkurtër
Mobilje, instalime dhe pajisje	3-5 vite
Kompjuterë dhe pajisje të lidhura me ta	3-5 vite
Automjetet	5 vite

Toka nuk zhvlerësohet.

3.10. Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivt afatgjata jo materiale të blera nga Banka vlerësohen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi llogaritet me metodën lineare përgjatë një periudhe prej pesë vitesh.

Shpenzimet e mëvonshme në aktivet e patrupëzuara kapitalizohen vetëm kur ato rritin përfitimet e ardhshme ekonomike të aktivit specifik me të cilën lidhet. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin. Amortizimi nuk fillon deri në momentin kur aktivi është në dispozicion për përdorim.

3.11. Aktivet e riposeduara

Aktivt e riposeduara përfshijnë aktivet jo-financiare të përfituara përmes ekzekutimit të kolateraleve ndaj kredive dhe paradhënëve jo performuese për klientët, nga të cilat Banka nuk përfiton qira dhe nuk i përdor, dhe që janë të synuar për shitje në një periudhë të shkurtër kohe, pa ristrukturim të konsiderueshëm.

Aktivt e riposeduara njihen fillimisht dhe më pas rimaten me vlerën më të ulët ndërmjet vlerës së tyre kontabël dhe vlerës neto të realizueshme dhe klasifikohen si aktive të tjera. Humbjet që rrjedhin nga matja e mësipërme regjistrohet në fitim ose humbje dhe mund të anulohen në të ardhmen. Aktivt në këtë kategori nuk zhvlerësohen. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre aktiveve njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

3.12. Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet atëherë kur vlera kontabël e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme e një aktivi është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorim e një aktivi është vlera aktuale e flukseve monetare të pritshme në të ardhmen nga përdorimi i vazhdueshëm i një aktivi dhe nga shitja e tij.

3.13. Depozitat dhe huatë

Depozitat dhe huatë janë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për ta riblerë atë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshjet e riblerjes), marrëveshja regjistrohet si depozitë dhe aktivi kryesor vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Depozitat dhe huatë maten fillimisht me vlerë të drejtë minus kostot e drejtpërdrejta rritëse të transaksionit dhe më pas maten në koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.14. Garancitë financiare dhe angazhimet e kredive

Kontratat e garancive financiare janë kontrata të cilat kërkojnë që Banka të bëjë pagesa specifike për ta rimbursuar mbajtësin për humbjen që pëson për shkak se një debitor specifik dështon t'i bëjë pagesat me kohë në pajtueshmëri me kushtet e një instrumenti të borxhit. Angazhimet e kredive janë angazhime të vendosur për të ofruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar nëse dhe kur ato të bëhen të pagueshme.

3.15. Tatimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Njihet në fitim ose humbje me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen e vitit dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm lidhje me vitet e mëparshme. Ai matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit.

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.15 Tatimi (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës mbartëse të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme përveç rasteve kur tatimi i shtyrë vjen si rezultat i njohjes fillestare të një aktivi apo detyrimi që nuk ka të bëjë me një kombinim biznesi, dhe kur kryhet transaksioni ai nuk ndikon as fitimin kontabël dhe as fitimin apo humbjen tatimore. Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorur, kreditimet tatimore të papërdorur dhe diferencat e përkohshme të zbritshëm deri në masën që është e mundur që fitime të tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktiviteti i shtyrë rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën ku nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen. Tatimi i shtyrë matet me norma tatimore që priten të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur të rimerren, duke përdorur normat tatimore që janë miratuar ose që në mënyrë thelbësore janë miratuar në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston e drejta ligjore e zbatueshme për kompensimin reciprok të detyrimeve dhe aktiveve tatimore aktuale, dhe ato lidhen me tatimet e vëna nga i njëjti autoritet tatimor në të njëjtën njësi ekonomike të tatueshme, ose në subjekte të ndryshme tatimore, por ato kanë për qëllim pagesën e detyrimeve dhe aktiveve tatimore aktuale në baza neto ose aktivet dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen në të njëjtën kohë.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e ekspozimeve tatimore, duke përfshirë e mundësinë e pagesës së tatimeve shtesë dhe interesit. Ky vlerësim mbështetet në matje dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh rreth ngjarjeve të ardhshme. Informacioni i ri mund të vihet në dispozicion dhe bën që Banka ta ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

3.16. Provizionet

Një provizion është njohur nëse, si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten përmes vlerësimit më të mirë të drejtimit për shpenzimin e kërkuar për të shlyer gjendjen e detyrimit në datën e bilancit dhe zbriten nga vlera aktuale kur efekti është material.

3.17. Përfitimet e punonjësve

Banka paguan kontributet për planin e administruar publikisht të pensionit (KPST) në baza të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që të jenë paguar kontributet. Kontributet njihen si shpenzim i përfitimeve të punonjësve në kohën kur ato duhet të paguhen.

3.18. Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiranë operative i ngarkohen shpenzimeve në bazë të metodës lineare përgjatë jetëgjatësisë së qirasë. Kur një qira operative përfundon përpara se periudha e kontraktuar e qirasë të ketë skaduar, çdo pagesë që kërkohej t'i bëhet qiradhënësin si penalitet njihet si shpenzim në periudhën në të cilën ndodh ndërprerja.

3.19. Standarde të reja të cilat nuk janë adoptuar ende

Disa standarde të reja, ndryshime të standardeve ekzistuese dhe interpretime nuk janë efektive për periudhën deri në 31 dhjetor 2016, dhe nuk janë aplikuar paraprakisht në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Banka nuk planifikon që t'i adoptojë më herët këto standarde dhe ndryshime.

SNRF 9 Instrumentet financiare

SNRF 9, e publikuar në qershor të vitit 2014, zëvendëson udhëzimin ekzistues SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja. SNRF 9 përfshin udhëzimin e rishikuar për klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare, duke përfshirë modelin e ri të pritjes së humbjeve kreditore për llogaritjen e zhvlerësimit të aktiveve financiare dhe kërkesat e reja të përgjithshme të kontabilitetit mbrojtës. Ai gjithashtu ka çuar përpara udhëzimin për regjistrimin dhe çregjistrimin e instrumenteve financiare sipas SNK 39. SNRF 9 "Instrumentet financiare" do të ketë ndikim në klasifikimin, njohjen dhe matjen, zhvlerësimin si dhe në kërkesat për paraqitjen e instrumenteve financiare. Bazuar në vlerësimin paraprak, zbatimi i kërkesave të zhvlerësimit të SNRF 9 pritet të rezultojnë në rritjen të humbjeve të akumuluar në momentin e tranzicionit dhe rritjes së moderuar për shpenzimet për humbjet në kredi dhe paradhënie. Kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës nuk do të ndikojnë në pasqyrat financiare pasi Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është efektiv për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit të vitit 2018, me adoptim të hershëm të lejuar.

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.19. Standarde të reja të cilat nuk janë adoptuar ende (vazhdim)

SNRF 9 Programi i zbatimit

Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i duhur i standardit të ri, Banka ka planifikuar programin e zbatimit SNRF 9. Ky program do të drejtohet nga përcaktimi i klasifikimit të instrumenteve të saj financiare në bazë të kriterëve të reja, duke zhvilluar metodologji kryesore në lidhje me konceptet e SNRF 9, duke dizajnuar modelin operativ, dhe modeli operativ i sistemeve do të mirëmbahet duke zhvilluar metodologji të modelimit të rrezikut për llogaritjen e zhvlerësimit.

SNRF 9: Rrjedha e punës në klasifikim dhe matje

Banka është në proces të vlerësimit të modeleve ekzistuese dhe përcaktimit të modeleve të reja të biznesit, kur është e nevojshme, që do të jenë në përputhje me strategjinë e biznesit të Bankës. Rezultati i vlerësimit do të jetë paraqitja e aktiveve financiare të Bankës në modelet e reja të biznesit. Përveç kësaj, Banka është në procesin e vlerësimit të aktiveve të saj financiare në mënyrë që të përcaktojë nëse kriteri VPPI (d.m.th rrjedhjet e parasë së gatshme përfaqësojnë Vetëm Pagesat e Principalit dhe Interesit) është përmbushur. Për kreditë e standardizuara individuale, vlerësimi bazohet në karakteristikat e produktit, ndërsa për kreditë jo të standardizuara (kryesisht të korporatave) dhe letrat me vlerë të borxhit, vlerësimi bazohet në karakteristikat e aktivitetit individual. Banka do t'i përditësojë politikat dhe do të dizajnojë procese të reja të klasifikimit që do të zbatohen për klasifikimin e aktiveve financiare nga data 1 janar 2018.

SNRF 9: Rrjedha e punës për zhvlerësimin

Banka nevojitet të regjistrojë humbjet e pritshme për të gjitha kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, së bashku me angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare. Llogaria e zhvlerësimi bazohet në humbjet e pritshme të kredisë lidhur me probabilitetin e dështimit në pagesa në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm nëse nuk ka pasur rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga krijimi i saj, në të cilin, kompensimi bazohet në probabilitetin e dështimit në pagesa gjatë jetës së aktivitetit. Gjatë përcaktimit nëse rreziku i dështimit në pagesa është rritur në mënyrë të konsiderueshme që prej njohjes fillestare, Banka synon të marr parasysh informacione të arsyeshme dhe mbështetëse, si sasiore ashtu edhe cilësore, që mund të ndryshojnë midis portofoleve. Banka do t'i zhvillojë metodologjitë e veta të detajuara për vlerësim kur ka një rritje të rrezikut të kredisë.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit të vitit 2019, me adoptim të hershëm të lejuar, por vetëm nëse subjekti gjithashtu e aplikon SNRF 15 Të hyrat nga kontratat me klientë. SNRF 16 zëvendëson standardin e mëparshëm për qiratë, SNK 17 Qiratë, dhe interpretimet e ndërlidhura. Standardi i ri vendos parimet për regjistrimin, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirasë për të dy palët e një kontrate. d.m.th. klientin ('qiramarrësin') dhe ofruesin ('qiradhënësin'). SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirave si qira të operative ose qira financiare siç kërkohet nga SNK 17 dhe prezanton vetëm një model të kontabilitetit të qiramarrësit. Me zbatimin e këtij modeli, nga qiramarrësi kërkohet t'i regjistrojë: (a) të gjitha aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me kohëzgjatje prej më shumë se 12 muaj, përveç nëse aktivi themelor është me vlerë të vogël, dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë të ndarë nga interesi në detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave. SNRF 16 në mënyrë thelbësore mbart kërkesat kontabël të qiradhënësit në SNK 17. Prandaj, qiradhënësi vazhdon ta klasifikojë qiranë e vetë si qira operative ose qira financiare, dhe duhet t'i regjistrojë këto dy lloje të qirasë në mënyra të ndryshme. SNRF 16 "Qiratë" do të ketë ndikim në regjistrimin, matjen, prezantimin dhe paraqitjen e qirave. Aktualisht është duke u vlerësuar ndikimi i përgjithshëm i standardit. Standardet e reja ose të ndryshuara në vijim pritet të kenë pak ndikim ose të mos kenë fare ndikim në pasqyrat financiare të Bankës:

- Ndryshimet në SNK 7: Iniciativa për dhënie të informacioneve shpjeguese;
- Interpretimi 22 i KIRFN-së: Transaksionet e Këmbimit Valutor dhe Parapagimet;
- SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët;
- Përmirësimet vjetore në Standardet e SNRF-ve, cikli 2014-2016;
- Ndryshimet në SNK 12: Regjistrimi i aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara;
- Ndryshimet në SNRF 2: Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione;
- Ndryshimet në SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve;
- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Investimet në shitjen dhe blerjen e aktiveve midis investuesit dhe filialeve të tij ose sipërmarrjes së përbashkët; dhe
- Ndryshimet në SNK 40: Transferimi i aktiveve afatgjata materiale të investuara.

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësimet

Banka bën vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmërinë e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacionet rreth supozimeve dhe pasigurive të vlerësimit që kanë rrezik të konsiderueshëm që të rezultojnë në rregullim material në vitet e mëvonshme janë paraqitur më poshtë në lidhje me zhvlerësimin e instrumenteve financiare dhe në Shënimin 28 - përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare.

(i) Ngarkesa e zhvlerësimit për humbjet e kredisë

Banka shqyrton portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar nevojën për zhvlerësim të paktën çdo tre muaj. Në përcaktimin nëse humbja nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave, Banka bën gjykime mbi të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka rënie të matshme të flukseve të ardhshme të parave nga portofoli i kredive para se sa rënia të mund të identifikohet në një kredi specifike të atij portofoli. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në një grup, apo kushtet ekonomike lokale ose kombëtare që lidhen me mos-përmbushjet në aktive në Bankë.

Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në përvojën e kaluar për humbjet nga aktivet me karakteristika të rrezikut të kreditimit dhe evidencë objektive të zhvlerësimit të ngjashme me ato në portofol, kur caktojnë flukset e ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e flukseve të ardhshme të parave rishikohen rregullisht për të zvogëluar diferencat ndërmjet vlerësimeve të humbjes dhe humbjeve aktuale. Rregullimet e faktorëve të humbjes që rrjedhin nga modeli i zhvlerësimit dhe vlerësimet e bëra nga Banka për të pasqyruar kushtet aktuale të zhvlerësimit janë detajuar në Shënimin 3.4 (vii). Si rezultat i rregullimeve të bëra ndaj faktorëve të rrjedhur nga modeli i zhvlerësimit, drejtimi beson se zhvlerësimi i përcaktuar nga Banka përfshin rishikimin e ndryshimeve të pafavorshme, përkatësisht 10% të faktorëve të llogaritur të humbjeve të përdorura në përcaktimin e zhvlerësimit kolektiv. Banka krijon fondin për zhvlerësim kolektiv bazuar në probabilitetin e dështimit në pagesa dhe humbjes si pasojë e saj ("LGD"). Një ndryshim në parametrin LGD prej +/-10%, do të rezultonte në ndryshim në zhvlerësim më 31 dhjetor 2016, prej 380 mijë EUR (2015: 396 mijë EUR).

(ii) Zhvlerësimi i investimeve të vlefshme për shitje

Banka përcakton që investimet e vlefshme për shitje janë zhvlerësuar kur ka pasur ulje të rëndësishme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e tyre. Përcaktimi i asaj që është e rëndësishme ose e zgjatur kërkon gjykim. Gjatë gjykimit, ndër të tjerë faktorë, Banka vlerëson luhatjet normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm kur ka evidencë të përkeqësimit të gjendjes financiare të investitorit, performancës së industrisë dhe sektorit, ndryshime në teknologji dhe flukset operative dhe financuese të mjeteve monetare. Në fund të vitit 31 dhjetor 2016, ndryshimi në vlerën e drejtë në portofolin e aktiveve të vlefshëm për shitje është i parëndësishëm. Bazuar në vlerësimin e Bankës, këto aktive nuk janë zhvlerësuar më 31 dhjetor 2016.

(iii) Aktivet e riposeduar

Banka ka krijuar një politikë në lidhje me vlerën e drejtë të aktiveve të riposeduar të cilat maten në vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerësuesve të jashtëm të certifikuar profesionalë të pasurive. Vlerat më pas rishikohen nga drejtimi i Bankës për burime të rëndësishme jo të vëzhgueshme dhe rregullime të nevojshme të uljes së vlerës. Një zhvlerësim fillestar prej 20% është njohur nga Banka për të gjitha aktivet (shih Shënimin 10 për detaje të mëtejshme). Vlera e drejtë e aktiveve të riposeduar klasifikohet në aspektin e hierarkisë së vlerës së drejtë në nivelin 3, meqenëse Banka ka përdorur burimeve të kërkimit, supozimet dhe burimet që lidhen me pronat e karakteristikave përkatëse dhe për këtë arsye përfshijnë një gamë të burimeve jo të vëzhgueshme të tregut.

(iv) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive janë të mbështetur në çmimet e kuotuar të tregut ose kuotimet e çmimeve të tregtarëve. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare, Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit. Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele gjykimit në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimet e caktimit të çmimit dhe rreziqe të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik. Shih Shënimin 28 (i) për detaje të mbi vlerën e drejtë.

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Gjykimet kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)

(iv) Përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Banka mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve.

- Niveli 1: të dhënat që janë çmimet e tregut të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për instrumente identike.
- Niveli 2: të dhënat tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme qoftë drejtpërdrejt (d.m.th. çmimet) ose tërthorazi (d.m.th. të nxjerra nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmimet e kuotuar për instrumente identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika të tjera të vlerësimit ku të gjitha të dhënat janë drejtpërdrejt ose tërthorazi të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: të dhënat që nuk janë të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin gjithë instrumentet për të cilat metoda e vlerësimit përfshin të dhëna që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhënat jo të vëzhgueshme kanë efekt të madh në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuar për instrumente të ngjashme për të cilat kërkohen korrigjime të rëndësishme jo të vëzhgueshme ose supozime për të pasqyruar dallimet ndërmjet instrumenteve.

Banka i njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese, gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

Për më shumë informacione për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare shih shënimin 28 Instrumentet Financiare: menaxhimi i rrezikut dhe vlerat e drejta.

5. Arka dhe Banka Qendrore

	2016	2015
Mjete monetare	16,639	16,621
Llogaritë rrjedhëse me bankat	12,235	5,246
<i>Fondet në BQK</i>		
Llogaritë rrjedhëse	1,534	20,549
Llogaria e rezervës së detyrueshme	30,454	30,460
	60,862	72,876

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime të likuiditetit, Banka duhet të mbajë si rezerva të detyrueshme një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit. Rezervat e detyrueshme mund të mbahet në formë të instrumenteve shumë likuide, duke përfshirë mjetet monetare, llogaritë në BQK ose në bankat e tjera në Kosovë, si dhe, shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jetë më pak se gjysma e totalit të rezervave të detyrueshme.

6. Huatë dhe paradhënie për bankat

	2016	2015
Huatë dhe paradhënie për bankat	14,699	5,004
	14,699	5,004

Huatë dhe paradhëniet për bankat më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 kanë afat maturimi fillestar më pak se 3 muaj dhe janë të përfshirë në ekuivalentë të mjeteve monetare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare përfshijnë:

	2016	2015
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	28,874	21,867
Gjendja e pakushtëzuar në BQK	1,534	20,549
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	14,699	5,004
	45,107	47,420

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***7. Huatë dhe paradhënie për klientët**

	2016	2015
Huatë për klientët	280,326	265,005
Overdraft	38,199	41,406
Karta krediti	34,170	33,804
Huatë ndaj klientëve	352,695	340,215
Fondi për zhvlerësimin e kredive për klientët	(24,240)	(26,471)
	328,455	313,744

Lëvizja në fondin për zhvlerësimin e kredive për klientët është si vijon:

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	26,471	25,396
(Rimarrja)/shesat gjatë vitit	(2,202)	1,099
Kreditë e çregjistruara	(29)	(24)
Gjendja më 31 dhjetor	24,240	26,471

Më 31 dhjetor 2016, dhjetë huamarrësit më të mëdhenj përbëjnë 7.9% (2015: 6.7%) të totalit të kredive.

Më 31 dhjetor 2016, huatë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë interesin e përlloritur prej 1,716 mijë EUR (2015: 1,746 mijë EUR) dhe tarifën e shtyrë të disbursimit prej 1,183 mijë EUR (2015: 1,214 mijë EUR)

8. Aktive financiare të vlefshëm për shitje

	2016	2015
Bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës	1,982	996
Obligacionet e Qeverisë së Kosovës	12,745	9,292
	14,727	10,288

Kthimet për Obligacionet qeveritare dhe Bonot e Thesarit variojnë nga 2.55% në 5.15% dhe nga 0.20% në 3.79%, respektivisht (2015: nga 0.03% në 3.2% dhe nga 0.45% në 4.00%).

9. Aktive të tjera financiare

	2016	2015
<i>Jo-derivative:</i>		
Të arkëtueshme nga tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë dhe kartave të kreditit	1,398	1,540
Të arkëtueshme nga institucionet financiare	840	21
Aktivitet e tjera financiare	96	170
<i>Derivatet:</i>		
Kontratat derivative 'swap' të valutës së huaj	309	189
	2,643	1,920

10. Aktive të tjera

	2016	2015
Shpenzimet e parapaguara	215	68
Aktive të riposeduara	1,618	885
Të tjera	84	228
	1,917	1,181

Aktivitet e riposeduara përbëhen kryesisht nga prona të paluajtshme të përfituara me anë të ekzekutimit të kolateraleve ndaj huave dhe paradhëniet të klientëve. Tri pronat më të mëdha më 31 dhjetor 2016 përfaqësojnë 57% të vlerës totale të aktiveve të riposeduara. Banka zakonisht i përfiton këto prona në ankandin e tretë me një vlerë prej 1/3 të vlerësimit të dhënë nga specialistët e jashtëm të vlerësimit. Këto vlera zhvlerësohen me 20% në vitin e parë kur aktivitet njihen dhe çregjistrohen në fund të vitit të pestë, që pason njohjen fillestare.

Lëvizjet në aktivitet e riposeduara gjatë vitit janë paraqitur më poshtë:

TEB SH.A.

Shënimet e pasqyrave financiare

Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

10. Aktive të tjera (vazhdim)

	2016	2015
Gjendja në fillim të vitit	885	307
Shtesat	955	799
Nxjerrjet nga përdorimi	(39)	-
Zhvlerësimi i aktiveve	(183)	(221)
Gjendja në fund të periudhës	1,618	885

11. Aktive afatgjatë materiale

	Toka	Përmirësimet e objekteve me qira	Mobilje, orendi dhe pajisje	Kompjuterë dhe pajisje lidhëse	Automjete	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2015	1,200	3,750	280	6,738	948	12,916
Shtesat	-	166	23	521	-	710
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	(7)	(187)	-	(194)
Më 31 dhjetor 2015	1,200	3,916	296	7,072	948	13,432
Shtesat	-	51	6	1,371	105	1,533
Nxjerrje nga përdorimi	-	(81)	-	-	-	(81)
Më 31 dhjetor 2016	1,200	3,886	302	8,443	1,053	14,884
Zhvlerësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2015	-	2,973	203	4,824	642	8,642
Shpenzimi i vitit	-	327	47	744	111	1,229
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	(8)	(181)	-	(189)
Më 31 dhjetor 2015	-	3,300	242	5,387	753	9,682
Shpenzimi i vitit	-	294	32	719	85	1,130
Nxjerrje nga përdorimi	-	(81)	-	-	-	(81)
Më 31 dhjetor 2016	-	3,513	274	6,106	838	10,731
Vlera kontabël neto						
Më 31 dhjetor 2015	1,200	616	54	1,685	195	3,750
Më 31 dhjetor 2016	1,200	373	28	2,337	215	4,153

Toka e blerë në vitet e kaluara do të përdoret nga Banka për ndërtimin e mjediseve të reja të Bankës.

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***12. Aktive afatgjatë jo-materiale**

	Programe komjuterike (software)
<i>Kosto</i>	
Më 1 janar 2015	3,190
Shtesat	1,998
Më 31 dhjetor 2015	5,188
Shtesat	1,312
Më 31 dhjetor 2016	6,500
<i>Amortizimi i akumuluar</i>	
Më 1 janar 2015	2,360
Shpenzimi i vitit	1,105
Më 31 dhjetor 2015	3,465
Shpenzimi i vitit	1,337
Më 31 dhjetor 2016	4,802
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2015	1,723
Më 31 dhjetor 2016	1,698

Të gjitha aktivet e patrupëzuara janë aktive të blera dhe amortizohen gjatë jetës së tyre të dobishme.

13. Detyrime ndaj klientëve

	2016	2015
Llogari kursimi		
Individë	165,800	160,057
Shoqëri të mesme dhe të vogla	55,082	56,346
Korporata dhe shoqëri tregtare	36,727	62,577
	257,609	278,980
Depozita me afat		
Individë	58,820	44,074
Shoqëri të mesme dhe të vogla	8,887	11,718
Korporata dhe shoqëri tregtare	9,151	8,106
	76,858	63,898
	334,467	342,878

Më 31 dhjetor 2016 llogaritë e klientëve përfshijnë interesin e përlllogaritur prej 747 mijë EUR (2015: 863 mijë EUR).

Depozitat me afat dhe llogaritë rrjedhëse sipas sektorit në raport me gjendjen totale paraqitet si më poshtë:

	2016	2015
Individë	67%	60%
Ndërmarrje dhe subjekte të tjera juridike	33%	40%
	100%	100%

TEB SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***14. Detyrime të tjera financiare**

	2016	2015
Transfertat e fondeve të klientëve në transit	1,704	990
Bonuse të pagueshme për karta të kredit	731	662
Detyrime ndaj furnitorëve	1,583	390
Shërbimi i telefonisë bankare me SMS -	75	70
Parapagimet për kartat e kreditit	191	54
	4,284	2,166

15. Detyrime të tjera

	2016	2015
<i>Provizionet për:</i>		
Garancitë	37	119
Lejet e papërdorur	-	17
Rastet ligjore	43	43
Provizion për tarifat e mirëmbajtjes së llogarisë	205	-
Bonuset	-	146
<i>Tatimet dhe shpenzimet sociale të pagueshme:</i>		
Tatimi i mbajtur në burim	41	17
Sigurimet shoqërore	63	47
Tatimi mbi të ardhurat personale	37	37
TVSH-ja dhe tatimet e tjera	75	68
Të tjera	174	-
	675	494

Shpenzimet neto për provizionet gjatë vitit është paraqitur më poshtë:

	2016	2015
<i>Shpenzimet e provizionit:</i>		
Tarifat e përlllogaritura të mirëmbajtjes së llogarisë	(205)	-
Bonuset	-	(146)
Çështjet ligjore dhe pretendimet	-	(102)
Pushimi vjetor i papaguar	-	(5)
<i>Rimarrje e provizioneve:</i>		
Garancitë	82	27
Pushimi vjetor i papaguar	20	-
Shpenzimi në pasqyrën e fitimit ose humbjes	(103)	(226)

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***16. Huatë**

	2016	2015
Borxhi i varur	4,500	4,500
Huatë e tjera	13,143	6,571
Tarifat administrative të shtyra	(153)	(130)
Interesi i përlllogaritur	32	34
	17,522	10,975

Gjatë vitit 2013 Banka nënshkroi një marrëveshje huaje të varur me Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC) në vlerë prej 4,500 mijë EUR. Qëllimi i huasë është që t'i ofrojë Bankës kapital të Klasit 2 dhe t'i lejojë Bankës përdorimin e flukseve për të financuar aktivitetet e saj të përgjithshme të huadhënies. Huaja do të paguhet me një kësht të vetëm pas 10 vitesh nga data e disbursimit. Interesi paguhet dy herë në vit. Norma vjetore e interesit për këtë hua është 4.77%.

Në vitet 2013 dhe 2014 Banka nënshkroi dy marrëveshje huaje në vlerë totale prej 5,000 mijë EUR me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Norma e interesit është 3% në vit. Qëllimi i këtyre huave është financimi i huave për eficiencë në energji. Gjendja e principalit të papaguar më 31 dhjetor 2016 është 2,143 mijë EUR (2015: 3,571 mijë EUR).

Në vitet 2014, 2015 dhe 2016 Banka nënshkroi tri marrëveshje huaje për një vlerë totale prej 8,000 mijë EUR me BERZH-in. Normat e interesit variojnë nga 2.6% në 3.3% në vit. Qëllimi i këtyre huave është financimi i huave për promovimin e aktiviteteve sipërmarrëse tek femrat. Gjendja e principalit të papaguar më 31 dhjetor 2016 është 8,000 mijë EUR (2015: 3,000 mijë EUR)

Huatë përfshijnë një hua afatshkurtër nga IS-Bank Londër, prej 3,000 mijë EUR (2015: zero). Norma vjetore e interesit është 0.7% në vit.

17. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i nënshkruar dhe i paguar i Bankës më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përfshin 2,400 mijë aksione të zakonshme me vlerë nominale 10 euro secili.

Aksionari	Më 31 dhjetor 2016		Më 31 dhjetor 2015	
	Përqindja e pronësisë	Shuma	Përqindja e pronësisë	Shuma
TEB Holding A.S.	100%	24,000	100%	24,000
	100%	24,000	100%	24,000

Aksionet janë aksione të zakonshme për nga natyra dhe nuk kanë preferenca, dhe as kufizime bashkëngjitur. Të gjitha aksionet janë paguar plotësisht.

18. Të ardhurat nga interesi

	2016	2015
Huatë dhe paradhëniet për klientët	30,231	32,596
Aktive financiare të vlefshëm për shitje	241	243
Huatë dhe paradhëniet për bankat	81	4
	30,553	32,843

Gjatë vitit 2016, Banka nuk ka përlllogaritur dhe nuk ka njohur interes nga kreditë e zhvlerësuara individualisht në një vlerë prej 560 mijë Euro (2015: 447 mijë EUR)

19. Shpenzimet e interesit

	2016	2015
Depozitat me afat	1,060	1,745
Huatë	445	748
Llogaritë e kursimit	11	7
	1,516	2,500

Normat e interesit për depozita me afat variojnë nga maturiteti i depozitave. Normat e interesit për depozita me afat ndryshojnë nga 0% në 2% më 31 dhjetor 2016 (2015: nga 0.01% në 1.5%).

TEB SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***20. Të ardhurat nga komisionet**

	2016	2015
Kartat e kreditit	4,391	4,258
Tarifat mbi shërbimet e llogarisë	1,294	783
Pagesat ndërkombëtare	1,128	1,495
Pagesat lokale	617	341
Garancitë dhe letër kreditë	236	666
Shërbimet bankare me SMS	223	217
Tarifa të tjera	204	144
	8,093	7,904

21. Shpenzimet e komisioneve

	2016	2015
Kartat e kreditit	1,027	766
Tarifat e Bankës Qendrore	297	281
Pagesat ndërkombëtare	204	206
Pagesat lokale	138	94
Garancitë dhe letër kreditë	38	51
Tarifa të tjera	113	156
	1,817	1,554

22. Shpenzime personeli

	2016	2015
Shpenzimet e pagave	6,109	6,118
Bonuset	491	354
Kontributet e detyrueshëm të pensionit	293	282
Sigurimi shëndetësor	98	130
Trajnimi i stafit	88	89
Shpenzime të tjera	11	32
	7,090	7,005

23. Shpenzimet administrative dhe shpenzimet e tjera operative

	2016	2015
Qiraja operative	1,507	1,503
Telekomunikimet	763	828
Siguria dhe primet e sigurimit	975	747
Marketingu dhe sponsorizimi	504	582
Shpenzimet e shërbimeve, kartat e kreditit	129	196
Udhëtimi	440	370
Tarifat për konsulentë dhe profesionale	387	447
Shpenzime kancelarie	378	241
Shpenzimet e tjera operative	-	62
Shërbimet komunale	286	349
Riparime dhe mirëmbajtje	269	259
Shpenzimet e pastrimit	156	161
Tatimet dhe licencat e biznesit	215	172
Përfaqësimet	103	127
Tarifat ligjore, të ekzekutimit të kolateralit dhe të auditimit	627	478
Tarifat e mirëmbajtjes së softuerit	242	139
Tatime dhe komisione	-	7
Shpenzimet e mirëmbajtjes së pikave të shitjes	18	43
Humbje në shitjen ose nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve fikse	-	6
Tarifa e përlllogaritur të fshira të e mirëmbajtjes	192	-
Provizionet për mirëmbajtjen e përlllogaritur dhe tarifat e kartave	205	-
Shpenzime të tjera	326	280
	7,722	6,997

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***24. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

	2016	2015
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	(2,193)	(2,063)
Kreditimi tatimor i shtyrë	11	19
	(2,182)	(2,044)

Më poshtë detajohet përlogaritja e normës efektive tatimore dhe barazimi i shpenzimit aktual i tatimit mbi të fitimin:

		2016		2015
Fitimi para tatimit		20,515		19,380
Tatimi duke përdorur normën 10%	10.0%	2,052	10.0%	1,938
Shpenzime të pazbritshme	0.8%	152	0.6%	125
Krijimi i diferencave të përkohshme për zhvlerësimin e huave	(0.1%)	(11)	(0.1%)	(19)
Totali i shpenzimit për tatim mbi fitimin	10.7%	2,193	10.5%	2,044

Shpenzimit aktual i tatimit mbi të fitimin llogaritet në bazë të rregullave në fuqi në Kosovë duke përdorur normat tatimore në fuqi në ditën e raportimit. Norma e tatimit mbi fitimin është 10% (2015: 10%).

Diferencat midis pasqyrave financiare sipas SNRF-ve dhe atyre sipas rregullave fiskale në Kosovë, sjellin diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të huave dhe paradhënies për klientë për qëllime të raportimit sipas SNRF-ve dhe për qëllime fiskale. Efekti tatimor i këtyre diferencave të përkohshme llogaritet në normën prej 10%.

Ndryshimet në tatimin e shtyrë

	2016	2015
Gjendja më 1 janar	90	71
Kredi për vitin	11	19
Totali i aktivitetit tatimor i shtyrë për zhvlerësimin e kredive	101	90

TEB SH.A.**Shënimet e pasqyrave financiare****Për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***25. Palët e lidhura**

Banka kontrollohet nga TEB Holding A.S, e themeluar në Turqi (Banka Mëmë), e cila ka në pronësi 100% të aksioneve të zakonshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 (shih Shënimin 1).

Tabela në vijim përmbledh transaksionet me palët të lidhur dhe gjendjet më 31 dhjetor 2016 si dhe shpenzimet përkatës për vitin .

	2016	2015
<i>Aktivet</i>		
<i>Huatë për klientët</i>		
Drejtimi kryesor	269	273
Totali i huave për klientët	269	273
<i>Huatë dhe paradhëniet për bankat</i>		
TEB A.S.	2	10
BNP Paribas N.Y.	205	5
BNP Paribas	2	1
BNL	2	3
Totali i huave dhe paradhënieve për bankat	211	19
Totali i aktiveve	480	292
<i>Detyrimet</i>		
<i>Detyrimet e tjera</i>		
TEB A.S	120	-
Kompania Mëmë	30	29
Totali i detyrimeve	150	29
<i>Angazhime dhe detyrime të kushtëzuar</i>		
<i>Garancitë e lëshuara nga Banka për:</i>		
TEB Sh.A.	989	698
BNP Paribas	70	100
BNL	50	60
BNP Paribas SA Sucursal en Espana	210	210
Findomestic Bank AD	75	75
Totali i angazhimeve dhe detyrimeve të kushtëzuar	1,394	1,143
<i>Shpenzimet</i>		
<i>Shpenzimet e interesit</i>		
TEB Sh.A.	2	1
Findomestic Bank AD	37	-
BNP Paribas	-	1
Totali i shpenzimeve	39	2
<i>Kompensimi i drejtimit kryesor</i>		
<i>Drejtimi ekzekutiv</i>		
Pagat	303	347
Bonuset	201	106
Totali i kompensimit të drejtimit kryesor	504	453

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***26. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara****Garancitë dhe letër kreditë**

Angazhimet që lidhen me huatë përfshijnë angazhimet për zgjatjen e huasë, letrave të kredisë dhe garancive të dhëna, që janë dizajnuar në mënyrë që t'i përmbushin nevojat e klientëve të Bankës. Letër kreditë dhe garancitë detyrojnë Bankën të bëjë pagesa në emër të detyrimeve të kushtëzuara të klientëve, në rast se klienti dështon të përmbushë kushtet e kontratës.

Angazhimet për kreditim përfaqësojnë angazhimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe për të rinovuar kreditë ekzistuese. Përgjithësisht, angazhimet kanë data fikse maturimi, ose klauzola të tjera përfundimi. Duke qene se angazhimet mund të përfundojnë para tërheqjes së të gjithë shumës, vlerat totale jo domosdoshmërisht përfaqësojnë kërkesat për para.

Shuma agregate e papaguar e garancive dhe letër kredive të lëshuara nga Banka është si vijon:

	2016	2015
Garanci dhënë në favor të klientëve	6,901	7,780
Letër kreditë	1,018	774
Garancitë e tjera	23	20
	7,942	8,574
Angazhime për kredi të patërhequra	69,818	63,908
	77,760	72,482

Banka përllongarit provizionin kolektiv për garancitë dhe letër kreditë duke shfrytëzuar përqindjet e mëposhtëm për ekspozimet në bazë të klasifikimit që ata u kanë bërë klientëve të caktuar për ekspozimin e tyre kreditor:

- 0.20% për klientë që kanë ekspozim kreditor të klasifikuar si kredi standarde (0-30 ditë në vonesë)
- 1.0% për klientë që kanë ekspozim kreditor të klasifikuar si kredi në vëzhgim (31-60 ditë në vonesë)
- 50% dhe 100% për klientë që kanë ekspozim kreditor të klasifikuar respektivisht si nën-standarde ose të dyshimta (61 - 180 ditë në vonesë) dhe të humbur (mbi 180 ditë në vonesë).

Çështjet ligjore

Gjatë aktivitetit normal të Bankës, kjo e fundit haset me çështje dhe pretendime gjyqësore. Drejtimi i Bankës ka mendimin se humbjet e mundshme nga çështje dhe pretendime gjyqësore janë jo materiale deri më 31 dhjetor 2016 (31 dhjetor 2015: njëlloj), përveç rasteve ku provizioni është regjistruar siç mund ta shihni në shënimin 15.

Angazhime për qiratë operative

Banka ka angazhime gjendje sipas kontratave të pa anulueshme për qira që duhen shlyer brenda datave si vijon:

	2016	2015
Brenda një viti	1,236	1,456
Brenda dy deri në pesë vite	1,178	2,033
	2,414	3,489

27. Ngjarjet pas datë së raportimit

Pas datës së raportimit janë emëruar dy anëtarë të rinj të Bordit të Drejtorëve. Dy anëtarët e rinj janë Z. Sabri Davaz dhe Znj. Esra Peri Aydogan me një mandat 4 vjeçar, në fuqi nga data 1 mars 2017.

Përveç kësaj, Z. Orçun Ozdemir u emërua Drejtor i Përgjithshëm i Bankës dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve me një mandat 4 vjeçar, në fuqi nga data 1 prill 2017 duke zëvendësuar Z. Ayhan Albeyoglu.

Nuk ka pasur ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat kërkojnë paraqitje në pasqyrat financiare.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe administrimi i rrezikut****a. Administrimi i kapitalit**

Objektivat e Bankës me rastin e administrimit të kapitalit janë:

- (i) të jetë në përputhje me kërkesat për kapital të vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK);
- (ii) të ruajë aftësinë e Bankës për ta vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe për të vazhduar të ofrojë kthime nga investimi për aksionarin; dhe
- (iii) të mbajë një bazë të fortë kapitale për ta mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen rregullisht nga drejtimi i Bankës që përdor teknika në bazë të udhëzimeve të BQK-së. Informacionet e kërkuar i raportohen BQK-së në baza tremujore.

Aktivitetet klasifikohen duke përdorur një renditje prej pesë ponderimesh të rrezikut, duke pasqyruar një vlerësim të rrezikut të kredisë, tregut dhe rreziqeve të tjera që lidhen me çdo aktiv dhe ekspozimet jashtë bilancit.

Rregullorja kërkon nga Bankat që ta mbajnë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 7,000 mijë EUR, të mbajnë raportin minimal të Kapitalit të Nivelit I ndaj aktiveve të ponderuar me rrezik prej 8%, ta mbajnë kapitalin minimal rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik në 12% dhe kapitalin total në proporcion me aktivet totale (raporti i levës) në 7% minimumi.

Raportet Minimale të Kapitalit të Bazuar në Rrezik

Nivelet e kapitalit, aktivet e ponderuar me rrezik dhe raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit sipas rregulloreve të BQK-së më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë:

	2016	2015
<i>Kapital i nivelit I</i>		
Kapitali aksionar	24,000	24,000
Fitimet e pashpërndara sipas raportimit për Bankën Qendrore të Kosovës	48,234	29,803
Pakësuar: Aktivet afatgjata jomateriale	(1,698)	(1,723)
Huatë për personat e lidhur me Bankën	(480)	(292)
Totali i kapitali kualifikuar në Nivelin e 1	70,056	51,788
Detyrime të varura	4,500	4,500
Provizionet për humbjet nga kreditë (<i>kufizuar në 1.25% të APR-ve</i>)	1,830	2,186
Totali i kapitali kualifikues për Nivelin 2	6,330	6,686
Totali i kapitali rregullator	76,386	58,474
Aktivitetet e ponderuar me rrezik:		
Në bilanc	430,166	307,006
Jashtë bilancit	9,025	7,736
Aktivitetet e rrezikut për rrezikun operacional	40,785	34,505
Totali i aktiveve të ponderuar me rrezik	479,976	349,247
Raporti i kapitalit i nivelit të parë ndaj aktiveve të ponderuar me rrezik	14.60%	14.83%
Raporti i totalit të kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuar me rrezik	15.91%	16.74%
Raporti i totalit të kapitalit ndaj aktiveve totale (raportimi rregullator)	16.79%	13.08%

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****b. Kategoritë e instrumenteve financiare**

Në fund të vitit Banka ka këto instrumente financiare:

	2016	2015
Aktivet financiare		
Paraja e gatshme dhe gjendja me Bankën Qendrore	60,862	72,876
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	5,004
Huatë dhe paradhëniet për klientët	328,455	313,744
Aktive financiare të vlefshëm për shitje	14,727	10,288
Aktive të tjera financiare	2,643	1,920
Totali i aktiveve financiare	421,386	403,832
Detyrimet financiare		
Detyrimet ndaj klientëve	334,467	342,878
Huatë	17,522	10,975
Detyrimet e tjera financiare	4,284	2,166
Totali i detyrimeve financiare	356,273	356,019

c. Objektivat e administrimit të rrezikut financiar

Funksioni i thesarit të Bankës ofron shërbime për biznesin, koordinon qasjen në tregjet financiare lokale dhe ndërkombëtare, monitoron dhe administron rreziqet financiare që lidhen me operacionet e Bankës nëpërmjet raporteve mbi rreziqet e brendshme, të cilat analizojnë ekspozimin në bazë të shkallës dhe madhësisë së rreziqeve. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e kurseve të këmbimit dhe rrezikun e normës së interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Pajtueshmëria me politikat dhe limiteve të ekspozimit rishikohet nga ana e komisioneve drejtuese dhe nga auditorët e brendshëm vazhdimisht. Banka nuk tregton instrumente financiare derivative të rëndësishme.

d. Rreziku i tregut

Aktivitetet e Bankës deri në një masë i ekspozohen mundësisë së humbjeve si pasojë e ekspozimit të instrumenteve financiare ndaj rrezikut të normës së interesit, ose rrezikut të kursit të këmbimit që rezultojnë nga luhajtjet në tregjet financiare. Shumica e transaksioneve të Bankës janë në valutën vendase dhe ekspozimi ndaj rrezikut të këmbimit valutator është i kufizuar.

e. Rreziku i kurseve të këmbimit

Politika për menaxhimin e rrezikut nga kurset e këmbimit në TEB Sh.a. përcakton metodat për administrimin e rrezikut nga kurset e këmbimit në Bankë. Banka administron rrezikun e këmbimit valutator nëpërmjet administrimit të strukturës valutore të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Rreziku i këmbimit valutator administrohet dhe qeveriset sipas politikave të grupit TEB. TEB Sh.a. vazhdimisht monitoron lëvizjet në kurset e këmbimit dhe në tregje të valutave të huaja dhe përcakton pozitën e vet valutore në baza ditore.

Për çdo përjashtim nga kjo politikë duhet të merret miratimi i Bordit të Drejtorëve të TEB Sh.a dhe i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut të grupit TEB. Politika e Bankës dhe e Grupit nuk lejojnë që Banka të mbajë pozicion të hapur valutator për qëllime spekulative. Gjithsesi, derivativat e këmbimit mund të përdoren për qëllime të mbrojtjes për mbylljen e pozicioneve të caktuara, në të cilën ato monitorohen si në nivel lokal ashtu edhe në nivel Grupi.

Banka ndërmerr transaksione në EUR dhe në valutë të huaj dhe nuk ka hyrë në ndonjë marrëveshje të rëndësishme për kontrata forward të këmbimit dhe nuk ka derivativë të integruar më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Meqenëse Banka i raporton pasqyrat e veta financiare në Euro, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet në kurset e këmbimit midis euros dhe valutave të tjera. Ekspozimet e transaksioneve të Bankës mundësojnë fitime ose humbje nga valutat e huaja që njihen në pasqyrën e fitim ose humbjes. Ekspozimi përfshin aktivet monetare dhe detyrimet monetare të Bankës që nuk shprehen në monedhën funksionale të Bankës.

Analiza e ndjeshmërisë ndaj valutës së huaj

Banka kryesisht i ekspozohet dollarit amerikan (USD) dhe frangës zvicerane (CHF). Tabela e mëposhtme paraqet detaje mbi ndjeshmërinë e Bankës ndaj rritjes dhe rënies përkatëse në vlerën e Euros kundrejt valutave të huaja.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)****e. Rreziku kurseve të këmbimit (vazhdim)**

Përqindja e përdorur është norma e ndjeshmërisë e përdorur kur raportohet rreziku i valutës së huaj te personelit drejtues kryesor dhe përfaqëson vlerësimin e drejtimit për ndryshimin e mundshëm në normat e këmbimit të valutës së huaj. Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetarë të hapur në valutë të huaj dhe rregullon përkthimin e tyre në fund të periudhës për ndryshimin përkatës në normat valutore. Banka ka aplikuar një rritje ose ulje prej 10% në normat aktuale të këmbimit valutor. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe kapital ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundrejt valutës përkatëse.

	2016		2015	
	+10% Euro	-10% Euro	+10% Euro	-10% Euro
Aktivitet:				
Ndikimi në mjete monetare dhe detyrimet nga bankat	(509)	622	(274)	335
Detyrimet:				
Ndikimi në detyrime ndaj bankave dhe klientëve	1,094	(1,337)	1,010	(1,235)
Ndikimi neto në fitim ose humbje dhe kapital	585	(715)	736	(900)

Tabelat në vijim përmbledhin pozicionin valutor të Bankës më 31 dhjetor 2016 dhe 2015:

<i>Shumat e paraqitur në EUR '000</i>	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Aktivitet financiarë					
Arka dhe Banka Qendrore	56,775	681	2,444	962	60,862
Huatë dhe paradhëniet për bankat	13,500	1,199	-	-	14,699
Huatë dhe paradhëniet për klientët	328,455	-	-	-	328,455
Aktivitet financiarë të vlefshëm për shitje	14,727	-	-	-	14,727
Aktive të tjera financiare	2,334	301	8	-	2,643
Totali aktivitet	415,791	2,181	2,452	962	421,386
Detyrimet financiarë					
Detyrimet ndaj klientëve	322,433	6,600	4,472	962	334,467
Huatë	17,522	-	-	-	17,522
Detyrime të tjera financiare	4,284	-	-	-	4,284
Totali i detyrimeve	344,239	6,600	4,472	962	356,273
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2016	71,552	(4,419)	(2,020)	-	65,113

<i>Shumat e paraqitur në EUR '000</i>	EURO	USD	CHF	Të tjera	Gjithsej
Aktivitet financiarë					
Arka dhe Banka Qendrore	69,859	364	2,107	546	72,876
Huatë dhe paradhëniet për bankat	5,004	-	-	-	5,004
Huatë dhe paradhëniet për klientët	313,744	-	-	-	313,744
Aktivitet financiarë të vlefshëm për shitje	10,288	-	-	-	10,288
Aktive të tjera financiare	1,920	-	-	-	1,920
Totali aktivitet	400,815	364	2,107	546	403,832
Detyrimet financiarë					
Detyrimet ndaj klientëve	331,764	7,100	3,331	683	342,878
Huatë	10,975	-	-	-	10,975
Detyrime të tjera financiare	2,166	-	-	-	2,166
Totali i detyrimeve	344,905	7,100	3,331	683	356,019
Pozicioni valutor neto më 31 dhjetor 2015	55,910	(6,736)	(1,224)	(137)	47,813

TEB SH.A.

Shënime për pasqyrat financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe administrimi i rrezikut (vazhdim)

e. Rreziku kurseve të këmbimit (vazhdim)

Bazuar në politikat e Grupit, pozicionet valutore të hapura individuale nuk duhet të jenë mbi 5% të kapitalit të nivelit 1 dhe ekspozimi gjithsej në të gjitha valutat nuk duhet të jenë mbi 10% të kapitalit të nivelit 1 në asnjë moment të caktuar kohor, ndërkohë që sipas kërkesave të BQK-së, pozicioni valutor i hapur për çdo valutë nuk duhet të kalojë 15% të kapitalit të nivelit 1 dhe ekspozimi gjithsej nuk duhet të kalojë 30% të kapitalit të nivelit 1.

Më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 Banka ka qenë në pajtueshmëri me këto raporte. Banka mban instrumente financiare derivative për tu mbrojtur kundrejt ekspozimeve të rrezikut nga monedhat në valutë të huaj USD. Kurset e këmbimit të aplikuara për valutat kryesore ndaj euros ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Dollari amerikan (USD)	1.0541	1.0887
Franga Zvicerane (CHF)	1.0739	1.0835

f. Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku se vlera e instrumentit financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe rreziku që maturiteti i aktiveve mbartës të interesit do të ndryshojë nga maturiteti i detyrimeve mbartëse të interesit të përdorura për të financuar këto aktive (rreziku i ri-çmimit). Koha për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar tregon se në çfarë mase instrumenti është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Aktivët dhe depozitat me afat të klientëve kanë norma fikse të interesit, ndërsa huatë kanë normë të ndryshueshme të interesit. Politika e Bankës për administrimin e rrezikut të normës së interesit përcakton metodat e identifikimit, matjes, monitorimit dhe kontrollit të rrezikut në rast të ndryshimit të normës së interesit. Qëllimi i kësaj politike është administrimi i ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit dhe kufizimi i humbjeve të mundshme, si rezultat i ndryshimit të niveleve të normave të interesit në treg dhe efektit të këtyre ndryshimeve në rezultatet e biznesit dhe vlerën e tregut të kapitalit të Bankës.

Departamenti i Administrimit të Rrezikut monitoron ekspozimin ndaj rrezikut të normës së interesit duke përdorur metodën e analizimit të hendekut të normës së interesit. TEB Sh.a përcakton një set të dhënave që janë të bazuara në flukset e mjeteve monetare sipas intervaleve kohore individuale. Parimi i maturitetit të mbetur zbatohet për marrëveshjet me normë fikse të interesit, ndërsa data e ri-përcaktimit të normës së interesit konsiderohet për marrëveshjet me normë të ndryshueshme të interesit. Të gjitha instrumentet dhe pozicionet të cilat janë të ndjeshme ndaj rrezikut të normës së interesit klasifikohen në librin bankar dhe librin tregtar. Pozicionet vëzhgohen në pajtim me këto segmente:

- Pozicionet e ndjeshme në normë të interesit në valutën EUR
- Pozicionet e ndjeshme në normë të interesit në valutat e tjera (vlera totale dhe sipas secilës valutë)

Drejtimi beson se Banka nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në instrumentet e saj financiare, përveç huave të cilat janë me norma të ndryshueshme të interesit. Kreditë dhe depozitat kanë norma fikse të interesit.

Analiza e ndjeshmërisë

Administrimit të rrezikut të normës së interesit vëzhgon ndjeshmërinë e të ardhurave bankare neto të Bankës dhe kapitalit, ndaj skenarëve të ndryshëm të luhatjes së normës së interesit. Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit është përcaktuar në bazë të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në datën e raportimit. Analiza supozon një rritje paralele të normave të interesit për 100 pikë bazë ($\pm 1\%$) në nivel të të ardhurave bankare neto.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit dhe ndikimi i saj në pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e fitimit dhe humbjes të Bankës matet përmes metodologjisë, Vlera e Pikëve Bazë. Rezultatet e paraqitura më poshtë paraqesin ndryshimet në fitim ose humbje dhe kapital, të cilat do të ndodhin në qoftë se normat e interesit do të rriten ose bien me 100 pikë bazë brenda vitit. Analiza e ndjeshmërisë së fitimit ose humbjes dhe kapitalit ndaj ndryshimeve në normat e interesit është si vijon:

Ndjeshmëria e fitimit ose humbjes	2016	2015
Rritja në pikë bazë +100 pikë bazë zhvendosje paralele	(112)	(667)
Rënia në pikë bazë -100 pikë bazë zhvendosje paralele	(535)	(188)

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****f. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)****Analiza e ndjeshmërisë**

	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite	Gjithsej
31 dhjetor 2016						
Aktivitet financiarë						
Arka dhe Banka Qendrore	60,862	-	-	-	-	60,862
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	-	-	-	-	14,699
Huatë dhe paradhëniet për klientët	42,525	10,395	37,512	178,200	59,823	328,455
Aktivitet financiarë të vlefshëm për shitje	10	12,479	610	1,628	-	14,727
Aktive të tjera financiare	2,643	-	-	-	-	2,643
Totali aktivitet	120,739	22,874	38,122	179,828	59,823	421,386
Detyrimet financiarë						
Detyrimet ndaj klientëve	273,978	5,113	30,977	24,368	31	334,467
Huatë	33	3,000	714	9,335	4,440	17,522
Detyrime të tjera financiare	4,284	-	-	-	-	4,284
Totali i detyrimeve	278,295	8,113	31,691	33,703	4,471	356,273
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj normës së interesit	(157,556)	14,761	6,431	146,125	55,352	65,113

	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3-12 muaj	1-5 vite	Më shumë se 5 vite	Gjithsej
31 dhjetor 2015						
Aktivitet financiarë						
Arka dhe Banka Qendrore	72,876	-	-	-	-	72,876
Huatë dhe paradhëniet për bankat	5,004	-	-	-	-	5,004
Huatë dhe paradhëniet për klientët	62,861	23,089	96,840	120,315	10,639	313,744
Aktivitet financiarë të vlefshëm për shitje	50	9,285	269	684	-	10,288
Aktive të tjera financiare	1,920	-	-	-	-	1,920
Totali aktivitet	142,711	32,374	97,109	120,999	10,639	403,832
Detyrimet financiarë						
Detyrimet ndaj klientëve	284,504	2,952	30,411	25,006	5	342,878
Huatë	-	-	1,643	9,332	-	10,975
Detyrime të tjera financiare	2,166	-	-	-	-	2,166
Totali i detyrimeve	286,670	2,952	32,054	34,338	5	356,019
Hendeku i ndjeshmërisë ndaj normës së interesit	(143,959)	29,422	65,055	86,661	10,634	47,813

28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

g. Rreziku i kredisë

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë nëpërmjet aktiviteteve të saj të kreditimit dhe kur ajo vepron si ndërmjetës në emër të klientëve ose palëve të tjera të treta ose me lëshimin e garancive. Në këtë aspekt, Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale. Administrimi i ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë ndaj huamarrësve bëhet me anë të analizës së rregullt të aftësisë kreditore të huamarrësve. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë pjesërisht administrohet me sigurimin e kolateralit dhe të garancive. Politikat dhe procedurat e rrezikut të kredisë shqyrtohen dhe përditësohen në baza vjetore në mënyrë që të jetë në përputhje me rregulloren e BQK-së dhe standardet e Grupit.

Ekspozimi primar i Bankës ndaj rrezikut të kredisë vjen nëpërmjet huave dhe paradhënieve të saj për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë drejtim përfaqësohet nga vlerat kontabël neto e aktiveve në datën e raportimit. Po ashtu, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë të zërave jashtë bilancit nga angazhimet dhe garancitë e lëshuar.

Rreziku i kredisë i nivelit të parë vlerësohet nga Departamenti i Shpërndarjes dhe Monitorimit të Kredive, ndërsa rreziku i kredisë i nivelit të dytë monitorohet nga Departamenti i Administrimit të Rrezikut dhe Kontrollit të Brendshëm dhe i raportohen Bordit të Drejtorëve ("BiD").

Autoriteti i Delegimit të Kompetencës të Kredisë caktohet dhe rishikohet nga BiD-ja në baza të rregullt. Për propozimet e kredive përtej pragut të caktuar nevojitet miratimet nga Komiteti i Kredive, ndërsa ekspozimet në vlerë më të madhe se 250 mijë EUR janë subjekt i miratimit nga Komiteti i Nivelit të Lartë të Kredive.

Të gjitha ekspozimet kreditore rishikohen në baza vjetore, ndërsa ekspozimet e mëdha monitorohen më shpesh. Banka ka themeluar Njësinë e Monitorimit të Korporatave dhe Njësinë e Cilësisë së Kredive, me mandat vëzhgimin dhe monitorimin e ekspozimeve të mëdha të korporatave çdo muaj dhe raporton të Komiteti i Kredive në rast të identifikimit të përkeqësimit të kredisë. Procesi i monitorimit konsideron, por nuk është i kufizuar në; flukset e mjeteve monetare dhe performancën e shitjes, marrëveshjet e kredisë, sjelljen në pagesa, përfitueshmërinë, likuiditetin, aftësinë paguese dhe raportin e borxhit.

Përqendrimet e rrezikut të kredisë (duke përfshirë ekspozimet jashtë bilancit) që rrjedhin nga instrumentet financiare ekzistojnë për palët e tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që do të çonin në pamundësinë e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të ndikuara nga ndryshimet në kushtet ekonomike apo të tjera.

Për matjen e mëtejshëm dhe zhvlerësimin e aktiveve, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive për zhvlerësim. Nëse përcaktohet se nuk ka evidencë objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të vlerësuar individualisht, qoftë ai i rëndësishëm ose jo, atëherë aktivi përfshihet në një grup të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të kredisë dhe Banka i vlerëson ato për zhvlerësim në mënyrë kolektive.

Banka ka krijuar Komitetin i Provizionimit i cila përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Bankës, Administratori i Rrezikut dhe Drejtori i Rrezikut të Kredisë. Ky komitet është përgjegjës për vëzhgimin e procesit të vlerësimit mujor dhe për vlerësimet individuale për zhvlerësim. Vlerësimi individual bëhet për ekspozimet që mbartin rrezik individualisht të rëndësishëm dhe bazohen në informacione dhe vëzhgime të marrë nga departamentet në terren, të tilla si Departamenti i Shpërndarjes dhe Monitorimit të Kredive .

Llogaria për zhvlerësimin e kredisë më 31 dhjetor 2016 ka rënë kryesisht si pasojë e rënies në kreditë jo-performuese, për të cilat janë caktuar burime shtesë. Banka ka krijuar një strukturë monitoruese me qëllim të administrimit të ekspozimeve në fazat e hershme të vonesës së kredisë. Përveç kësaj, prezantimi i Agjentëve Privatë të Përmbarimit (PEA) dhe Kompanive të kontraktuara për mbledhjen e borxhit kanë rezultuar në rritje të arkëtimit nga kreditë jo-performuese.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****g. Rreziku kreditor (vazhdim)****Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë::**

	Ekspozimi maksimal bruto	Lejimi për zhvlerësim	Ekspozimi maksimal neto	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2016				
Arka dhe Banka Qendrore	60,862	-	60,862	-
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	-	14,699	-
Huatë për individë	172,593	(7,233)	165,360	98,418
Huatë për klientët	139,716	(4,000)	135,716	98,375
Overdrafte	2,241	(197)	2,044	43
Karta krediti	30,636	(3,036)	27,600	-
Huatë për persona juridikë	180,102	(17,007)	163,095	130,130
Huatë për persona juridikë	140,610	(14,360)	126,250	108,002
Overdrafte	35,958	(2,353)	33,605	22,128
Karta krediti	3,534	(294)	3,240	-
Totali huave dhe paradhëniet për klientët	352,695	(24,240)	328,455	228,548
Aktive financiare të vlefshëm për shitje	14,727	-	14,727	-
Letër kreditë	1,022	(4)	1,018	-
Letër garancitë	6,934	(33)	6,901	-
Garancitë dhe dëmshpërblime të tjera	23	-	23	-
Angazhimet për kredi	69,818	-	69,818	-
Detyrimet e kushtëzuar	77,797	(37)	77,760	-
	Ekspozimi maksimal bruto	Lejimi për zhvlerësim	Ekspozimi maksimal neto	Vlera e drejtë e kolateralit
Më 31 dhjetor 2015				
Arka dhe Banka Qendrore	72,876	-	72,876	-
Huatë dhe paradhëniet për bankat	5,004	-	5,004	-
Huatë për individë	158,703	(7,013)	151,690	87,128
Huatë për klientët	126,819	(3,930)	122,889	86,900
Overdrafte	2,020	(209)	1,811	228
Karta krediti	29,864	(2,874)	26,990	-
Huatë për persona juridikë	181,512	(19,458)	162,054	131,719
Huatë për persona juridikë	138,383	(16,265)	122,118	107,604
Overdrafte	39,437	(2,896)	36,541	24,115
Karta krediti	3,692	(297)	3,395	-
Totali huave dhe paradhëniet për klientët	340,215	(26,471)	313,744	218,847
Aktive financiare të vlefshëm për shitje	10,288	-	10,288	-
Letër kreditë	775	(1)	774	-
Letër garancitë	7,828	(48)	7,780	-
Garancitë dhe dëmshpërblime të tjera	40	(20)	20	-
Angazhimet për kredi	63,958	(50)	63,908	-
Detyrimet e kushtëzuar	72,601	(119)	72,482	-

TEB SH.A.
Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)

g. Rreziku i Kredisë (vazhdim)

Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë përmbledhur si më poshtë:

	2016		2015	
	Huatë dhe paradhëniet për klientët	Huatë dhe paradhëniet për bankat	Huatë dhe paradhëniet për klientët	Huatë dhe paradhëniet për bankat
As në vonesë, as të zhvlerësuara	318,845	14,699	304,758	5,004
Me vonesë por jo të zhvlerësuara	12,163	-	11,210	-
Të zhvlerësuara	21,687	-	24,247	-
Huatë bruto	352,695	14,699	340,215	5,004
<i>Minus: Zhvlerësimi</i>				
Individual	(20,438)	-	(22,511)	-
Kolektiv	(3,802)	-	(3,960)	-
Huatë neto	328,455	14,699	313,744	5,004

Kreditë për klientët	2016			2015		
	Individët	Subjektet	Gjithsej	Individët	Subjektet	Gjithsej
As në vonesë, as të zhvlerësuara	161,525	157,320	318,845	149,056	155,702	304,758
Me vonesë por jo të zhvlerësuara						
<i>1 deri në 30 ditë</i>	2,565	2,910	5,475	1,951	5,815	7,766
<i>31 deri në 90 ditë</i>	1,626	5,062	6,688	881	2,563	3,444
	4,191	7,972	12,163	2,832	8,378	11,210
Kreditë e zhvlerësuara	6,841	14,846	21,687	6,814	17,433	24,247
Totali	172,557	180,138	352,695	158,702	181,513	340,215
Zhvlerësimi	(7,233)	(17,007)	(24,240)	(7,013)	(19,458)	(26,471)
Huatë neto	165,324	163,131	328,455	151,689	162,055	313,744

Vlera e drejtë e kolateraleve	2016			2015		
	Individët	Subjektet	Gjithsej	Individët	Subjektet	Gjithsej
As në vonesë e as të zhvlerësuara	94,291	114,362	208,653	82,286	111,212	193,498
Në vonesë por jo të zhvlerësuara	1,764	6,156	7,920	2,658	8,244	10,902
Kreditë e zhvlerësuara	2,363	9,612	11,975	2,184	12,263	14,447
	98,418	130,130	228,548	87,128	131,719	218,847

Llojet e kolateralit	2016			2015		
	Individët	Subjektet	Gjithsej	Individët	Subjektet	Gjithsej
Hipotekë	14,744	76,183	90,927	14,921	69,493	84,414
Kolateral në mjete monetare	3,042	3,639	6,681	4,151	4,181	8,332
Mallrat dhe pajisje të lëna peng	73,105	29,486	102,591	59,104	33,761	92,865
Automjete të lëna peng	7,527	20,822	28,349	8,952	24,284	33,236
Totali	98,418	130,130	228,548	87,128	131,719	218,847

Vlera e drejtë e kolateraleve e paraqitur më lart përcaktohet nga vlerësues të certifikuar lokal të brendshëm dhe të jashtëm të Bankës dhe ka për qëllim ta përfaqësojë vlerën e tregut të realizueshme nga pronarët ligjorë të tyre. Për shkak të rrethanave në Kosovë ku tregu nuk është aktiv, Banka synon të ketë një qasje konservatore në përcaktimin e vlerës së kolateraleve. Banka synon të përdorë kolaterale që mund të konvertohen në aktive likuide brenda një periudhe të shkurtër kohore.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****g. Rreziku kreditor (vazhdim)*****Huatë dhe paradhëniet******Kreditë me kushte të ri-negociuara***

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë rinegociime të cilat nuk do të konsideronte në rast tjetër. Vendim për ristrukturim i nënshtrohet parakushteve vijuese:

- ristrukturimi rrit probabilitetin që klienti të jetë në gjendje ta paguajë ekspozimin;
- plani i ri i pagesave është në harmoni me kapacitetin aktual dhe të pritur të klientit për pagesë në të ardhmen;
- huamarrësi ofron kolateral shtesë, nëse është e mundshme dhe e përshtatshme.

Huatë me kushte të rinegociuara	2016	2015
As në vonesë, as të zhvlerësuara	1,428	748
Me vonesë por jo të zhvlerësuara	3,225	2,011
Të zhvlerësuara	5,913	7,815
Total hua bruto	10,566	10,574
Zhvlerësimi individual	(5,183)	(7,079)
Zhvlerësim kolektiv	(1,417)	(858)
Huatë neto	3,966	2,637

Huatë dhe paradhëniet për bankat

Huatë dhe paradhëniet për bankat që nuk janë as në vonesë e as të zhvlerësuara dhe jepen pa kolateral. Tabela në vazhdim paraqet klasifikimin kreditor të dhënë nga agjencitë e klasifikimit kreditor Moody's, Fitch dhe Standard and Poor's:

Klasifikimet	2016	2015
AAA	547	775
A+	-	6
A.	207	-
A1	-	811
A3	8,720	-
Aa3	1,195	-
Baa1	2,672	3
Baa2	9,506	2,626
Baa3	-	5,014
BBB+	-	1,004
Jo të klasifikuara (bankat vendore)	4,087	11
Gjithsej	26,934	10,250

Tabela e mësipërme nuk përfshin gjendjet në BQK (shih shënimin 5) të cilat nuk janë të klasifikuara.

Aktivet financiare të vlefshëm për shitje

	2016	2015
Borxhi i Qeverisë së Kosovës: E paklasifikuar	14,727	10,288

Përqendrimi sipas rajoneve gjeografike

Në vijim paraqiten ekspozimet kryesore të Bankës sipas rajonit gjeografik më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Banka ka ndarë ekspozimet sipas rajoneve bazuar në shtetin e banimit të palëve të saj.

	Vendet e		Gjithsej	Vendet e		Gjithsej
	OECD-së	Kosovë		2016	OECD-së	
Arka dhe Banka Qendrore	12,235	48,627	60,862	5,246	67,630	72,876
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	-	14,699	-	5,004	5,004
Huatë dhe paradhëniet për klientët	-	328,455	328,455	-	313,744	313,744
Aktivet financiare të vlefshëm për shitje	-	14,727	14,727	-	10,288	10,288
Aktive të tjera financiare	309	2,334	2,643	189	1,731	1,920

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****g. Rreziku kreditor (vazhdim)****Përqendrimi sipas sektorit***Përqendrimi i industrisë*

	31 dhjetor 2016		31 dhjetor 2015	
	Huatë neto	%	Huatë neto	%
Bankat	14,699	4 %	5,004	2%
Individët	165,605	48%	148,792	47%
Elektricitet, gaz, ujë	28	0%	1,630	1%
Industri	23,319	7%	9,847	3%
Bujqësi	4,286	1%	3,703	1%
Shërbimet dhe të tjera	31,386	9%	94,138	30%
Hotele dhe restorante	7,566	2%	4,122	1%
Transporti dhe komunikimet	4,533	1%	2,931	1%
Ndërtim	34,315	10%	28,687	9%
Tregti	57,417	17%	19,894	6%
Huatë neto për bankat dhe klientët	343,154	100%	318,748	100%

Fshirjet kontabël

Fshirjet kontabël përkufizohen si zvogëlim kontabël i një borxhi, i cili nuk nënkupton heqjen dorë nga kërkesa ligjore kundër debitorëve, për këtë arsye borxhi mund të ri-arkëtohet. Propozimet për fshirje (të plota ose të pjesshme) të borxheve mund t'i dorëzohen komitetit kompetent me kusht që të ndiqen procedura të caktuara.

Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") ka publikuar një rregullore të re për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor që do të hyjë në fuqi nga data 30 qershor 2017. Rregullorja përcakton kriteret për fshirjen e kredive që janë të klasifikuara si humbje. Banka ka ndryshuar politikën e saj të brendshme për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat e reja që fillojnë nga viti 2017. Bazuar në një vlerësim fillestar të ndikimit të kërkesave të reja të përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Rrezikut, shuma gjithsej prej 5.6 milionë EUR do të fshihet në vitin 2017, duke përfaqësuar kredi që janë provizionuar plotësisht më 31 dhjetor 2016. Për disa ekspozime të përfshira në këtë total ka prishmëri se Banka do të jetë në gjendje ta rikuperojë një pjesë të ekspozimit.

h. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit shfaqet në financimin e përgjithshëm të aktiviteteve të Bankës dhe në administrimin e pozicioneve. Ai përfshin rrezikun e të pamundësisë për të financuar aktivet kur arrijnë maturitetin përkatës dhe normat dhe rrezikun e pamundësisë për ta likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe me kohë për t'i përmbushur detyrimet. Banka e monitoron likuiditetin e saj në bazë ditore, mujore dhe tremujore ashtu që të administrojë detyrimet e veta kur ato maturohen.

Raportet e mëposhtme janë përdorur nga Banka për qëllime të menaxhimit të likuiditetit:

- Raporti i mjeteve monetare dhe raportet e likuiditetit të ofruara nga rregullorja e BQK-së (>25% dhe > 20%): në baza ditore
- Raportet e Mbulimit të Likuiditetit dhe të Hendekut të Likuiditetit të KAD-së: në baza mujore
- Raportimi në nivel të KAD-së dhe Bordit: në baza tremujore.

Raporti i Hendekut të Likuiditetit përgatitet nga Departamenti i Rrezikut në Turqi duke përdorur të dhënat e pranuar nga Banka. Banka gjithashtu përdor raportet e Hendekut të Likuiditetit të BQK-së (ku nuk aplikohen supozime). Limitet e financimit prej 35 milionë EUR janë në dispozicion nga ana e TEB A.S për të mbuluar nevojat e Bankës për likuiditet.

Fondet sigurohen duke shfrytëzuar një sërë instrumentesh, duke përfshirë depozitat, huatë si dhe kapitalin aksionar. Kjo gjë shton fleksibilitetin e financimit, kufizon varësinë në secilën prej burimeve të fondeve si dhe në përgjithësi e ul koston e financimit. Banka bën përpjekjet më të mira që të ruajtur një ekuilibër në mes vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit duke i përdorur detyrimet me një seri maturiteteve. Banka në vazhdimësi bën vlerësimin e rrezikut të likuiditetit duke i identifikuar e monitoruar ndryshimet në financimin e nevojshëm për të arritur qëllimet dhe objektivat afariste të caktuara brenda strategjisë së përgjithshme të Bankës. Banka gjithashtu mban portofolin e aktiveve likuide si pjesë e strategjisë së administrimit të rrezikut të likuiditetit. Drejtimi monitoron raportet e likuiditetit kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullatorit në baza ditore, javore dhe mujore. Si rezultat, Menaxhmenti beson se Banka nuk ka hendek afatshkurtër të likuiditetit.

TEB SH.A.**Shënime mbi pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****h. Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Shumat e paraqitur në tabelën në vijim janë rrjedha të parasë jo të skontuara të kontraktuara.

	Shumat e	Flukset	Më	1-3	3-12	1-5	Më
31 dhjetor 2016	bartura	hyrëse/	pak se	muaj	muaj	vite	shumë se
		(dalëse)	1 muaj				5 vite
Aktivët financiarë							
Arka dhe Banka Qendrore	60,862	60,862	60,862	-	-	-	-
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	14,699	14,699	-	-	-	-
Huatë për klientët	328,455	364,629	47,208	11,540	41,643	197,826	66,412
Aktivët financiarë të vlefshëm për shitje	14,727	15,023	306	12,479	610	1,628	-
Aktive të tjera financiare	2,643	2,643	2,643	-	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	421,386	457,856	125,718	24,019	42,253	199,454	66,412
Detyrimet financiare							
Detyrimet ndaj klientëve	334,467	345,121	282,705	5,276	31,964	25,144	32
Huatë	17,522	19,449	33	3,000	714	9,335	6,367
Detyrimet e tjera financiare	4,284	4,284	4,284	-	-	-	-
Totali detyrimet financiare	356,273	368,854	287,022	8,276	32,678	34,479	6,399
Angazhime për hua të papërdorur	69,818	69,818	50,109	3,824	9,763	169	5,953
Totali detyrimeve dhe angazhimeve	426,091	438,672	337,131	12,100	42,441	34,648	12,352
Hendeku pozitiv/(negativ)	(4,705)	19,184	(211,413)	11,919	(188)	164,806	54,060

	Shumat e	Flukset	Më	1-3	3-12	1-5	Më
31 dhjetor 2015	bartura	hyrëse/	pak se	muaj	muaj	vite	shumë se
		(dalëse)	1 muaj				5 vite
Aktivët financiarë							
Arka dhe Banka Qendrore	72,876	72,876	72,876	-	-	-	-
Huatë dhe paradhëniet për bankat	5,004	5,004	5,004	-	-	-	-
Huatë për klientët	313,744	351,767	46,919	24,891	102,005	161,573	16,379
Aktivët financiarë të vlefshëm për shitje	10,288	10,495	50	9,423	271	751	-
Aktive të tjera financiare	1,920	1,920	1,920	-	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	403,832	442,062	126,769	34,314	102,276	162,324	16,379
Detyrimet financiare							
Detyrimet ndaj klientëve	342,878	344,316	284,511	3,361	28,465	27,974	5
Huatë	10,975	15,213	-	-	1,797	13,416	-
Detyrimet e tjera financiare	2,166	2,166	2,166	-	-	-	-
Totali detyrimet financiare	356,019	361,695	286,677	3,361	30,262	41,390	5
Angazhime për hua të papërdorur	63,908	63,908	50,109	3,824	9,763	169	43
Totali detyrimeve dhe angazhimeve	419,927	425,603	336,786	7,185	40,025	41,559	48
Hendeku pozitiv/(negativ)	(16,095)	16,459	(210,017)	27,129	62,251	120,765	16,331

Për qëllime të likuiditetit, Banka i klasifikon depozitat dhe llogaritë e kursimet me kërkesë dhe me afat maturimi brenda një muaji. Si rezultat, është rritur hendeku kontraktuar i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj. Megjithatë, mundësia e tërheqjes së shumave të mëdha të depozitave të klientëve nga Banka nuk ka gjasa të ndodhë. Për këtë arsye, Banka nuk konsideron se ka hendek të likuiditetit në afat të shkurtër.

TEB SH.A.**Shënime për pasqyrat financiare****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016***(Shumat në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)***28. Instrumentet financiare: vlerat e drejta dhe menaxhimi i rrezikut (vazhdim)****i. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare*****Instrumentet financiare që nuk maten në vlerën e drejtë***

Tabela e mëposhtme përcakton vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten në vlerë të drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën secila matja në vlerë të drejtë është e kategorizuar.

	2016	Vlera e drejtë		2015	Vlera e drejtë	
	Vlera	Niveli 2	Niveli 3	Vlera	Niveli 2	Niveli 3
Aktivet financiare	kontabël			bartëse		
Arka dhe Banka Qendrore	60,862	60,862	-	72,876	72,876	-
Huatë dhe paradhëniet për bankat	14,699	14,699	-	5,004	5,004	-
Huatë dhe paradhëniet për klientët	328,455	-	327,111	313,744	-	312,276
Aktivet e tjera financiare	2,334	-	2,334	1,731	-	1,731
Detyrimet financiare						
Detyrimet ndaj klientëve	334,467	-	336,006	342,878	-	343,848
Huatë	17,522	-	17,522	10,975	-	10,975
Detyrime të tjera financiare	4,284	-	4,284	2,166	-	2,166

Kur është e mundur, vlera e drejtë e huave dhe e paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur metodat e vlerësimit, siç janë teknikat e flukseve të skontuar të mjeteve monetare. Burimi në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë gjatë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për ta përmirësuar saktësinë e vlerësimit për kredi për pakicë dhe kredi më të vogla tregtare, kreditë homogjene janë të grupuara në portofol me karakteristika të ngjashme.

Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe aktivet dhe detyrimet e tjera financiare përfshijnë vendosjet ndër-bankare dhe zërat për arkëtim. Pasi këto gjendje janë afatshkurtra, vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën e tyre kontabël.

Vlera e drejtë e depozitave dhe huave nga bankat dhe klientët vlerësohet duke përdorur teknika e flukseve të skontuara të mjeteve monetare, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturitete dhe terme të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme në moment është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Nuk ka pasur blerje ose shitje të aktiveve financiare të nivelit të 3-të dhe ndryshimi në vlerën kontabël të tyre është si rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë.

Instrumentet financiare që maten në vlerë të drejtë - Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare që maten në vlerë të drejtë në datën e raportimit sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën matja në vlerë të drejtë është e kategorizuar. Shumat janë të bazuara në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2016 Vlera e drejtë	Niveli 2	2015 Vlera e drejtë	Niveli 2
Aktivet financiare jo-derivative				
Aktivet financiare të vlefshme për shitje		14,727		10,288
Aktivet financiare derivative				
Këmbimet derivative të valutës së huaj		309		189
	15,036	15,036	10,477	10,477

Aktivet financiare të vlefshme për shitje janë aktive që bartin interes. Për shkak se nuk ka treg aktiv për bonot e thesarit dhe obligacionet, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të mjeteve monetare duke u bazuar në trendin aktual të kthimit të përshtatshme për periudhën e mbetur deri në maturim dhe ato janë klasifikuar si Niveli 2.



TEB

BNP PARIBAS JOINT VENTURE

teb-kos.com